



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**RAPORT MBI PROCESIN E ANËTARËSIMIT DHE  
INTEGRIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË  
BASHKIMIN EVROPIAN**

*(Periudha raportuese: viti 2025 dhe 4 mujori i parë 2026)*

## PASQYRA E LËNDËS

<b>HYRJE</b> .....	<b>3</b>
<b>PJESA I: NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIM NË BASHKIMIN EVROPIAN</b> .....	<b>4</b>
I.1 ÇELJA E NEGOCIATAVE: PROGRESI .....	4
I.2 KUSHTET E NDËRMJETME: PROGRESI.....	5
I.3 KUSHTET E MBYLLËSE: PROGRESI .....	19
<b>PJESA II: PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT KOMBËTAR ME ACQUIS TË BE-SË NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN</b> .....	<b>45</b>
<b>PJESA III: FONDET NGA BASHKIMI EVROPIAN DHE PARTNERËT E TJERË</b> .....	<b>55</b>
<b>PJESA IV: TË TJERA</b> .....	<b>61</b>
IV.1 STRUKTURA NEGOCIUESE .....	61
IV.2 PLATFORMA E PARTNERITETIT PER INTEGRIMIN EVROPIAN.....	62
IV.3 KAPACITETET .....	63
IV.4 PUSHTETI VENDOR.....	64
<b>PJESA V: ANEKS I: LISTA E AKTEVE TË MIRATUARA GJATË PERIUDHËS 2025 – PRILL 2026 PËR SECILIN (GRUP) KAPITULL TË ACQUIS:</b> .....	<b>72</b>

## HYRJJE

Raporti i Këshillit të Ministrave për “Procesin e Negociatave për Anëtarësimin dhe Integrimin të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, i drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, hartohet në zbatim të nenit 18, të ligjit nr. 77/2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2015, ‘Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian’, i ndryshuar”, i cili përcakton detyrimin për paraqitjen e një raporti të detajuar mbi zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim, si dhe menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian dhe donatorëve të tjerë për vitin paraardhës.

Njëkohësisht në funksion të rritjes së koherencës së informacionit në lidhje me negociatat dhe integrimin, duke nisur nga fakti se negociatat kanë hape dhe ritmin të përcaktuar, ku fazat programohen sipas ecurisë dhe dinamikës teknike politike, ky Raport parashikon informacion të përditësuar edhe në kombinimin më të kërkuesat e përcaktuar në nenin 19, pika 1 të ligjit nr. 77/2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2015, ‘Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian’, i ndryshuar”, lidhur me progresin në përafrimin me Acquis të BE-së, ecurinë e negociatave dhe ndjekjen e rekomandimeve, duke integruar këto dimensione në mënyrë të përmbledhur dhe të strukturuar, për sa i takon zhvillimeve dhe progresit në kuadër të procesit të integritit evropian dhe më konkretisht kalim nga faza e çeljes së negociatave për anëtarësim.

Përgjatë Tetor 2024 – Nëntor 2025, në Fazën e Ndërmjetme (midis çeljes së negociatave dhe mbylljes së tyre), pra atë të plotësimit të “Kushteve të Ndërmjetme” në “Themeloret” (përkatesisht 24 Kushte në Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”), puna për të cilat u zhvillua gjatë vitit 2025 dhe u përmbyll nga Shqipëria në Janar 2026, drejt Fazës së mbylljes së negociatave. Ku gjatë vitit 2025 u punua për të qënë teknisht gjatë duke lëvruar të gjitha masat për Kushtet Mbyllëse të negociatave të përcaktuara nga Bashkimi Evropian, të paktën për 3 kapitujt e parë (30, 26, 25), ku në muajin Mars u përfundua dhe me avancime të mira dhe për të paktën 7 kapitujt të tjerë. Informacioni për progresin gradual të vendit për të gjitha çështjet, i është dërguar më parë sistematikisht (në çdo 3 muaj) Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nga Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator në emër të Grupit Negociator të Republikës së Shqipërisë, respektivisht me shkresat, shkresa nr.2508 prot., datë 20.05.2025, me lëndë “Dërgim raporti Kuvendit të Shqipërisë për ecurinë e procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian për tremujorin e parë të vitit 2025”, shkresa nr. 3996 prot., datë 06.08.2025, me lëndë “Dërgim raporti Kuvendit të Shqipërisë për ecurinë e procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian për tremujorin e dytë të vitit 2025”, shkresa nr. 860/1 prot., datë 25.02.2026, me lëndë “Mbi ecurinë e procesit të anëtarësimit për dy mujorin dhe katërmujorin e tretë të vitit 2025, shkresa nr. 85 prot. (e kufizuar), datë 25.02.2026 me lëndë “Përcjellje e informacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të Komisionit për Evropën dhe Punët e Jashtme, në Procesin e Negociatave të Anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

Me ndryshim nga sa më sipër ky Raport përfshin:

- Strukturimin e informacionit në një dokument të vetëm Raport të konsoliduar
- përditësimin e tij me progresin (sidomos me avancimin për përgatitjet teknike për plotësimin e Kushteve Mbyllëse në 3 Kapitujt e para, dhe me gjërë deri në 10 Kapitujt e para, për muajt Mars – Prill 2026.

# PJESA I: NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIM NË BASHKIMIN EVROPIAN

## I.1 Çelja e negociatave: progresi

Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian brenda vitit 2030 përfaqëson më shumë se një objektiv të politikës së jashtme, ai përbën një proces të thellë përmirësimi institucional, si dhe një transformim ekonomik dhe shoqëror. Mbështetja e fortë e 92% të popullsisë për integrimin evropian e vendos këtë proces në krye të prioritetëve të programit të Qeverisë Shqiptare 2025-2029. Shqipëria ka arritur të shënojë një rekord historik në negociatat për anëtarësim, duke hapur të gjashtë grupkapitujt në vetëm 13 muaj, ritmi më i shpejtë në historinë e zgjerimit të BE-së. Si vijim i rrugëtimit të nisur gjatë 2024 me hapjen e Grupkapitullit I “Themelorët” (15.10.2024) dhe Grupkapitullit VI “Marrëdhëniet me Jashtë” (17.12.2024), Shqipëria përmbylli hapjen e të gjithë grupkapitujve gjatë vitit 2025, në përputhje të plotë me Metodologjinë e Rishikuar të Zgjerimit të BE-së. Ky zhvillim ka kaluar nga faza përgatitore në një fazë intensive negociuese, të orientuar drejt përbushjes së piketave të ndërmjetme (për Kapitujt 23 dhe 24 – Grupkapitulli I), piketave mbyllëse dhe arritjes së rezultateve të matshme reformuese në të gjithë kapitujt.

**Më 14 prill 2025** u zhvillua Konferenca e 4-të Ndërqeveritare Shqipëri–BE, e cila shënoi hapjen zyrtare të negociatave për Grupkapitullin II “Tregu i Brendshëm”. Në vijim, Komisioni Evropian përcolli Dokumentin e Qëndrimit të Përbashkët të Bashkimit Evropian (miratuar më 11.04.2025), i cili përcakton kornizën negociuese dhe **29 piketat mbyllëse** për Grupkapitullin II, të shpërndara në kapitujt: si lëvizja e lirë e mallrave, liria e lëvizjes së punëtorëve, e drejta e themelimit dhe ofrimit të shërbimeve, lëvizja e lirë e kapitalit, legjislativi për shoqëritë tregtare, e drejta e pronësisë intelektuale, politika e konkurrencës, shërbimet financiare si dhe mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit. Sipas metodologjisë së zgjerimit, mbyllja e kapitujve kushtëzohet drejtpërdrejt nga përbushja e plotë e këtyre piketave.

**Më 22 maj 2025**, Konferenca e 5-të Ndërqeveritare hapi zyrtarisht negociatat për Grupkapitullin III “Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse”. Dokumenti i Qëndrimit të Përbashkët të BE-së (miratuar më 8.05.2025) përcakton **19 piketa mbyllëse** që lidhen me kapitujt e transformimit digjital dhe medias, tatimeve, politikës ekonomike dhe monetare, politikës sociale dhe punësimit, ndërmarrjeve dhe politikës industriale, shkencës dhe kërkimit, arsimit dhe kulturës, si dhe bashkimit doganor. Ky dokument udhëheq planifikimin, monitorimin dhe raportimin e progresit negociues për Grupkapitullin III.

**Më 16 shtator 2025** u zhvillua Konferenca e 6-të Ndërqeveritare, e cila hapi negociatat për Grupkapitullin IV “Agjenda e Gjelbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme”. Qëndrimi i Përbashkët i BE-së (miratuar më 12.09.2025) përcakton **22 piketa mbyllëse**, të fokusuara në kapitujt e politikës së transportit, energjisë, rrjeteve trans-evropiane, si dhe mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Përbushja e këtyre piketave, në ndërthurje me vendimmarrjen e vendeve anëtare, përbën kushtin thelbësor për mbylljen e negociatave për kapitujt përkatës.

**Më 17 nëntor 2025**, Konferenca e 7-të Ndërqeveritare shënoi hapjen e negociatave për Grupkapitullin V “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni”. Dokumenti i Qëndrimit të Përbashkët të BE-së (miratuar më 12.11.2025) përcakton **18 piketa mbyllëse**, të lidhura me bujqësinë dhe zhvillimin rural, sigurinë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare, peshkimin dhe akuakulturën, politikën rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore, si dhe dispozitat financiare dhe buxhetore.

Në periudhën 2026–2028, prioriteti kryesor i institucioneve shqiptare do të jetë përmbushja e plotë dhe në kohë e piketave mbyllëse të përcaktuara në Qëndrimet e Përbashkëta të BE-së, përmes reformave të qëndrueshme ligjore, institucionale dhe administrative. Ky objektivi do të mbështetet nga një koordinim i forcuar ndër-institucional, mekanizma të rregullt monitorimi dhe raportimi, si dhe nga integrimi i angazhimeve negociuese në dokumentet strategjike dhe buxhetore afatmesme të qeverisë.

## 1.2 Kushtet e Ndërmjetme: progresi

Në përputhje me Qëndrimin e Përbashkët të BE-së për Grupkapitullin e I-rë “Themeloret” (miratuar më 11 tetor 2024), gjatë vitit 2025 e deri në mes të shkurtit 2026 (kur edhe përfundoi puna 15 mujore për zbatimin e masave për përmbushjen e Kushteve të Ndërmjetme) është avancuar me plotësimin e 24 Piketave të Ndërmjetme (*Interim Benchmarks*) të përcaktuara për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kapitullin 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”. Këto kushte përbëjnë pikat kyçe në negociatat e anëtarësimit, për të garantuar një ecuri të qëndrueshme dhe të besueshme veçanërisht në fushat e Shtetit të së Drejtës, reformës në drejtësi, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut.

Për përmbushjen e 24 Kushteve, është punuar për adresimin e 92 Hendeqeve Kritike (*Critical Gaps*), të dakordësuar me Komisionin Evropian. Këto hendeqe identifikojnë veprimet dhe masat institucionale të nevojshme për të arritur përafrimin me *Acquis*-në e BE-së dhe për të demonstruar zbatim efektiv në praktikë në luftën kundër krimit, korrupsionit, konsolidimit të reformës në drejtësi, të drejtave të njeriut, barazisë.

### Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”

- Numri i Kushteve të Ndërmjetme: 14
- Numri i Hendeqeve Kritike: 64

### Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”

- Numri i Kushteve të Ndërmjetme: 10
- Numri i Hendeqeve Kritike: 28

Përmbushja e Kushteve të Ndërmjetme përbën një fazë kyçe për avancimin e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë, duke krijuar bazën për nisjen e procesit të mbylljes së negociatave përmes punës në përmbushjen e Kushteve Mbyllëse për të gjithë grupkapitujt (31 nga 33 kapituj). Të gjithë institucionet shqiptare, Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, institucionet e sistemit të drejtësisë dhe institucionet e pavarura përkatëse, kanë punuar intensivisht me një qasje gjithëpërfshirëse ndër-institucionale për plotësimin dhe përshejtimin e zbatimit, duke garantuar rezultate të vlerësuara konkrete dhe të matshme, si dhe progres të qëndrueshëm dhe besueshmëri në procesin e përmbushjes së Kushteve të Ndërmjetme në Grupkapitullin, “Themeloret”, (kapitujt 23 dhe 24).

Gjatë vitit 2025 dhe në fillim të vitit 2026, Shqipëria ka konsoliduar qasjen e saj të bazuar në rezultate, duke ndërthurrur përmirësime institucionale, instrumente të reja rregullatore, rritje të kapaciteteve dhe rezultate me tregues të matshëm, duke avancuar kështu dukshëm në konsolidimin e Reformës në Drejtësi, luftës kundër krimit, korrupsionit, të drejtave të njeriut dhe barazisë. Gjatë periudhës Nëntor 2024 (mbas çeljes së negociatave për këtë Grupkapitull) fillim Shkurti 2026, në përmbushje të Kushteve të Ndërmjetme, Shqipëria ka hartuar dhe

miratuar rreth 75 akte rregullatore, me rëndësi të veçantë, duke demonstruar një angazhim të lartë e të vlerësueshëm institucional me nisma reformuese e rregullatore si dhe rezultate.

### **Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”**

Sa i përket **pavarësisë së sistemit të drejtësisë** dhe vijimësisë së drejtimit të institucioneve kyçe, është forcuar praktika e rinovimit të rregullt dhe transparent të pozicioneve të nivelit të lartë në drejtësi, mbi bazën e parimeve të meritës dhe integritetit. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka zhvilluar procedura të plota vlerësimi/renditjeje për kandidatë në Gjykatën e Lartë dhe vakanca në Gjykatën Kushtetuese (verifikime të integritetit, dhe raportet e ILDKPKI-së).

Pas përmbylljes së procedurave të përzgjedhjes nga KLP, Z.Klodjan Braho u zgjodh Drejtues i Prokurorisë së Posaçme (SPAK) me Vendimin e KLP-së Nr. 374, të datës 11 Dhjetor 2025 dhe nisi zyrtarisht detyrën më 19.12.2025, ndërsa Z.Joni Keta u emërua Drejtor i Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) me Vendimin e KLP Nr. 370, të datës 9 Dhjetor 2025, pas një procesi të besueshëm dhe të pavarur.

Në funksion të rishikimit dhe harmonizimit të kuadrit ligjor për emërimin e anëtarëve jo-magjistratë të KLGJ-së dhe KLP-së, janë ndërmarrë hapa të strukturuar për të garantuar standarde të njëjta të meritës dhe integritetit si për magjistratët ashtu edhe për prokurorët. Në këtë kuadër, Kuvendi i Shqipërisë, më datë 27.01.2026 miratoi Ligjin Nr. 10/2026 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 9/2026 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Këto ndryshime synojnë konsolidimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, sidomos në lidhje me përmirësimin e statusit, garancive të pavarësisë, integritetit dhe përgjegjshmërisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Gjatë vitit 2025, u forcua koherenca ndër-institucionale dhe standardizimi i praktikave, duke adresuar elementë të **pavarësisë** dhe **përgjegjshmërisë** përmes rregullave të brendshme, procedurave të përbashkëta dhe mekanizmave të ndjekjes. KLGJ dhe KLP kanë avancuar ndjeshëm me përmirësime në kuadrin rregullator dhe standardet e funksionimit, duke u fokusuar te standardizimi i proceseve dhe rritja e efektivitetit. Në këtë kuadër, më 16.07.2025 u miratua Rregullorja e Përbashkët për Procedurat Standarde të Verifikimit të Pasurisë dhe Integritetit në kontekstin e rivlerësimit (KLGJ vendimi nr. 409; KLP vendimi nr. 169), duke forcuar komponentin e “standardeve të larta të verifikimit” dhe kontroleve përkatëse. Po ashtu, KLP përditësoi Metodologjinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Prokurorëve, me vendimin nr. 265, datë 30.07.2025, ndërsa KLGJ miratoi paketën e masave për efikasitet duke përfshirë “Udhërrëfyesin” 2025 – 2027” dhe standarde kohore/sasiore e modele standarde vendimesh, duke adresuar kërkesat për rregulla që rrjedhin nga Plani i Efikasitetit dhe përmirësimin e cilësisë/standardizimit të punës.

Në kuadër të zbatimit të plotë dhe në kohë të vendimeve gjyqësore, përfshirë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë, më 27.01.2026 miratoi ligjin nr. 14/2026 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8891, datë 02.05.2002 'Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit’”. Ky ligj synon të forcojë qartësinë dhe sigurinë juridike në veprimtarinë e komisioneve hetimore parlamentare, duke garantuar ushtrimin e kompetencave të tyre, në përputhje me parimin e ndarjes së pushteteve dhe detyrimin kushtetues për respektimin dhe zbatimin e vendimeve të gjykatave.

Sa i përket **cilësisë së drejtësisë**, viti 2025 shënoi progres të matshëm në drejtim të reduktimit të *backlog*-ut të vlerësimeve dhe forcimit të vendimmarrjes së bazuar në performancë. Në veçanti, KLGJ rriti ndjeshëm volumin e vlerësimeve, duke përfunduar 50 raporte vlerësimi për gjyqtarë gjatë vitit 2025, si tregues i rritjes dhe i një qasjeje më konsistente ndaj standardeve të cilësisë. Në total, që nga viti 2021 deri më 31.03.2026, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësime për 158 gjyqtarë. Paralelisht, KLP vijoi procesin e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve sipas metodologjisë së miratuar dhe amendimeve përkatëse. Aktualisht numri i raporteve të miratuara është 50, ndërsa metodologjia u përditësua me Vendimin Nr. 265, datë 30.07.2025, si pjesë e përpjekjeve për rritjen e objektivitetit dhe sistematikës së procesit.

**Në drejtim të eficiencës së sistemit të drejtësisë**, janë ndërmarrë masa strukturore e operacionale për uljen e *backlog*-ut dhe shkurtimin e kohëzgjatjes së çështjeve. KLGJ miratoi “Udhërrëfyesin për Eficiencën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri 2025–2027” (vendimi nr. 407, datë 15.07.2025), duke vendosur objektiva të matshëm, statistika të unifikuara dhe monitorim të rregullt, ndërsa një paketë vendimesh operacionale gjatë 2025 (për njësitë e shërbimit juridik, numrin total të gjyqtarëve dhe ngritjen e njësive në gjykatat kryesore) ka standardizuar mbështetjen analitike dhe ka forcuar menaxhimin e fluksit. Këto masa shoqërohen me rezultate në reduktimin e kohëzgjatjes së çështjeve.

Evidentohet një ulje e matshme e çështjeve të prapambetura (“*backlog*”) si në nivel sistemi, ashtu edhe në institucione kyçe. Në fund të vitit 2024<sup>1</sup>, numri i përgjithshëm i çështjeve të prapambetura në gjyqësor ishte 137,101, rreth 2% më i ulët krahasuar me vitin paraardhës. Ndërsa në Gjykatën e Lartë, trendi i reduktimit është më i theksuar. Deri më datë 31.12.2025 *backlog*-u ishte 14,081 çështje, me një ulje të qëndrueshme ndër vite dhe një reduktim -24% në vitin 2025 krahasuar me 2024, si dhe -60% ulje kumulative nga niveli maksimal i korrikut 2020 deri në dhjetor 2025.

**Transformimi digjital** ka shërbyer si shtyllë për rritjen e eficiencës dhe integritetin. Më 01.08.2025, KLGJ shpalli ofertuesin fitues dhe lidhi kontratën për zbatimin e Sistemit të ri të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve (ICMIS), ndërsa për prokuroritë vijon projekti “EU4Digital Justice - Support to the Rule of Law through Digital Transformation” (i lançuar më 28.01.2025 me zbatim deri në vitin 2028). Gjatë 2025 u ngrit infrastruktura fizike, u përmbyllën fazat e nisjes/analizës/planifikimit dhe u krijuan grupet e punës për module specifike, duke vendosur bazat për integrim, interoperabilitet dhe kufizim të diskrecionit nëpërmjet digjitalizimit kombëtar të sistemit të drejtësisë përmes ICMIS që parashikohet të përfundojë deri në vitin 2027, si dhe digjitalizimin e mëtejshëm të të dhënave.

Në aspektin e ndërtimit të një gjurmueshmërie “*track record*” të qëndrueshëm të progresit në hetime, Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur në qendër rritjen e efikasitetit institucional përmes digjitalizimit dhe standardizimit të proceseve, duke vijuar zhvillimin e Sistemit të ri të Menaxhimit të Çështjeve (ICMIS), i financuar nga BE dhe i zhvilluar nga UNOPS, me qëllim digjitalizimin e plotë të proceseve të punës, prodhimin e statistikave të sakta, shpërndarjen e çështjeve me short elektronik dhe ndërlidhjen me databaza/ funksionalitete të tjera. Po ashtu, për të konsoliduar “*track record*”-in dhe për të siguruar një qasje më të njëtrajtshme në ndjekjen penale, Prokurori i Përgjithshëm ngriti një grup pune ekspertësh me Urdhrin Nr. 24, datë 16.12.2025, për rishikimin, standardizimin dhe përditësimin e modeleve të akteve procedurale penale, me synim gjithashtu, integrimin funksional të tyre në ICMIS.

---

<sup>1</sup> Të dhënat zyrtare statistikore në lidhje me uljen e “backlog” jepen në baza vjetore dhe të dhënat për vitin 2025 pritet të publikohen nga sistemi gjyqësor.

Për më tepër, ka avancuar procesi i forcimit të kapaciteteve njerëzore, përfshirë procesin e rekrutimit të 10 oficerëve të Policisë Gjyqësore në BKH, të cilët janë në fazën e dytë të procesit (intervistë e strukturuar me gojë), si pjesë e përpjekjeve për të përballuar ngarkesën në rritje dhe për të përmirësuar mbështetjen procedurale të hetimeve.

Po gjatë vitit 2025, në funksion të rritjes së efektivitetit operacional të SPAK, është avancuar operacionalizimi i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve (me mbështetje të BE-së përmes UNOPS), me synim funksionimin e plotë deri në Dhjetor 2026. Gjithashtu, më 04.08.2025 u miratua Strategjia “Për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura 2025–2027”, e bazuar në Udhërrëfyesin EU4LEA, me afate të qarta, mekanizma monitorimi dhe menaxhim aktiv të çështjeve.

**Në fushën e Luftës Kundër Korrupsionit**, gjatë 2025 është evidentuar rritje e qëndrueshme, në numër dhe cilësi, të referimeve drejt SPAK-ut, me kallëzime të targetuara nga Tatimet, Doganat, ASHK, BKH, Policia e Shtetit dhe DPA, si dhe me intensifikim të masave administrative dhe çështjeve sipas ligjit për sinjalizimin, nga ILDKPKI. Paralelisht, për të formalizuar bashkëpunimin Polici - SPAK/BKH, më datë 27.01.2026 është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit “Për Luftën Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Konsultimin e Bazave të të Dhënave në Interes të Hetimit” midis Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, duke synuar koordinim më të mirë hetimor dhe shkëmbim më të shpejtë e të sigurt informacioni.

“*Track record*”-et në fushën e luftës kundër korrupsionit pasqyrojnë konsolidimin gradual të rezultateve të ndjekjes penale dhe të vendimmarrjes gjyqësore, duke ofruar një bazë të qëndrueshme për vlerësimin e progresit. Në këtë kuadër, të dhënat vjetore për vitin 2025 paraqesin një panoramë të matshme të performancës për kategoritë kryesore të veprave penale dhe të ecurisë së çështjeve, si më poshtë vijon:

*Krimi i organizuar*: Gjatë vitit 2025 u ruajt një volum i -qëndrueshëm i veprimtarisë hetimore dhe i ndjekjes penale. U regjistruan 74 hetime të reja dhe u paraqitën 18 aktakuza të reja. Në vijim, u siguruan 61 vendime gjyqësore të formës së prerë, duke reflektuar avancim të qëndrueshëm të rezultateve në fazën gjyqësore.

*Korrupsioni i nivelit të lartë*: Ndjekja penale gjatë vitit 2025 pati fokus në konsolidimin e rezultateve dhe përfundimin e çështjeve. U hapën 6 hetime të reja dhe u paraqitën 10 aktakuza të reja. Krahas kësaj, u regjistruan 6 vendime gjyqësore të formës së prerë dhe 5 dënime përfundimtare, duke dëshmuar vijimësi të shqyrtimit dhe vendimmarrjes së gjyqësorit në këtë kategori.

*Korrupsioni - vepra penale të lidhura me korrupsionin (jo niveli i lartë)*: Në 2025, u evidentua një numër hetimesh dhe aktakuzash. Konkretisht, u regjistruan 878 hetime të reja dhe 236 aktakuza të reja. Në fazën gjyqësore, u raportuan 287 vendime gjyqësore të formës së prerë, si dhe 221 dënime përfundimtare, ç’ka forcon bazën e rezultateve të qëndrueshme në këtë grupim çështjesh.

*Pastrimi i parave*: Gjatë vitit 2025, u regjistruan 207 hetime të reja dhe 23 aktakuza të reja. Njëkohësisht, u siguruan 16 vendime gjyqësore të formës së prerë dhe 16 dënime përfundimtare.

Paralelisht, është forcuar komponenti i trajnimit të profilizuar. Shkolla e Magjistraturës zhvilloi module të dedikuara për prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, përfshirë trajnime mbi

zbatimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së në hetimet e korrupsionit, dispozitat ligjore për veprat e korrupsionit, si dhe tematika mbi “korrupsionin, shpërdorimin e detyrës dhe shkeljet e barazisë në prokurime”, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve hetimore dhe cilësisë së ndjekjes penale.

Gjithashtu, në kuadër të punës intensive për **parandalimin e korrupsionit**, zbatimi i Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030 po mbështetet nga një sistem i konsoliduar koordinimi, monitorimi dhe raportimi, ku udhëheqja ushtrohet nga Koordinator i Kombëtar (Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin) dhe koordinimi teknik sigurohet nga Drejtorja e Përgjithshme Antikorrupsion. Progresi matet me cikël të detyrueshëm monitorimi gjashtëmujor dhe raportim vjetor. Raporti Vjetor i Monitorimit 2024 u miratua më 10.06.2025, me Urdhrin Nr. 4, datë 25.06.2025, duke paraqitur një rezultat të mirë me 87.5% shkallë zbatimi të Planit të Veprimit 2024 (me 22 masa dhe 63 aktivitete të përmbushura; nga 24 tregues, 20 të përmbushur plotësisht).

Sa i takon Raportit Vjetor të zbatimit të Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit për vitin 2025, më datë 14 prill u zhvillua mbledhja e Ekipit Tematik Antikorrupsion. Në takim morën pjesë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të cilët ndanë komentet dhe vlerësimet e tyre mbi gjetjet dhe përmbajtjen e raportit. Raporti evidenton një nivel zbatimi prej 83.5% të Planit të Veprimit, çka dëshmon qëndrueshmëri në realizimin e masave të parashikuara, si edhe një nivel të konsoliduar koordinimi ndërinstitucional. Në përfundim të mbledhjes, raporti u konsiderua i miratuar në parim nga Ekipi Tematik dhe pritet të formalizohet përmes urdhrin të Ministrin të shpejti.

Në kuadër të **GRECO - Raundi i Pestë i Vlerësimit**, Shqipëria ka shënuar progres të konsiderueshëm në përmbushjen e rekomandimeve për integritetin e funksioneve ekzekutive të nivelit të lartë dhe të agjencive të zbatimit të ligjit, duke kaluar pragun e mbi dy të tretave të përputhshmërisë. Sipas Raportit të Dytë të Përputhshmërisë, miratuar më 19 mars 2025, 18 nga 24 rekomandime janë vlerësuar si të zbatuara ose të trajtuara në mënyrë të kënaqshme (~75%), ndërsa 5 rekomandime rezultojnë pjesërisht të zbatuara dhe 1 rekomandim i pazbatuar, rrjedhimisht mbeten 6 rekomandime të hapura (iii, iv, vii, viii, ix dhe xix) për ndjekje të mëtejshme. Ky nivel përputhshmërie përkthehet në një vlerësim substancialisht pozitiv për konsolidimin e standardeve të integritetit si për ekzekutivin e nivelit të lartë, ashtu edhe për strukturat e zbatimit të ligjit, ndërsa fokusi vijon të jetë tek mbyllja e rekomandimeve të mbetura për të arritur përputhshmëri të plotë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025, janë miratuar dhe është punuar me prioritet për Planet e Integritetit në lidhje me sektorët me potencial për risk:

- **E drejta e Pronës:** ASHK ka miratuar Planin e Integritetit dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Riskut 2025 – 2027, me Urdhrin Nr. 1219, datë 25.11.2025, të hartuar në bashkëpunim me strukturat kundër korrupsionit.
- **Arsimi:** Plani i Integritetit i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit 2022–2025 ka vijuar zbatimin edhe gjatë vitit 2025, ku nga 29 masa të planifikuara, 27 masa janë zbatuar dhe 2 masa vijojnë në proces. Brenda tremujorit të parë të vitit 2026, u ngrit grupi i punës për Planin e ri të Integritetit 2026-2029, si dhe u hartua Metodologjia e vlerësimit të riskut.
- **Prokurimi Publik:** në Dhjetor 2025 është kryer vlerësimi i riskut të korrupsionit në fushën e prokurimit publik, në zbatim të Metodologjisë së publikuar për vlerësimin e këtij risku dhe brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 po hartohet Plani i Integritetit mbi bazën e gjetjeve dhe rezultateve të këtij vlerësimi.

- **Shëndetësia:** është duke u kryer vlerësimi riskut të korrupsionit në fushën e shëndetësisë dhe brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, po hartohet Plani i Integritetit mbi bazën e gjetjeve dhe rezultateve të këtij vlerësimi.
- **Deklarimi i pasurisë, konflikt interesi dhe llogaridhënia:** Udhërrëfyesi për Rritjen e Efijencës dhe Transparencës së ILDKPKI 2026–2027 u hartua në vitin 2025 dhe synon forcimin e integritetit dhe transparencës institucionale, përmes auditimit të përputhshmërisë me standardet e mbrojtjes së të dhënave dhe krijimit të një “dashboard”-i publik, rritjen e efikasitetit të verifikimeve, përmes zbatimit të një modeli të bazuar në risk dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale, përshejtimin e transformimit digjital përmes përmirësimit të sistemit EACIDS dhe ndërveprimin të të dhënave me institucionet e tjera, si dhe thellimin e bashkëpunimit ndër-institucional e ndërkombëtar me SPAK, KLSH, FIU, GRECO dhe OECD.

- **Në lidhje me kuadrin legjislativ për parandalimin e Korrupsionit:**

Në planin normativ, në kuadër të rritjes së transparencës dhe integritetit në proceset e vendimmarrjes publike, Kuvendi i Shqipërisë në përputhje me *Acquis* të BE-së dhe standardet evropiane, gjatë vitit 2026 miratoi Ligjin Nr. 23/2026, datë 03.02.2026 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i cili forcon integritetin në funksionet publike dhe qartëson detyrimet për zbatim më efektiv, Ligjin Nr. 12/2026, datë 27.01.2026 “Për lobimin”, që vendos rregulla të qarta transparence për marrëdhënien ndërmjet interesave private dhe vendimmarrjes publike si dhe ndryshimet në Ligjin Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, në funksion të përafrimit me Direktivën (BE) 2019/1937 dhe forcimit të mbrojtjes efektive të sinjalizuesve.

Paralelisht, puna për dy nisma të tjera ligjore ka avancuar me objektiv miratimin në vitin 2026. Projektligji “Për financimin e partive politike”, i cili synon rritjen e transparencës dhe mbikëqyrjes së financimeve politike është hedhur për konsultim në faqen zyrtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në datë 01.04.2026 dhe ka përfunduar afatin e Konsultimit Publik më 15.04.2026. Ndërsa sa i përket projektligjit “Për donacionet dhe sponsorizimet”, që synon krijimin e një kornize të unifikuar kombëtare për rregullimin e këtyre marrëdhënieve, është hedhur për Konsultim Publik në datë 14.01.2026 dhe ka përfunduar më 11.02.2026. Ai është duke u konsultuar me shërbimet e Komisionit Evropian dhe institucionet përgjegjëse po vijojnë punën për reflektimin e rekomandimeve dhe përgatitjen për miratim. Këto akte të tëra sëbashku konsolidojnë një kuadër më koherent dhe të parashikueshëm për integritetin publik.

Në fushën e të Drejtave Themelore, gjatë 2025 janë shënuar *arritje të prekshme* në disa nëndrejtime kryesore.

Në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 124/2024, që përafuron në mënyrë të plotë Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 27 prill 2016, “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, dhe për shfuqizimin e Direktivës 95/46/KE, Komisioneri ka miratuar të 10 aktet nënligjore të parashikuara në ligj për zbatimin e tij (të botuara në Fletoren Zyrtare).

Gjithashtu, është konsoliduar më tej kuadri ligjor për garantimin e të drejtave themelore, përmes miratimit nga Kuvendi të një pakete aktesh që synojnë forcimin e barazisë, mosdiskriminimit dhe mbrojtjes nga dhuna, si dhe përmirësimin e garancive për grupet vulnerabël. Në këtë kuadër u miratuan Ligji Nr. 64 “Për barazinë gjinore” (06.11.2025) dhe

Ligji Nr. 92 “Për Kujdesin Alternativ” (18.12.2025), si dhe një sërë ndërhyrjesh të mëtejshme ligjore nëpërmjet miratimit të Ligjit Nr. 22/2026 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010, ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’, i ndryshuar”, Ligjit Nr. 11/2026 “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”. Sa i përket lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias, janë ndërmarrë masa që synojnë rritjen e mbrojtjes praktike të gazetarëve dhe standardizimin e ndërveprimit Polici–Media. Akademia e Sigurisë ka futur në kurrikulën e rishikuar temën “Mbrojtja e Lirisë së Shprehjes dhe Medias”, ndërsa programi i detyrueshëm i trajnimit në shërbim (Urdhri Nr. 1619, datë 12.12.2024) po zbatohet në të gjitha strukturat dhe përfshin module mbi sigurinë e gazetarëve. Paralelisht, është hartuar paketa teknike e “Protokollit për Sigurinë e Gazetarëve”. Në tërësi, këto akte forcojnë koherencën e politikave publike, rrisin standardet e mbrojtjes dhe zgjerojnë instrumentet e parandalimit dhe reagimit, duke mbështetur zbatimin më efektiv të të drejtave në praktikë, veçanërisht për kategoritë vulnerabël.

Në kuadër të sigurimit të qëndrueshmërisë së shërbimeve sociale të strehimit (Strehëzat) dhe të rritjes së mbështetjes buxhetore publike për mekanizmat e dëshmshpërblimit dhe asistencës, financimi për strehëzat është forcuar për vitin 2026, duke garantuar mbulim të plotë të kostove të ushqimit mbi bazën e kapacitetit dhe financim kryesisht ose plotësisht nga fondet publike të pagave të personelit, me qëllim rritjen e vazhdimësisë dhe gatishmërisë operacionale të shërbimit nga ofruesit e shërbimit. Kjo qasje mbështetet nga rritja me 17.6% e Fondit Social, sipas Ligjit të Buxhetit të Shtetit 2026 dhe shoqërohet me monitorim periodik, duke konsoliduar financimin e strukturuar për Strehëzat dhe reduktuar varësinë nga financimet ad hoc. Për Strehëzat e Specializuara të menaxhuara nga OJF-të, kontributi mesatar i shtetit rezulton rreth 68.7% e kostove operative, i kanalizuar kryesisht përmes Fondit Social dhe i llogaritur sipas standardeve të miratuara, dhe kapacitetit të licencuar.

Gjithashtu, në datë 27.01.2026, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 97/2013 “Për Median Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ku është bërë progres i rëndësishëm në drejtim të standardit evropian dhe përafrimit me *Acquis* në lidhje me pronësinë e medias (mospërqëndrimi) dhe transparencën e financimit.

Krahas këtyre masave, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 8, datë 28.01.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 ‘Kodi Penal’”, ku është ndërhyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë për dekriminalizimin e shpifjes për gazetarët, si dhe për marrjen në mbrojtje të gazetarëve për kanosje për shkak të detyrës

Sa i përket garantimit të ushtrimit të detyrës së gazetarit dhe për të siguruar mbrojtje efektive ndaj kanosjes/intimidimit që synon të pengojë raportimin me interes publik, kuadri i ndryshuar penal tashmë parashikon një qasje që ul efektin frenues nga kanosja ndaj lirisë së shprehjes dhe informimit. Në këtë linjë ndryshimet e Kodit Penal kanë për qëllim të sigurojnë parashikimin e një mekanizëm mbrojtës për punën e gazetarëve.

Në fushën e **barazisë dhe mosdiskriminimit**, viti 2025 shënoi hapa të rëndësishëm për forcimin e pavarësisë institucionale, rritjen e transparencës dhe përafrimin me *acquis* të BE-së.

Avokati i Popullit u zgjodh nga Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin Nr. 111/2025, datë 11.12.2025, ndërsa procedura për përzgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi vijon ende. Njëkohësisht, Kuvendi riafirmoi prioritetin për forcimin e kapaciteteve të këtyre institucioneve, përfshirë adresimin e nevojave për burime në kuadër të diskutimeve për Buxhetin 2026. Në planin normativ, ndryshimi i nenit 28 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” u

miratua nga Kuvendi më 05.12.2025. Po ashtu, duke avancuar me agjendën evropiane të BE-së dhe përafrimin e *Acquis* në këtë drejtim, ligji “Për barazinë gjinore” u miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr. 432, datë 31.07.2025 dhe më pas nga Kuvendi më 06.11.2025. Në të njëjtin drejtim, ligji “Për masat kundër dhunës në familje” u miratua më 30.12.2025 nga Këshilli i Ministrave dhe më tej nga Kuvendi në seancë plenare më 27.01.2026.

Në drejtim të procesit të përafrimit me Aktin Evropian të Aksesueshmërisë (Direktiva BE 2019/882), kuadri kombëtar është mbështetur mbi bazën ekzistuese për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara (Ligji Nr. 93/2014), si dhe mbi rregullat e përgjithshme për konformitetin/mbikëqyrjen e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit, megjithatë gjatë vitit 2025 (duke qenë se u bë analiza dhe u përpilua Tabela e Përputhshmërisë) por është vlerësuar se nevojiten dispozita më të detajuara për standardet specifike të aksesueshmërisë për produkte e shërbime, si edhe për kërkesat që lidhen me dokumentimin e përputhshmërisë dhe kontrollin, mbikëqyrjen nga autoritetet përgjegjëse. Në këtë kontekst, MSHMS ka nisur procesin e ndryshimit të Ligjit Nr. 93/2014 për të adresuar boshllëqet dhe për ta përafruar kuadrin me kërkesat e Direktivës 2019/882. Grupi i punës është ngritur me Urdhrin Nr. 623, datë 18.12.2025, dhe Tabela përkatëse e Përputhshmërisë është hartuar. Aktualisht, po punohet që kërkesat e Direktivës të reflektohen edhe në kuadrin për produktet jo-ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit, duke synuar një zbatim më të plotë e të standardizuar të kërkesave të aksesueshmërisë.

**Për të drejtat e fëmijëve**, gjatë 2025 ka patur progres si në drejtim të deinstitutionalizimit, ashtu edhe në forcimin e menaxhimit të rasteve dhe reagimit të hershëm. Aktualisht, procesi i deinstitutionalizimit ka avancuar me ulje të qëndrueshme të numrit të fëmijëve në qendrat rezidenciale publike nga 246 (2021) në 199 (fundi i vitit 2025) dhe me ulje të hyrjeve në institucione nga 60 (2024) në 46 (2025). Moratoriumi për deinstitutionalizimin e fëmijëve 0-2 vjeç ka vijuar të zbatohet (në Durrës dhe Shkodër), ndërsa transformimi ka avancuar në dy qendra rezidenciale (Vlorë dhe Korçë), të cilat po shndërrohen në shërbime komunitare të tipit “Fëmijë dhe Familje”. Njëkohësisht, Plani Kombëtar i Transformimit për 7 institucionet e mbetura është miratuar nga Komiteti Drejtues i Deinstitutionalizimit, me objektiv përfundimin deri në fund të vitit 2026. Në nivel operativ, janë rritur kapacitetet vendore (Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës nga 241 në 370) dhe është intensifikuar menaxhimi i rasteve (p.sh. 2,042 raste, prej të cilave 296 raste të reja), ndërsa linja ALO 116-111 ka forcuar rolin e referimit dhe paralajmërimit të hershëm me 484 raste të këshilluara dhe 328 raste të referuara gjatë vitit 2025. Paralelisht, po vendosen bazat praktike për operacionalizimin dhe zgjerimin e Njësitëve të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NARU/NVV), të cilat aktualisht funksionojnë në 15 bashki, me zgjerim të planifikuar në vitin 2026. Në aspektin ligjor, më datë 18.12.2025, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 92 “Për Kujdesin Alternativ”, i cili vendos kuadrin e unifikuar për kujdesin familjar/komunitar dhe parashikon aktet nënligjore për zbatim të plotë të tij.

**Në lidhje me të drejtën e pronës**, gjatë vitit 2025, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) ka mbajtur në fokus digjitalizimin, rritjen e efikasitetit të shërbimeve kadastrale dhe transparencën, me synim forcimin e sigurisë juridike të të drejtave të pronës, përmirësimin e shërbimit për qytetarët/bizneset dhe përafrimin e proceseve me standardet e BE-së në kuadër të rekomandimeve të BE në progresin me shtetin e së drejtës. Në këtë kuadër, është miratuar Udhërrëfyshi i Digjitalizimit Kadastral, me Urdhrin Nr. 710, datë 9.06.2025, për të përmbyllur digjitalizimin e kartelave, dokumentacionit teknik/ligjor dhe hartave kadastrale, si dhe për të përmbyllur regjistrimin e parë në rang kombëtar. Për kartelat e pronës, pjesa e digjitalizuar është rritur nga 24% (2024) në 80% (dhjetor 2025) (rritje totale +56%), ndërsa 20% e mbetur

parashikohet të përfundojë brenda qershorit 2026. Sa i takon dokumentacionit teknik dhe ligjor, skanimi ka kaluar nga 53.5% (tetor 2024) në 100% (dhjetor 2025), duke shënuar një arritje të plotë të këtij komponenti.

**Për hartat kadastrale**, procesi mbështetet nga projekti i financuar nga BE “EU for Property Rights” i zbatuar nga UNOPS, me synim avancimin me digjitalizimin, në vitin 2026.

**Në drejtim të regjistrimit të parë**, mbulimi kombëtar është rritur nga 90% (2024) në 91.5% (2025), me punë në proces në 151 zona kadastrale me objektiv 96.5% gjatë 2026 dhe perfundim në rang kombëtar, deri në fund të 2027 (me ritëm vjetor të përshpejtuar krahasuar me periudhën pararendëse).

Për të forcuar integritetin institucional dhe me qëllim parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk, ASHK ka miratuar Planin e Integritetit dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Riskut 2025 – 2027, me Urdhrin Nr. 1219, datë 25.11.2025, të hartuar në bashkëpunim me strukturat kundër korrupsionit dhe nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.

**Në fushën e shërbimeve**, digjitalizimi dhe automatizimi kanë vijuar duke vënë në funksion 10 shërbime të automatizuara (5 të shtuara në 2025), ku 10-15% e aplikimeve përpunohen automatikisht në kohë reale. Janë mundësuar tashmë pagesat elektronike. Në 2025 janë ofruar gjithsej 2,436,072 shërbime (rritje +35% krahasuar me 2024).

Në drejtim të formalizimit të drejtave të pronës përmes **legalizimit të ndërtimeve informale**, janë lëshuar gjithsej 291,240 tituj pronësie. Vetëm gjatë vitit 2025 u përpunuan 28,818 aplikime dhe u lëshuan mbi 26,000 tituj (niveli më i lartë që nga 2019, me rritje +230% kundrejt dy viteve paraardhëse).

Ndërkohë, Agjencia e Trajtimit të Pronës (ATP) ka përshpejtuar uljen e numrit të dosjeve që presin kompensimin. Në mënyrë të përmbledhur, deri në fund të 2024 ishin në pritje 7,000 dosje kompensimi nga të cilat, aktualisht janë kompensuar 3,527 dosje me fond total me vlerë ekzekutimi 1.4 miliardë lekë. Nga kjo paketë kompensimi kanë përfituar drejtpërdrejt rreth 13,000 individë dhe familje.

**Në fushën e të drejtave të pakicave kombëtare**, gjatë vitit 2025 ka pasur përparim, me punë të vlerësuar dhe progres të konsoliduar tashmë nga aktet rregullatore (përfunduar së miratuarit në dhjetor 2024), gjatë fazës së zbatimit të tyre në gjashtë drejtime kryesore: (i) forcimi i qeverisjes, procedurave dhe financimit të Komitetit Shtetëror për Pakicat Kombëtare; (ii) operacionalizimi i kuadrit nënligjor të vitit 2024 për vetëidentifikimin dhe njohjen e pakicave, përfshirë funksionimin efektiv të Komisionit për Njohjen e Pakicave Kombëtare; (iii) sigurimi i teksteve shkollorë në gjuhët e pakicave, me mbulim të plotë dhe subvencionim në arsimin bazë; (iv) Shërbimet në sportel në dy gjuhë (Help Desk) në 3 bashki; (v) Avancimi i procesit të regjistrimit të parë, digjitalizimit dhe formalizimit të pronës në bashki me prani të konsiderueshme të pakicave; (vi) emërtesat e rrugëve në dy gjuhë në tre bashki, me prezencë qytetare minoritare mbi 20%.

Kuadri ligjor i Komitetit për Pakicat Kombëtare (KPK) u përforcua përmes ndryshimeve në VKM nr. 286/2019 me VKM nr. 548, datë 01.10.2025, duke parashikuar një proces përzgjedhjeje transparent dhe të bazuar në meritë, proces që u kryesua nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe me përfaqësim ndërinstitucional. Procedura e rishikuar u

zbatua në praktikë me përfundimin me sukses të procedurës së zgjedhjes së Kryetarit të ri, më 29.12.2025.

Në aspektin financiar, janë ndërmarrë hapa konkretë për të forcuar kapacitetin operacional të KPK-së. Financimi për aktivitete të bazuara në projekte u rrit me 200%, nga 41,841 Euro në vitin 2023 në 125,523 Euro në vitin 2025, ndërkohë që buxheti i përgjithshëm i KPK-së u rrit me 28%, nga 514,479 Euro në vitin 2025 në 658,285 Euro në vitin 2026, duke mbështetur qëndrueshmërinë institucionale, rritjen e kapaciteteve dhe zgjerimin e veprimtarisë. Këto masa kontribuojnë në përafrimin me standardet evropiane, përfshirë ato të Këshillit të Evropës dhe Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

Në kuadër të të drejtës për vetë-identifikim dhe zbatimin të kuadrit ligjor për mbrojtjen e pakicave kombëtare Shqipëria ka forcuar kuadrin institucional që garanton ushtrimin e së drejtës për vetë-identifikim dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare, përmes përmirësimit të bazës ligjore, konsolidimit institucional dhe rritjes së mbështetjes buxhetore.

Lidhur me vetë-identifikimin, Komisioni për Njohjen e Pakicave Kombëtare, i ngritur sipas VKM nr. 845/2024, është plotësisht funksional.

Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), janë hartuar materiale udhëzuese për qytetarët, duke forcuar qartësinë procedurale dhe mbështetjen institucionale. Përbërja e Komisionit siguron ekspertizë dhe përfaqësim të balancuar, duke përfshirë përfaqësues nga ministritë përkatëse, Akademia e Shkencave, KPK dhe shoqëria civile.

Deri më sot, Komisioni ka miratuar 355 vendime të konfirmuara, prej të cilave 354 kanë të bëjnë me vetë-identifikime: 202 qytetarë (egjiptianë), 51 qytetarë (romë), 94 qytetarë (bullgarë) dhe 7 qytetarë (malazezë). Gjithashtu, 334 aplikime janë kthyer për plotësim ose sqarim, kryesisht për shkak të aplikimeve nga persona nën moshë ose dokumentacionit të paplotë. Nuk është konstatuar asnjë rast që ka kërkuar verifikim shtesë sipas VKM Nr. 843, ç'ka indikon funksionim të qartë dhe konsistent të procedurës së parashikuar nga VKM, në praktikë.

Në drejtim të ndërgjegjësimit, Këshilli i Evropës ka përfunduar Hartimin e Udhëzuesit për Qytetarët mbi procesin e vetë-identifikimit, i cili po përkthehet në tetë gjuhë të pakicave kombëtare dhe do të shpërndahet për komunitetet përfituese. KPK ka zhvilluar takime me 62 shoqata të pakicave kombëtare në të gjithë vendin. Në bashkëpunim me organizatat vendore, është ofruar asistencë direkte për qytetarët: 100 qytetarë në Elbasan nga Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome; 80 nga Qendra për Drejtësi Sociale; 75 nga Qendra për Avokim Social; dhe 70 nga Qendra për Fuqizim dhe Organizim të Komunitetit. Gjithashtu, gjatë vitit 2026 janë parashikuar të kryhen tre tryeza diskutimi me aktorë vendorë, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, për të mbështetur më tej procesin.

Në kuadër të zbatimit të Ligjit Nr. 96/2017 "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë", në njësitë e qeverisjes vendore ku njerëzit që u përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht e përbëjnë më shumë se 20% të popullsisë së përgjithshme, autoritetet vendore janë të detyruara të krijojnë kushtet e nevojshme për të garantuar përdorimin e gjuhëve të pakicave në marrëdhëniet me organet administrative lokale, arsimin dhe në toponime.

Bazuar në rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë (Census) të vitit 2023, tre bashki përmbushin pragun e mbi 20% të popullsisë që i përket pakicave kombëtare: Finiq, Dropull dhe Pustec.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025 Shqipëria ka shënuar progres lidhur me të drejtat e pakicave, në bashkitë me minoritete mbi 20% të popullsisë së përgjithshme, si më poshtë:

Ofrimi i shërbimeve në gjuhën e pakicave kombëtare - Në bashkitë Dropull, Finiq dhe Pustec shërbimet administrative (sportel) ofrohen edhe në gjuhët përkatëse të pakicave përmes sporteleve dygjuhëshe.

Vendosja e sinjalistikës dygjuhëshe në rrugët kombëtare dhe vendore është realizuar në Dropull, Finiq dhe Pustec, në përputhje me detyrimet e kuadrit nënligjor dhe praktikën vendore.

Shpërndarja e teksteve shkollore në gjuhët e pakicave - Në Dropull, Finiq dhe Pustec shpërndahen tekste në dy gjuhë, në përputhje me të drejtat e pakicave sipas legjislacionit në fuqi. Nxënësit pajisen çdo vit shkollor me tekste falas si në gjuhën e pakicës ashtu edhe në gjuhën shqipe. Për botimin e teksteve të arsimit bazë për pakicat kombëtare është parashikuar një fond i dedikuar nga Ministria e Arsimit.

## **Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”**

Gjatë vitit 2025, në kuadër të Kapitullit 24 “**Drejtësia, Liria dhe Siguria**”, Shqipëria shënoi një progres të dukshëm dhe të qëndrueshëm drejt përmbushjes së **Kushteve të Ndërmjetme (Interim Benchmarks)**, duke forcuar më tej qasjen institucionale në forcimin e shtetit të së drejtës, rritjen e sigurisë publike dhe avancimin e përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian.

Në drejtim të përafrimit ligjor dhe forcimit të kuadrit penal, gjatë vitit 2025 u intensifikua puna për harmonizimin me aktet kyçe të Bashkimit Evropian në fushat e krimit të organizuar, pastrimit të parave, mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi (*online* dhe *offline*), si dhe kontrollit të armëve të zjarrit.

Në këtë kuadër, u krye gjithashtu *përafrimi i plotë* i Kodit Penal përmes miratimit të ndryshimeve të tij, me 7 akte kyçe të BE-së (2001/500/JHA; 2004/757/JHA; Direktivat 2011/36/BE, 2011/93/BE, (BE) 2015/849, (BE) 2017/541, (BE) 2018/1673), si pjesë e përmbushjes së piketave të ndërmjetme të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE, përmes ndërhyrjeve si më poshtë:

- **Pastrimi i parave:** Riformulim i nenit 287 (standarde provuese më të qarta; mjafton të provohet origjina nga vepra penale); rritje e pragueve të dënimit në nene 149/a, 149/b, 180/a.
- **Trafikimi i qenieve njerëzore:** Zgjerim i përkufizimit të “shfrytëzimit” dhe kriminalizim i përdorimit me dashje të shërbimeve të viktimës (neni 110/a); standarde të forta për të miturit (neni 128/b). Përfshirje nga “kriminaliteti i dyfishtë” (neni 6).
- **Mbrojtja e të miturve nga abuzimi/shfrytëzimi:** Dënim shtesë i ndalimit të profesioneve me kontakt me të mitur (neni 30/11); përfshirje nga ndëshkimi i të miturit viktimë (neni 52/a); forcim i neneve 100, 101, 108 dhe riformulim i nenit 117 (përfshirë aksesimin dhe kërkimin përmes TIK); udhëtimet me qëllime seksuale (neni 108/b).
- **Terrorizmi:** Jurisdikcion në rast refuzimi ekstradimi (neni 7/b); zgjerim i listës së akteve (përfshi CBRN dhe IT) dhe sanksionim i kanosjes (neni 230); rekrutimi/trajnimi me rëndim për të mitur (nenet 231–232); nxitja/propaganda (232/a), marrja e trajnimit

(232/a/1), udhëtimi dhe lehtësimi i tij (232/c; 232/ç); rritje e dënimit minimal për pjesëmarrje në organizatë terroriste (234/a).

- **Trafikimi i lëndëve narkotike:** Zgjerim i veprimeve të ndaluara (p.sh. “ofrimi”, “ndërmjetësimi”, “dërgimi në transit”, “shpërndarja”) dhe dënime të rritura kur ka sasi të mëdha/dëmtime serioze shëndetësore (nenet 283, 283/a, 284, 284/c, 284/ç).
- **Liria e medias & siguria e gazetarëve:** Përjashtim nga përgjegjësia penale për shpifje kur gazetarët kur veprojnë me mirëbesim (neni 120); rrethana të posaçme mbrojtjeje nga kanosja/goditja ndaj gazetarëve (nenet 237–238).

Në këtë kontekst, një zhvillim me rëndësi të veçantë ishte nisma për ndryshimet në Kodin Penal, me synim harmonizimin e legjislacionit kombëtar me *Acquis* të BE-së në fusha prioritare të luftës kundër krimit të organizuar dhe forcimit të sigurisë. Në mënyrë të posaçme, ndërhyrja legjislative synon përafrimin me aktet përkatëse të Bashkimit Evropian në fushën e pastrimit të parave, identifikimit, gjurmimit, ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të produkteve të krimit, trafikimit të paligjshëm të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore, abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve, parandalimit dhe kriminalizimit të pastrimit të parave, si dhe luftës kundër terrorizmit.

Ky proces përfshin, ndër të tjera, përafrimin me Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/500/JHA dhe Vendimin Kuadër të Këshillit 2004/757/JHA, me Direktivën 2011/36/BE dhe Direktivën 2011/93/BE, si edhe me Direktivën (BE) 2015/849, Direktivën (BE) 2017/541 dhe Direktivën (BE) 2018/1673.

Ndryshimet u miratuan nga Kuvendi në seancë plenare më datë 27 janar 2026 si pjesë e ndryshimeve në Kodin Penal, duke përbërë një hap domethënës në forcimin e kuadrit penal të vendit dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian.

Shqipëria vendosi një bazë të qëndrueshme normative dhe institucionale për fuqizimin e mekanizmave të rikuperimit të aseteve me origjinë kriminale, përmes miratimit dhe hyrjes në fuqi të kuadrit të posaçëm ligjor për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve.

Në këtë kuadër, u miratua Ligji Nr. 44/2025 “Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve”, i cili siguron themelet për një qasje të standardizuar dhe efektive në identifikimin, gjurmimin, sekuestrimin dhe rikuperimin e të ardhurave nga veprimtaria kriminale dhe përafrimin me *Acquis* të BE-së.

Funksionalizimi institucional u krye përmes miratimit të Strukturës dhe Organigramës së Drejtorisë së Rikuperimit të Aseteve pranë Policisë së Shtetit, me Urdhri Nr. 1494, datë 10.10.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke garantuar qartësinë e rolit institucional, ndarjen e përgjegjësive dhe kapacitete organizative të përshtatshme për zbatimin efektiv të legjislacionit përkatës.

Në vijim, u miratuan edhe aktet rregullatore që mundësojnë përzgjedhjen e drejtuesit, konkretisht Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm Nr. 203, datë 27.11.2025 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përzgjedhjen e kandidatit për Drejtor të Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ZRA)”, si dhe Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 48, datë 07.01.2026, për përzgjedhjen e Drejtorit të Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (ZRA).

Në të njëjtën kohë me Urdhri Nr. 301, datë 19.02.2026, janë miratuar “Procedurat Standarde të Punës” për mbështetjen e procesit të gjurmimit dhe rikuperimit të aseteve nga Zyra e

Rikuperimit të Aseteve (ZRA), në bashkëpunim dhe sipas rekomandimeve të shërbimeve të Komisionit Evropian dhe DBE.

Paralelisht, është evidentuar *përparim i qëndrueshëm* në konsolidimin e rezultateve dhe në rritjen e transparencës në proceset e **sekuestrimit, konfiskimit dhe administrimit të pasurive**, përmes forcimit të kapaciteteve institucionale dhe përmirësimit të instrumenteve të menaxhimit. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë masa konkrete për fuqizimin e mandatit të AAPSK-së<sup>2</sup>, duke përfshirë plotësimin e strukturës së brendshme me burime njerëzore shtesë dhe rritjen e transparencës përmes publikimit online të katalogëve të asetëve të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Me Urdhrin Nr. 163, datë 25.09.2025 të Kryeministrit, u miratuan struktura dhe organika e re e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), duke përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve në 36. Riorganizimi institucional përfshiu forcimin e Drejtorisë së Administrimit, si dhe krijimin e Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve Kombëtare dhe Ndërkombëtare, me synim rritjen e kapaciteteve administrative, përmirësimin e koordinimit ndër-institucional dhe garantimin e një administrimi më efikas dhe profesional të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Çdo aktivitet dhe vendimmarrje e institucionit, si dhe çdo pasuri e disponueshme për dhënie në përdorim apo me qira, është bërë e aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të institucionit dhe promovohet rregullisht në rrjetet sociale, duke garantuar një nivel të lartë transparence dhe informimi publik.

Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe Korrupsionit, gjatë vitit 2025, strukturat e Policisë së Shtetit sekuestruan dhe konfiskuan në total 17,936,029 Euro pa përfshirë 115 asete që ende nuk janë vlerësuar nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), asete të cilat burojnë nga veprimtaria kriminale.

Të ndara sipas bazës ligjore, si më poshtë:<sup>3</sup>

Konkretisht:

- Për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” (neni 287), janë sekuestruar asete në vlerën 8,150,722 Euro. Kjo vlerë nuk përfshin 44 asete të sekuestruara, për të cilat nuk mund të përcaktohet ende vlera.
- Në zbatim të Ligjit Nr. 10192/2009, janë sekuestruar asete në vlerën 8,745,965 Euro.
- Gjatë ushtrimit të kontrolleve janë sekuestruar para cash, në zbatim të neneve 287 dhe 287/b, në shumën rreth 3,335,320 Euro.
- Janë konfiskuar dhe kanë kaluar në favor të shtetit, në 5 raste (me 4 vendime gjyqate), 1,039,342 Euro dhe 22 asete që ende nuk janë vlerësuar nga AAPSK.
- Konfiskime sipas Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar: në 3 raste, janë konfiskuar 1,039,342 Euro dhe 12 asete ende të pavlerësuara nga AAPSK.
- Konfiskime sipas nenit 287 të Kodit Penal, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”: në 2 raste (me 1 vendim gjyqate), janë konfiskuar 10 asete ende të pavlerësuara nga AAPSK.

<sup>2</sup> Shifrat e raportuara nga AAPSK janë me bazë vjetore.

<sup>3</sup> Shifrat e raportuara nga AAPSK janë me bazë vjetore.

Gjithashtu, u konsolidua orientimi strategjik dhe koordinimi ndërinstitucional për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta, me miratimin në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të datës 24.12.2025 të vendimit Nr. 787 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025–2030 dhe të Planit të Veprimit 2025–2028”, duke vendosur një kornizë të qartë politike dhe operacionale për forcimin e kontrollit, gjurmueshmërisë dhe parandalimin e devijimit dhe trafikimit të paligjshëm. Në vijim më datë 28.01.2026, u miratua Ligji “Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve”.

**Në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore,** gjatë vitit 2025 u ndërmorën masa për standardizimin e mbrojtjes dhe forcimin e kapaciteteve ndërinstitucionale. Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të datës 19.12.2025, u miratua vendimi Nr. 772 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, duke konsoliduar një qasje të unifikuar për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave, si dhe duke forcuar garancitë mbrojtëse për grupet më vulnerabël, në veçanti gratë dhe vajzat. Paralelisht, u garantua ngritja e strukturave të planifikimit dhe koordinimit për ciklin e ardhshëm strategjik, përmes Urdhrit Nr. 114, datë 26.08.2025 për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Strategjinë Kombëtare kundër Trafikimit të Personave 2026 - 2030 dhe Planin e Veprimit 2026-2028”.

**Në fushën e drogave dhe substancave psikoaktive,** Shqipëria shënoi një avancim të rëndësishëm institucional në forcimin e kapaciteteve analitike, monitoruese dhe koordinuese, përmes ngritjes së Observatorit Kombëtar të Drogave me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 102, datë 14.07.2025, duke vendosur një strukturë të dedikuar për koordinimin e grumbullimit të të dhënave, raportimit dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, përfshirë EUDA si dhe përmes ngritjes së Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm që funksionon pranë Policisë së Shtetit, në zbatim të Urdhrit Nr. 127, datë 26.07.2024, të Ministrit të Brendshëm, “Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit kombëtar të paralajmërimit të hershëm për substancat e reja psikotrope”, si dhe të Urdhrit Nr. 233, datë 05.12.2024, të Ministrit të Brendshëm “Për disa ndryshime në Urdhrin Nr. 47, datë 14.04.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës në nivel qendror dhe vendor, si dhe të strukturave të posaçme të Policisë së Shtetit”, i ndryshuar, në pjesën që lidhet me këtë sistem.

Në vijim të konsolidimit institucional, gjatë vitit 2025, Njësia e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm u përforcua përmes shtimit të tre punonjësve, përkatësisht drejtuesit të njësisë dhe dy specialistëve, duke rritur kapacitetet operacionale dhe analitike. Gjithashtu, me Urdhrin Nr. 589, datë 18.04.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, u miratuan përshkrimet e detajuara të punës për funksionet e Drejtuesit dhe Specialistit të Njësisë së Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm, duke garantuar qartësi funksionale, përgjegjësi institucionale dhe standardizim të roleve në përmbushje të mandatit të sistemit.

Gjithashtu në kuadër të përafrimit ligjor me standardet e BE-së në fushën kundër drogave në Seancën Plenare të Kuvendit të datës 3.02.2026 u miratuan:

- Ligji Nr. 17/2026 “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 7975, datë 26.7.1995, “Për barnat narkotike, psikotrope dhe të kontrolluara”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 16/2026, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8874, datë 29.3.2002, “Për kontrollin e substancave që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope.

Në fushën e **migracionit, azilit dhe menaxhimit të kufijve të jashtëm**, gjatë vitit 2025 kuadri ligjor *u konsolidua* me miratimin e Ligjit Nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror” dhe me Ligjin Nr. 38/2025, “Për përpunimin e të dhënave të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë” duke forcuar kontrollin kufitar dhe rregullimin e përpunimit të të dhënave të udhëtimit, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Po ashtu, *u forcua* më tej baza ligjore për menaxhimin e migracionit të ligjshëm, përmes miratimit të Ligjit Nr. 43/2025, i cili ndryshon dhe plotëson Ligjin Nr. 79/2021 “Për të huajt”, duke reflektuar orientimin drejt harmonizimit gradual me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Në të njëjtën kohë, Këshilli i Ministrave, në datë 24 Dhjetor 2025, miratoi VKM Nr. 788 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontingjencës për Flukset e Përziera Migratore për vitet 2026–2028”, në përputhje me metodologjinë e EUAA dhe Frontex, duke vendosur bazën për një reagim të parashikueshëm, të koordinuar dhe të harmonizuar me praktikatat e Bashkimit Evropian ndaj flukseve të përziera migratore.

**Sa i takon flukseve të përziera migratore**, gjatë vitit 2025 u evidentua një rënie e migracionit të parregullt. Në këtë kontekst, u ndaluan gjithsej 1.926 migrantë të parregullt, nga të cilët 1.694 migrantë të parregullt të kapur për herë të parë. Ndër ta 126 paraqitën kërkesë për azil; 87 u pajisën me urdhra largimi dhe u transferuan në Qendrën e Mbyllur për ndjekjen e procedurave të ripranimit; 42 u pajisën me urdhra për qëndrim në një territor të përcaktuar; ndërsa, për 1 445 u lëshuan urdhra largimi.<sup>4</sup>

Në drejtim të **përafrimit me politikën e vizave të BE-së**, gjatë vitit 2025 u ndërmorën hapa të qartë për eliminimin gradual të regjimit pa viza me vendet e treta. Shqipëria hartoi Planin për të dalë nga regjimi pa viza me 11 vende të treta që mbas konsultimit me Komisionin Evropian u miratua me Urdhrin e Përbashkët Nr. 652, datë 27 Nëntor 2025, të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Urdhrin e Përbashkët Nr. 260/1, datë 27 Nëntor 2025, të Ministrit të Brendshëm për miratimin e “Udhërrëfyesit të Politikës së Vizave”.

Në përputhje me angazhimet e Planit të Rritjes/Agjendës së Reformave si dhe Kushtet e Ndërmjetme, Shqipëria hartoi Planin e Veprimit Schengen 2026–2030, miratuar me VKM Nr. 44, datë 21.01.2026, i cili përbën të parin plan të këtij lloji dhe vendos një shembull pozitiv për rajonin.

Në tërësi, viti 2025 shënoi një angazhim të konsoliduar politik dhe institucional në kuadër të Kapitullit 24, ku miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore kyçe, i shoqëruar me përmirësimin e mekanizmave të monitorimit të progresit krijoi një bazë më të fortë për rezultate të qëndrueshme dhe të matshme në fushat prioritare të drejtësisë, sigurisë dhe menaxhimit të migracionit, në përputhje me rekomandimet dhe kriteret e Bashkimit Evropian.

### **1.3 Kushtet e Mbyllëse: progresi**

Procesi i negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka hyrë në një fazë të re dhe të avancuar pas hapjes së të gjithë kapitujve, me objektin kryesor gjatë vitit 2025-2026 arritjen e Gatishmërisë Teknike dhe përmbushjen e Kushteve Mbyllëse deri në vitin 2027, përmes një qasjeje të strukturuar dhe të bazuar në prioritizim. Në këtë kuadër, në bashkëpunim

<sup>4</sup> Të dhënat statistikore jepen me baza vjetore.

me Komisionin Evropian, faza e parë e punës intensive për maturim gjatë vitit 2026, përqendrohet në dhjetë kapituj që po shënojnë përparim të konsiderueshëm dhe për të cilët kapaciteti institucional, korniza ligjore dhe masat e planizuara për kapacitetet e zbatimit janë ose mund të jenë brenda këtij viti (objektiv paraprak) shumë pranë niveleve të kërkuara nga Kushtet Mbyllëse të Negociatave të përcaktuara nga BE.

Këta kapituj janë:

- **Kapitulli 30** “Marrëdhëniet me Jashtë”
- **Kapitulli 25** “Shkenca dhe Kërkimi Shkencor”
- **Kapitulli 26** “Arsimi dhe Kultura”
- **Kapitulli 20** “Ndërmarrjet dhe Politika Industriale”
- **Kapitulli 6** “Legjislacioni për Shoqëritë Tregtare”
- **Kapitulli 7** “E drejta e pronësisë intelektuale”
- **Kapitulli 32** “Kontrolli Financiar”
- **Kapitulli 5** “Prokurimi Publik”
- **Kapitulli 4** “Lëvizja e Lirë e Kapitalit”
- **Kapitulli 21** “Rrjetet Trans-Evropiane”

Përveç sa më sipër, punohet paralelisht në të gjitha kapitujt/fushat për Kushtet e Mbylljes së Negociatave nga Bashkimi Evropian, ku në grupin e dytë të Kapitujve mund të veçojmë:

- **Kapitulli 17** “Politika Ekonomike dhe Monetare”
- **Kapitulli 13** “Peshkimi”
- **Kapitulli 9** “Shërbimet Financiare”
- **Kapitulli 31** “Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes”
- **Kapitulli 11** “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”
- **Kapitulli 3** “E Drejta e Vendosijes dhe Liria e Ofrimit të Shërbimeve”

Më poshtë paraqesim informacionin mbi grupin e parë (10 kapituj), sa i përket progresit mbi Kushtet e Mbylljes së Negociatave nga BE, ku:

- **3 kapitujt e parë (30, 25 dhe 26)** progresi i arritur është i tillë që mund të vlerësohet se, në një masë të konsiderueshme, kërkesat teknike të Kushteve Mbyllëse janë përmbushur.
- **4 kapitujt e tjerë (6, 7, 20 dhe 32)** progresi është i avancuar dhe puna vjen duke u përmbyllur për Kushtet Mbyllëse në muajt pasardhës.
- **3 kapitujt e tjerë (4, 5 dhe 21)** ku puna vazhdon me prioritet për plotësimin e Kushteve Mbyllëse dhe ka progres të besueshëm për maturimin e tyre teknikisht brenda këtij viti (objektiv paraprak).

### 1.3.1 Kapitulli 30 - Marrëdhëniet me Jashtë

#### *Kushtet Mbyllëse*

Kushtet mbyllëse (gjithsej: 2) për Kapitullin 30 kërkojnë që: 1) Shqipëria të përafrojë kuadrin e saj ligjor me dispozitat e mbetura të Rregullores (BE) 2021/821 për kontrollin e eksporteve

të mallrave me përdorim të dyfishtë, e ndryshuar, me dispozitat e Rregullores (BE) 2019/452 për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte (FDI), e ndryshuar, si dhe të zbatojë dispozitat e mbetura të Rregullores (BE) 2019/125 për mallrat kundër torturës; 2) Shqipëria duhet t'i paraqesë Komisionit një plan veprimi që përmban një inventar të plotë të marrëveshjeve të saj ndërkombëtare, me qëllim përafrimin e këtyre marrëveshjeve me *Acquis*-in e BE-së që nga dita e anëtarësimit.

### ***Masa Specifike për periudhën (2025)-2026***

Në kuadër të përmbushjes së Kushteve Mbyllëse nën drejtimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, progresi i bërë deri tani për zbatimin e planit dhe adresimin e **Kushtit të parë Mbyllës** “*Shqipëria përafron kuadrin e saj ligjor me dispozitat e mbetura të Rregullores (BE) 2021/821 për kontrollin e eksporteve të mallrave me përdorim të dyfishtë, e ndryshuar, me dispozitat e Rregullores (BE) 2019/452 për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte (FDI), e ndryshuar, si dhe zbaton dispozitat e mbetura të Rregullores (BE) 2019/125 për mallrat kundër torturës.*” paraqitet si më poshtë:

- Janë miratuar tashmë aktet ligjore dhe nënligjore si:
  - **Ligji Nr. 56, datë 03.07.2025, “Për një ndryshim në Ligjin Nr. 7764, datë 2.11.1993, ‘Për investimet e huaja’, i ndryshuar”;**
  - **Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 323, datë 11.06.2025, “Për miratimin e modeleve standarde të autorizimeve individuale, të përgjithshme dhe globale për tregtinë e produkteve që i nënshtrohen kontrollit shtetëror dhe që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturë ose ndëshkim apo trajtim tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, si dhe të formateve të kërkesave për këto dokumente dhe përcaktimin e afateve, procedurave dhe tarifave për lëshimin e autorizimeve”;**
  - **Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 596, datë 15.10.2025, “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare”;**
  - **Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 27, datë 21.1.2026, “Për miratimin e listave të mallrave, që mund të përdoren ose nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime, apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare”;**
  - **Ligji Nr. 29, datë 5.3.2026 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë” i ndryshuar;**
  - **Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.226, datë 1.4.2026 “Për miratimin e rregullores për procedurat e vlerësimit dhe rishikimit të investimeve të huaja të drejtpërdrejta që lidhen me ose që prekin infrastrukturën publike kritike, teknologjinë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, furnizimin me inpute kritike, aksesin në informacion të ndjeshëm ose lirinë e medias”.**

Me sa më sipër, Shqipëria ka përafruar *Acquis* të BE në këtë fushë dhe ka plotësuar kërkesat për veprim të Kushtit të Parë Mbyllës të vendur nga BE për Kapitullin 30 “Marrëdhëniet me Jashtë”. Të gjitha informacionet mbi progresin e arritur i janë paraqitur Komisionit Evropian, i cili bën më tej dhe vlerësimin e përmbushjes së Kushteve Mbyllëse për këtë kapitull, përmes CBAR (Raporti i Vlerësimit të Kushteve Mbyllëse).

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit të dytë Mbyllës** të vendosur për këtë kapitull “*Shqipëria i paraqet Komisionit një plan veprimi që përmban një inventar të plotë të marrëveshjeve të saj ndërkombëtare, me qëllim përafrimin e këtyre marrëveshjeve me *acquis-in* e BE-së që nga dita e anëtarësimit.*” paraqitet si më poshtë progresi:

- Akte të miratuara:
  - **Urdhëri i përbashkët i Ministrisë të Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme Nr. 100 datë 10.2.2026** “Për miratimin e planit të veprimit për përafrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me *Acquis* të Bashkimit Evropian në kuadër të Kapitullit 30 “Marrëdhëniet me Jashtë”.

Në lidhje me Kapitullin 30, Shqipëria tashmë ka arsye të besojë se ka përmbushur në mënyrë të plotë të gjitha masat ligjore dhe nënligjore për adresimin e Kushteve Mbyllëse, duke dëshmuar një nivel serioz përgatitjeje dhe përputhshmërie me *Acquis* të Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, vendi ynë tregon gatishmëri teknike për mbylljen e këtij Kapitulli në kohën e përshtatshme, sipas Metodologjisë së Zgjerimit, si dhe mirëpret vlerësimin e Komisionit Evropian dhe më tej të vendeve anëtare të BE për mbylljen e tij.

### 1.3.2 Kapitulli 25 - Shkenca dhe Kërkimi Shkencor

#### ***Kushtet Mbyllëse***

Kushtet mbyllëse (gjithsej: 3) për Kapitullin 25 kërkojnë që: 1) Shqipëria të sigurojë një rritje të investimeve në kërkim dhe shkencë, veçanërisht me financimin publik, si dhe kapacitetet e nevojshme zbatuese; 2) Shqipëria të demonstrojë se ka krijuar struktura për të forcuar ekosistemet e kërkimit dhe inovacionit, zbatimin e strategjive të specializimit inteligjent dhe masa për të rritur bashkëpunimin midis sektorit privat dhe publik në kërkim dhe inovacion; 3) Shqipëria zbaton Ligjin e ri për Kërkimin Shkencor dhe Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor.

#### ***Masa Specifike për periudhën (2025)-2026***

Në kuadër të përmbushjes së Kushteve Mbyllëse nën drejtimin e Ministrisë së Arsimit, progresi i bërë deri tani për adresimin e **Kushtit të parë Mbyllës** “*Shqipëria siguron një rritje të investimeve në kërkim dhe shkencë, veçanërisht financimin publik, dhe kapacitetet e nevojshme zbatuese.*”, si dhe **Kushtit të tretë Mbyllës** “*Shqipëria zbaton Ligjin e ri për Kërkimin Shkencor dhe Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor.*”, paraqitet si më poshtë:

- Janë miratuar aktet nënligjore **në fushën e shkencës** si:
  - **VKM Nr. 304, datë 28.05.2025** “Për organizimin, funksionimin dhe rastet e lirim të anëtarëve të këshillit kombëtar për shkencën dhe kërkimin shkencor”;
  - **VKM Nr. 793, datë 24.12.2025** “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për përfitimin e kategorisë nga punonjësit kërkimorë-shkencorë”;
  - **VKM Nr. 792, datë 24.12.2025** “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave dhe të procedurave për krijimin, vendosjen nën mbikëqyrje, pezullimin dhe mbylljen e instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor”;
  - **VKM Nr. 831, datë 30.12.2025** “Për miratimin e kodit të etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor”;

- **VKM Nr. 833, datë 30.12.2025**<sup>5</sup> “Për miratimin e standardeve e të kriterëve që mundësojnë zbatimin e parimit të shkencës së hapur dhe janë në përputhje me politikat e zonës evropiane të kërkimit”;
- **VKM Nr. 100, datë 11.2.2026** “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit “Qendër Ekselence”;
- **VKM Nr. 33 datë 21.01.2026** “Për përcaktimin e fushave të rëndësisë së veçantë të kërkimit shkencor për të cilat kërkohet leje e veprimtarisë kërkimore-shkencore, si dhe kriteret e procedurat për lëshimin e lejes”;
- **VKM Nr. 82 datë 06.02.2026** “Për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe elementët e Regjistrit Kombëtar të Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë, si dhe procedurat e krijimit, administrimit të informacionit, si dhe dokumentacioni që depozitohet për regjistrim”;
- **VKM Nr.122, datë 27.02.2026** “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit shqiptar të informacionit të kërkimit shkencor (ACRIS)”;
- **VKM Nr. 174 datë 19.03.2026** “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave, periodicitetit, metodologjisë dhe llojeve të masave për vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të funksionimit të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor të cilat financohen me fonde publike”;
- **VKM Nr. 230 datë 01.04.2026** “Për përcaktimin e modelit të financimit të buxhetit për shkencën dhe kërkimit shkencor”.

Në kuadër të krijimit të bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor, parashikohet zhvillimi i platformës digjitale ACRIS (në zbatimin të VKM Nr.122, datë 27.02.2026, si më sipër), e cila do të mbështesë parimet e shkencës së hapur duke u mundësuar studiuesve akses në botime shkencore, aplikim për fonde dhe përdorim të infrastrukturës kërkimore. Termat e Referencës tashmë janë përfunduar, ndërsa procedura e prokurimit ndodhet aktualisht në fazën e vlerësimit të ofertave. Përfundimi dhe funksionalizimi i plotë i platformës parashikohet të realizohet brenda vitit 2026.

Gjithashtu është në proces miratimi i Projektvendimit “Për disa shtesa në vendimin Nr. 833, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve e të kriterëve që mundësojnë zbatimin e parimit të shkencës së hapur dhe janë në përputhje me politikat e zonës evropiane të kërkimit”.

**Në fushën e inovacionit** janë miratuar aktet nënligjore:

- **VKM Nr. 58 datë 28.01.2026** “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë “Innovation4Albania””.
- **Urdhri i Kryeministrit Nr. 142 datë 29.08.2025** “Për ngritjen e grupit ndërinstytucional për hartimin e planit të veprimit për ta klasifikuar Shqipërinë si “inovator mesatar” në Tabelën Evropiane të Inovacionit” dhe është miratuar **Plani i Veprimit** me Urdhër të Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit Nr. 179 datë 30.12.2025.
- **Urdhri i Ministrit Nr. 667 datë 27.05.2025** “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë së Specializimit Inteligent (S3)”.

<sup>5</sup> Janë draftuar disa shtesa në vendimin Nr. 833, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve e të kriterëve që mundësojnë zbatimin e parimit të shkencës së hapur dhe janë në përputhje me politikat e Zonës Evropiane të Kërkimit”, me qëllim përaftrimin e Rregullores (KE) Nr. 723/2009 për ERIC dhe ndryshimet e saj.

Funksionalizimi i plotë i sistemit dhe strukturës së monitorimit, si dhe përfundimi i metodologjisë përkatëse, priten në gjysmën e parë të vitit 2026.

Zhvillime të tjera mbi angazhimet në kuadër të zbatimit të Kushteve Mbyllëse përfshijnë:

- Përpunimi i të dhënave nga INSTAT për indikatorin GBARD për vitin 2024, ku fondet për kërkim dhe zhvillim në Shqipëri arritën në 0.3% të PBB-së, me trend rritës nga viti 2022 me 0.06 %. Paralelisht, ishte mbledhja e të dhënave për vitin referues 2025, në përputhje me Rregulloren Evropiane, ndërsa të dhënat paraprake priten të transmetohen brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2026.
- Përgatitja e Raportit të parë të monitorimit për Strategjinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit 2023–2030.

**Gjatë vitit 2026, po kryhet:**

Në lidhje me përmirësimin e bashkëpunimit Publik-Privat në Kërkim dhe Inovacion:

- Është ngritur dhe funksionon Këshilli Kombëtar për Inovacionin, tashmë konceptuar dhe dizenuar si një platformë e strukturuar dialogu publik-privat, e frymëzuar nga praktika e Këshillit Evropian të Inovacionit. Me anë të Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit Nr. 138, datë 24.02.2026 është miratuar rregullorja e hollësishme për përbërjen e Këshillit të Inovacionit, kriteret, procedurën e përzgjedhjes, kompetencat dhe organizimin e funksionimit të tij.
- Është ngritur struktura operationale e përbërë nga Koordinatorin i Zbatimit dhe Rrjeti i Pikave Fokale, të cilët sigurojnë monitorimin dhe ndërveprimin institucional.
- Është ngritur Agjencia/ Qendra e Vlerësimit të Shpejtë të Nevojave, që do të mbështesë identifikimin e vazhdueshëm të nevojave të ekosistemit dhe do të informojë politikëbërjen.
- Është krijuar **Startup Albania**, platforma kombëtare digjitale e Shqipërisë për mbështetjen dhe koordinimin e ekosistemit të startup-eve, e cila funksionon si një “one-stop-shop” për ofrimin e shërbimeve, granteve, mundësive të rrjetëzimit dhe promovimit të inovacionit.

Të dhënat tregojnë qartë një rritje të qëndrueshme të financimit për kërkimin shkencor gjatë periudhës 2025–2028, si në nivel total, ashtu edhe në të dy komponentët kryesorë: projektet dhe fondet për shkencën. Në mënyrë të përgjithshme, buxheti total rritet nga rreth **30.9 milion € në 2025** në afro **49.7 milion € në 2028**, që përfaqëson një rritje prej mbi **60%** brenda katër viteve, çka reflekton një angazhim të fortë për ta kthyer kërkimin shkencor në një prioritet strategjik.

Sa i përket **projekteve (financim i brendshëm dhe i huaj)**, ato përbëjnë peshën kryesore të financimit dhe shënojnë një rritje të ndjeshme nga **22.2 milion € në 2025** në rreth **37.0 milion € në 2028**. Kjo tregon një zgjerim të vazhdueshëm të mbështetjes për projekte konkrete kërkimore dhe inovative, me një rritje prej rreth **+66%** deri në fund të periudhës.

Ndërkohë, **fondet për shkencën (shpenzime korrente)** gjithashtu rriten, por me një ritëm më të moderuar nga **8.7 milion € në 2025** në rreth **12.7 milion € në 2028**, çka tregon një përpjekje për të konsoliduar bazën institucionale dhe për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm të sistemit kërkimor.

Përtej angazhimeve buxhetore një numër i konsiderueshëm projektsh strategjike (26 projekte) janë në proces maturimi me qëllim financimin e kërkimit shkencor, ku përmendim:

- Qendra Kombëtare të Informatikës me Performancë të Lartë (AI HPC), në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.
- Qendra së Biosimulimit në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, për forcimin e infrastrukturës së kërkimit mjekësor.
- Qendra e Ekselencës dhe Inovacionit në Nanoteknologji dhe Shkencat Biomarine
- AI4DigiT – Hub-i i Inovacionit Inteligjenca Artificiale për Transformimin Digjital.
- Qendra Kombëtare e Kompetencës në Shqipëri, që krijon një qendër kombëtare për HPC, analizë të të dhënave dhe inteligjencë artificiale në bashkëpunim me EuroHPC, e udhëhequr nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Lista e projekteve paraqet një vizion të gjerë transformimi për Shqipërinë, ku investimet strategjike fokusohen në kërkim shkencor, inovacion, infrastrukturë inteligjente dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Në lidhje me Kapitullin 25, Shqipëria tashmë ka përmbushur në masë të madhe masat ligjore dhe nënligjore për adresimin e Kushteve Mbyllëse, duke dëshmuar një nivel serioz përgatitjeje dhe përputhshmërie me *Acquis* të Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, vendi ynë tregon gatishmëri teknike për mbylljen e këtij Kapitulli në kohën e përshtatshme, sipas Metodologjisë së Zgjerimit, si dhe mirëpret vlerësimin dhe rekomandimet përmbyllëse të Komisionit Evropian dhe më tej të vendeve anëtare të BE për mbylljen e tij.

### 1.3.3 Kapitulli 26 - Arsimit dhe Kultura

#### *Kushtet Mbyllëse*

Kushti Mbyllës (gjithsej: 1) për Kapitullin 26 kërkon që: Shqipëria të demonstrojë se ka të plotë kuadrin institucional dhe politik, si dhe planifikimin përkatës të buxhetit, masat kundër korrupsionit, me qëllim përmbushjen e objektivave të politikave të BE-së në fushat e arsimit dhe trajnimit, duke përfshirë arsimin dhe trajnimin profesional, rininë, sportin dhe kulturën. Kjo përfshin masa për të ngushtuar hendekun me objektivat e përcaktuara në kuadër të Hapësirës Evropiane të Arsimit, dhe ndërtimin progresiv të një sistemi të besueshëm monitorimi, si dhe masa për të nxitur arsimin gjithëpërfshirës, duke përfshirë edhe për grupet vulnerabël.

#### *Masa Specifike për periudhën 2025-2026*

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit Mbyllës**: “*Shqipëria demonstroi se ka krijuar kuadrin e nevojshëm institucional dhe politik, dhe planifikimin përkatës të buxhetit, dhe masat kundër korrupsionit, me qëllim përmbushjen e objektivave të politikave të BE-së në fushat e arsimit dhe trajnimit, duke përfshirë arsimin dhe trajnimin profesional, rininë, sportin dhe kulturën. Kjo përfshin masa për të ngushtuar hendekun me objektivat e përcaktuara në kuadër të Hapësirës Evropiane të Arsimit, dhe ndërtimin progresiv të një sistemi të besueshëm monitorimi, si dhe masa për të nxitur arsimin gjithëpërfshirës, duke përfshirë edhe për grupet vulnerabël.*”, nën drejtimin e Ministrisë së Arsimit, progresi i bërë deri tani për adresimin e tij paraqitet si më poshtë:

Janë miratuar aktet nënligjore:

- **VKM Nr. 733, datë 3.12.2025** “Për miratimin e planit të veprimit të Agjendës Digjitale për Arsimin 2025–2030”, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale.”;
- **VKM Nr. 589, datë 15.10.2025** “Për një ndryshim të VKM Nr. 969 (02.12.2020) mbi kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar Rinor dhe funksionimin e tij”;
- **VKM Nr. 791 datë 24.12.2025** “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për zhvillimin e projekteve arkeologjike nënujore dhe aktiviteteve të tjera që ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazisht në tërësinë e vlerave arkeologjike dhe historike nënujore”;
- **VKM Nr. 832, datë 30.12.2025** “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL)”;
- **VKM Nr. 120, datë 27.02.2026** “Për miratimin e rregullave për organizimin e Programit të Talenteve Rinore, duke përfshirë kriteret, mënyrën e mbështetjes dhe shumën e kompensimit financiar për të rinjtë”;
- **VKM Nr. 121, datë 27.02.2026** “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror të Arsimit Parauniversitar”;
- Është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të datës 19 mars 2026 **Projektligji “Për krijimin e Agjencisë për Shërbimet Arsimore”** (pritet miratimi i projektligjit në Kuvendin e Shqipërisë);
- **Urdhri Nr. 845, datë 03.07.2025** – me anë të cilit miratohet Rregullorja mbi standardet, kriteret dhe procedurat për akreditimin e ofruesve të AFP-së;
- **Udhëzimi Nr. 3, datë 13.08.2025** – i cili parashikon ndryshime në Udhëzimin Nr. 21 (27.06.2022) “Mbi kualifikimin profesional të mësuesve të kulturës profesionale”;
- **Urdhri Nr. 435, datë 04.09.2025** – me anë të cilit miratohet Kodi i Etikës së Mësuesit;
- Në kuadër të zbatimit të plotë të **Ligjit Nr. 79/2017 “Për Sportin”**, janë miratuar dy Vendime të Këshillit të Ministrave:
  - **VKM Nr. 34, datë 21.1.2026** “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të shpërndarjes së grantit për komitetin olimpiq kombëtar shqiptar, komitetin paralimpiq kombëtar shqiptar, organizatën kombëtare antidoping, federatat sportive olimpike, fondacionet sportive, me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit, dhe Këshillin e Arbitrazhit Sportiv”;
  - **VKM Nr. 795, datë 24.12.2025** “Për rregullimin e procedurave të aplikimit, shqyrtimit, përzgjedhjes së projekteve dhe financimit për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Lojërat Olimpike Speciale Shqiptare, federatat joolimpike dhe organizatat sportive përfituese”.
- Me anë të **Urdhrit Nr. 32, datë 03.02.2026** të Zëvendësministrit të Arsimit, është miratuar “Metodologjia dhe instrumentet për proceset gjithëpërfshirëse në arsim”, të cilat krijojnë një kornizë të unifikuar për garantimin e pjesëmarrjes dhe barazisë në institucionet arsimore. Në vijim, po procedohet me përditësimin e kurrikulave për klasat 1, 6 dhe 10 për vitin shkollor 2026–2027, si dhe me hartimin e programeve lëndore për klasat 2, 7 dhe 11, me synim promovimin e diversitetit kulturor dhe përfshirjen e historisë dhe kulturës së komuniteteve romë dhe egjiptiane.

Për të rritur cilësinë e procesit mësimor, do të vijojë marrja e masave për rritjen e numrit të mësuesve të kualifikuar dhe garantimin e disponueshmërisë së teksteve shkollore në të gjitha gjuhët e pakicave, duke forcuar aksesin në arsimin në gjuhën amtare. Mekanizmat e sigurimit të cilësisë janë përmirësuar më tej duke përfshirë një perspektivë më të gjerë të të nxëniet gjatë

gjithë jetës, duke mbështetur zhvillimin e një sistemi AFP-je më fleksibël, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Në këtë kontekst, është miratuar **Udhëzimi Nr. 1 i Ministrisë së Arsimit, datë 10.02.2026**, për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 16, datë 08.05.2018, “Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional”, i ndryshuar.

Ministria e Arsimit ka hartuar edhe një Raport të zbatimit të **Planit të Integritetit 2022–2025** i cili pasqyron progres të qëndrueshëm në forcimin e mekanizmave të integritetit, transparencës dhe parandalimit të korrupsionit. Gjatë periudhës së zbatimit, është regjistruar rritje e dukshme e nivelit të realizimit të masave, duke arritur për vitin 2025 me 93% të masave të planifikuara të zbatuara, si rezultat i konsolidimit institucional dhe digjitalizimit të proceseve. Ky raport i paraprin Planit të Integritetit 2026–2029, i cili synon të forcojë sistemin e menaxhimit të integritetit përmes një qasjeje të strukturuar planifikimi, zbatimi dhe monitorimi afatmesëm. Plani parashikon organizimin e grupeve të punës, identifikimin e proceseve kyçe dhe rreziqeve të integritetit, si dhe përcaktimin e masave konkrete parandaluese dhe korrigjuese me objektiva të matshme, afate kohore dhe përgjegjësi të qarta institucionale.

Në lidhje me sistemin e monitorimit, Inspektoratit Qendror të Arsimit Parauniversitar (IQAP), Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore (AKSHA) dhe Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL) përbëjnë së bashku arkitekturën institucionale dhe dixhitale të monitorimit të besueshëm në sektorin e arsimit. IQAP siguron monitorimin dhe inspektimin e arsimit parauniversitar përmes një strukture të re dhe të operacionalizuar me plan veprimi konkret, AKSHA konsolidon shërbimet arsimore dhe funksionet mbështetëse në nivel sistemi, duke forcuar kapacitetet administrative dhe analitike, ndërsa SMIAL shërben si platforma kombëtare digjitale për menaxhimin, integrimin dhe analizën e të dhënave të arsimit të lartë. Këto tre komponentë, të ndërlidhur funksionalisht, mundësojnë mbledhjen sistematike të të dhënave, raportimin e standardizuar dhe përdorimin e tyre për politikëbërje të bazuar në evidencë.

Për forcimin e kapaciteteve dhe arritjen e objektivave të **Zonës Evropiane të Arsimit**, janë ndërmarrë masa të integruara institucionale, administrative dhe njerëzore, të mbështetura nga plane veprimi sektoriale dhe sisteme monitorimi dixhitale. Këto përfshijnë ngritjen dhe funksionalizimin e strukturave të specializuara për monitorim dhe shërbime arsimore, zhvillimin e kapaciteteve përmes trajnimeve të vazhdueshme profesionale për mësuesit, drejtuesit dhe rrjetet profesionale, si dhe digjitalizimin e formimit fillestar dhe në shërbim, me fokus në kompetencat bazë, digjitale dhe përdorimin etik të inteligjencës artificiale.

Paralelisht, zbatohen masa konkrete për: i) përmirësimin e aftësive bazë dhe digjitale të nxënësve; ii) uljen e numrit të nxënësve me rezultate të ulëta; iii) rritjen e pjesëmarrjes në arsimin e lartë, dhe iv) reduktimin e braktisjes shkollë. Këto masa mbështeten nga mbledhja sistematike e të dhënave, treguesëve të matshëm dhe raportimeve periodike, në funksion të ngushtimit të hendekut dhe përafrimit gradual me standardet e vendosura në Zonën Evropiane të Arsimit.

Në lidhje me Kapitullin 26, Shqipëria tashmë ka përmbushur në masë të madhe masat ligjore dhe nënligjore për adresimin e Kushteve Mbyllëse, duke dëshmuar një nivel serioz përgatitjeje dhe përputhshmërie me *Acquis* të Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, vendi ynë tregon gatishmëri teknike për mbylljen e këtij Kapitulli në kohën e përshtatshme, sipas Metodologjisë së Zgjerimit, si dhe mirëpret vlerësimin dhe rekomandimet për mbyllje të Komisionit Evropian dhe më tej të vendeve anëtare të BE për mbylljen e tij.

### 1.3.4 Kapitulli 20 - Ndërmarrjet dhe Politika Industriale

#### *Kushtet Mbyllëse*

Kushti mbyllës (gjithsej: 1) për Kapitullin 20 kërkon që: Shqipëria të miratojë dhe të fillojë zbatimin e një strategjie gjithëpërfshirëse industriale, si dhe të një politike për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), në përputhje me politikat dhe praktikën përkatëse të Bashkimit Evropian.

#### *Masa Specifike për periudhën 2025 -2026*

Për përmbushjen e Kushtit Mbyllës “*Shqipëria të miratojë dhe të fillojë zbatimin e një strategjie gjithëpërfshirëse industriale dhe një politikë për NVM-të në përputhje me politikat përkatëse të BE-së, si dhe të demonstrojë kapacitete të mjaftueshme administrative dhe koordinim ndërmjet ministrive dhe agjencive përkatëse*”, është punuar për:

- Përafrimin e plotë të **Ligjit Nr. 48/2014** “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, i ndryshuar.” me Direktivën 2011/7/BE, për garantimin e pagesave të shpejta dhe parandalimin e vonesave në transaksionet tregtare. Gjithashtu, përmes ndryshimeve ligjore do të sigurohet që dispozitat e Kodit Civil dhe ndryshimet ligjore përkatëse në Ligjin Nr. 48/2014 të përshtaten plotësisht me standardet evropiane duke rritur dhe lehtësuar pagesat tregtare, si dhe ndërmarrjet të kenë mbrojtje të qartë ligjore ndaj pagesave të vonuara. Sot Shqipëria ka një shkallë të lartë përafrimi dhe po përmbyll përafrimin e plotë.
- Përgatitjen dhe miratimin e **Strategjisë Kombëtare Industriale 2026–2030**, e cila synon të përcaktojë një vizion dhe plan veprimi gjithëpërfshirës për zhvillimin industrial të vendit, në linjë me standardet dhe praktikën më të mira të BE-së, duke orientuar politikat drejt digjitalizimit, tranzicionit të gjelbër, zhvillimit të aftësive dhe mbështetjes së sektorëve prioritarë. Për këtë qëllim është miratuar Urdhri i Kryeministrit Nr.14 datë 30.01.2026 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare Industriale 2026–2030”, si dhe është hartuar analiza dhe orientimi strategjik (metodologjia) dhe po konkludon puna për draftin e parë të dokumentit të Politikës dhe Strategjinë me mbështetjen e asistencës teknike të GIZ.
- Përgatitjen dhe miratimin e **Dokumentit të Politikave Kombëtare për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme**, i cili synon fuqizimin e NVM-ve përmes një politike kombëtare të qëndrueshme, duke ofruar instrumente financiare dhe jo-financiare, mekanizma për monitorimin e performancës dhe mbështetje për inovacionin dhe integrimin në tregun e përbashkët. Për këtë qëllim është miratuar Urdhri i Kryeministrit Nr.14 datë 30.01.2026 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional i Punës për hartimin e Politikave Kombëtare për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme”.

Të dy këto dokumente të rëndësishme politikëbërëse do të konsultohen gjerësisht me grupet e interesit, gjithashtu dhe me Komisionin Evropian, duke synuar përgatitjen brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2026.

Gjithashtu, në përmbushje të piketës me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe mekanizmave koordinues, synohet garantimi i një kuadri funksional dhe efektiv për zbatimin e politikave. Në këtë drejtim, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit po punon për të siguruar që në të dy strategjitë do të jenë pjesë: parashikimi i Mekanizmave koordinues, si dhe Struktura e monitorimit dhe vlerësimit, për të garantuar zbatimin e politikave industriale dhe atyre për NVM-të të koordinuar e harmonizuar me aktet e Bashkimit Evropian, dhe për të siguruar një transformim evropian industrial të qëndrueshëm të ekonomisë shqiptare.

### 1.3.5 Kapitulli 6 – Legjislacioni për Shoqëritë Tregtare

#### *Kushtet Mbyllëse*

Kushtet Mbyllëse (gjithsej: 4) për Kapitullin 6 kërkojnë që: 1) Shqipëria të sigurojë një nivel të konsoliduar përafrimi me *acquis-në* të BE-së në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, duke përfshirë harmonizimin e plotë me dispozitat e përgjithshme që rregullojnë themelimin, funksionimin dhe transformimet e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, si dhe procedurat kombëtare e ndërkufitare të bashkimeve dhe ndarjeve të shoqërive. Gjithashtu; 2) kërkohet përafrim i plotë me Direktivën për të Drejtat e Aksionarëve dhe me Direktivën për Marrjen e Kontrollit, si dhe që Shqipëria do të jetë në gjendje të zbatojë Direktivën e Kujdesit të Duhur për Qëndrueshmërinë e Korporatave, në momentin e anëtarësimit. Në fushën e tregjeve të kapitalit dhe raportimit financiar; 3) Shqipëria duhet të ketë harmonizuar legjislacionin përkatës me *acquis* - duke përfshirë versionin më të fundit të Direktivës së Transparencës dhe Direktivën e Kontabilitetit - së bashku me aktet zbatuese. Së fundi, 4) kërkohet përafrim i plotë i kuadrit ligjor dhe zbatues për auditimin, në përputhje me versionin më të fundit të Direktivës së Auditimit, duke garantuar një sistem mbikëqyrjeje publike që siguron funksionim të besueshëm dhe të pavarur të mekanizmave të cilësisë, hetimeve dhe sanksioneve, veçanërisht për auditimet e enteve me interes publik.

#### *Masa Specifike për periudhën (2025)-2026*

Në kuadër të përmbushjes së Kushteve Mbyllëse, nën drejtimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, janë planifikuar dhe zbatuar masa për rishikimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor për shoqëritë tregtare dhe auditin dhe pasqyrat financiare.

Në përmbushje të **Kushtit të parë Mbyllës** “*Shqipëria ka përafruar legjislacionin e saj me dispozitat e përgjithshme të *acquis* të BE-së për të drejtën e shoqërive tregtare dhe themelimin dhe funksionimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, bashkimet dhe ndarjet në nivel kombëtar, si dhe shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare.*”, janë përgatitur 8 akte përafruese (7 projektligje dhe 1 projektvendim) të cilat i janë dërguar Komisionit Evropian për opinion. Të gjitha të përafruara plotësisht me *acquis*-in përkatës të BE-së, më konkretisht:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008, ‘Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare’”. Kjo nismë synon të sigurojë përputhshmëri të ligjit shqiptar me *acquis* i Bashkimit Evropian, duke krijuar një mjedis ligjor më të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe transparent për bizneset dhe investitorët si dhe lehtësimin e operacioneve tregtare, në kuadër të Tregut të Brendshëm të BE-së.
- Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007, ‘Për regjistrimin e bizneseve’, i ndryshuar”: Ky projektligj ka si qëllim transpozimin e avancuar të kërkesave të *acquis*-it të Bashkimit Evropian në fushën e regjistrimit të biznesit dhe të drejtës së shoqërive tregtare, në veçanti atyre që lidhen me përdorimin e

mjeteve digjitale dhe ndërlidhjen e regjistrave. Njëpërmjet kësaj nisme synohet harmonizimi i legjislacionit shqiptar me Direktivat (BE) 2017/1132 dhe 2019/1151, si dhe zbatimin e plotë të Rregullores (BE) 2021/1042, me fokus në: (i) mundësimin e regjistrimit elektronik të shoqërive dhe procedurave të tjera përmes sportelit elektronik; (ii) njohjen e mjeteve të identifikimit elektronik të lëshuara nga vendet anëtare të BE-së; (iii) krijimin e formateve standarde për aktet e themelimit/statutet dhe përdorimin e tyre gjatë regjistrimit elektronik; (iv) ndërlidhjen e Regjistrimit Tregtar shqiptar me sistemin e ndërlidhjes së regjistrave të biznesit të BE-së (BRIS); dhe (v) përmbushjen e standardeve teknike të unifikuara të përcaktuara nga legjislacioni evropian.

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 131/2015, datë 26.11.2015, ‘Për Qendrën Kombëtare të Biznesit’”: Qëllimi kryesor i këtij projektligji është transpozimi në legjislacionin shqiptar i kërkesave më të fundit të acquis-it të së Bashkimit Evropian në fushën e regjistrimit të biznesit dhe shoqërive tregtare. Në veçanti, projektligji synon integrimin e elementeve të reja të Direktivës (BE) 2019/1151 (që ndryshon Direktivën 2017/1132) dhe të Rregullores (BE) 2021/1042 në ligjin Nr. 131/2015, duke përmirësuar përdorimin e mjeteve digjitale dhe ndërlidhjen ndërmjet regjistrave tregtarë. Kjo nismë parashikon lidhjen e Regjistrimit Tregtar shqiptar me sistemin evropian BRIS (Business Registers Interconnection System) dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave me regjistrat e vendeve të BE-së.
- Projektligji “Për shndërrimin, bashkimin dhe ndarjen ndërkufitare të shoqërive tregtare”: Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i një kuadri të plotë ligjor që rregullon kushtet, procedurat dhe pasojat juridike të shndërrimeve, bashkimeve dhe ndarjeve ndërkufitare ndërmjet shoqërive tregtare shqiptare dhe atyre të vendeve të Bashkimit Evropian. Projektligji përcakton rregulla të unifikuara për kryerjen e këtyre operacioneve ndërkufitare, duke garantuar siguri juridike, transparencë dhe trajtim të barabartë për subjektet e përfshira. Një objektiv themelor është përafrimi i legjislacionit shqiptar me standardet e BE-së – konkretisht transpozimi i Direktivës (BE) 2019/2121 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e cila ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 sa i përket këtyre operacioneve.
- Projektligji “Për Statutin e Shoqërive Evropiane (SE)”: Qëllim kryesor është krijimi i kuadrit ligjor të brendshëm për njohjen dhe funksionimin e formës evropiane të shoqërisë aksionare – Societas Europaea (SE) – në Republikën e Shqipërisë. Me anë të këtij akti synohet transpozimi i plotë në ligjin shqiptar i Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 2157/2001, datë 8 tetor 2001 “Për statutin e Shoqërisë Evropiane (SE)”, së bashku me zbatimin e kërkesave të Direktivës 2001/86/EC të Këshillit, datë 8 tetor 2001, “Për plotësimin e statutit të Shoqërisë Evropiane në lidhje me përfshirjen e punëmarrësve”. Kjo ndërhyrje ligjore vjen si nevojë e domosdoshme për të adresuar boshllëkun aktual ligjor: Shqipëria deri më sot nuk ka pasur dispozita për Shoqëritë Evropiane, çka do të lehtësojë ndërmarrjet aktive shqiptare të përfitojnë nga operacionet ndërkufitare dhe lehtësitë që ofron Tregu i Përbashkët evropian.
- Projektligji “Për Grupimet Ekonomike me Interes Evropian”: Projektligji krijon bazën ligjore për themelimin dhe funksionimin e Grupimeve Ekonomike me Interes Evropian (GEIE) në Shqipëri, duke transpozuar plotësisht Rregulloren (EEC) Nr. 2137/85. Ai synon të lehtësojë bashkëpunimin ekonomik ndërkufitar, të rrisë konkurrencën dhe inovacionin, duke eliminuar pengesat ligjore e fiskale ndaj partneriteteve me subjektet e BE-së.
- Projektligji “Për Shoqëritë Evropiane të Bashkëpunimit”: Projektligji krijon kuadrin e posaçëm ligjor për themelimin dhe funksionimin e Shoqërisë Evropiane të Bashkëpunimit në Shqipëri, duke transpozuar plotësisht Rregulloren (KE) 1435/2003 dhe Direktivën 2003/72/EC. Ai synon të eliminojë pengesat ligjore për

bashkëthemelimin e shoqërive të bashkëpunimit me partnerë nga BE-ja, të garantojë standardet evropiane për përfshirjen e punëmarrësve dhe të integrojë parimet bashkëpunuese (si kontrolli demokratik dhe anëtarësia vullnetare) në legjislacionin shqiptar. Me këtë nismë forcohet qasja e ndërmarrjeve shqiptare në Tregun e Brendshëm evropian dhe promovohet zhvillimi social-ekonomik gjithëpërfshirës.

- Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 391, datë 3.5.2017, ‘Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit’”: Projektvendimi synon digjitalizimin dhe modernizimin e procedurave të regjistrimit në QKB, përmes harmonizimit me *acquis-in* e BE-së. Ai forcon shkëmbimin ndërkufitar të informacionit, rrit transparencën dhe mbrojtjen e ortakëve/aksionarëve, si dhe siguron administrim më të qartë të shoqërive.

Jemi në komunikim me Komisionin Evropian për të marrë rekomandimet e shërbimeve të Komisionit mbi aktet përafruese të *Acquis* dhe saktësinë dhe mjaftueshmërinë e këtyre ndryshimeve ligjore të propozuara përkundrejt Kushtit Mbyllës të përcaktuar nga BE. Kjo paketë aktesh e draftuar në nëntor 2025, ka përfunduar edhe procesin e konsultimit publik dhe është në fazë të avancuar të bashkërendimit me ministritë dhe institucionet që japin mendim, dhe mbas pranimit nga shërbimet e Komisionit Evropian do të kalojë për shqyrtim e miratim pranë Këshillit të Ministrave e më tej në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Në përmbushje të **Kushtit të dytë Mbyllës** “*Shqipëria ka përafruar legjislacionin e saj me Direktivën për të Drejtat e Aksionarëve, të ndryshuar, Direktivën për Marrjen e kontrollit dhe siguron që ajo do të jetë në gjendje të zbatojë Direktivën e Kujdesit të duhur për Qëndrueshmërinë e Korporatës nga data e aderimit.*” janë marrë masat për hartimit e Ligjit “Për tregjet e kapitalit” dhe akteve nënligjore zbatuese, duke siguruar përputhje të plotë me Direktivën për të Drejtat e Aksionarëve (2007/36/EC), Direktivën për Ofertat Publike të Blerjes (2004/25/EC) dhe përgatitjen e kuadrit për zbatimin e Direktivës për Kujdesin e Qëndrueshëm të Korporatave (CSDDD) pas anëtarësimit. Në këtë kuadër, është parashikuar miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 236, datë 18.2.2010 “Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike”, i cili ka përfunduar edhe procesin e konsultimit publik, dhe synon të përafrojë ligjin shqiptar për ofertat e marrjes në kontroll me *acquis*-në e BE-së, duke rritur sigurinë juridike, mbrojtjen e aksionarëve dhe transparencën e tregut dhe duke e afruar Shqipërinë me standardet e Tregut të Brendshëm evropian. Paketa e projektligjit, që synon përafrimin e plotë me Direktivën 2004/25/KE për ofertat publike të blerjes, si dhe Plani i Veprimit për përafrimin dhe zbatimin efektiv të Direktivës (BE) 2024/1760 për kujdesin e duhur të qëndrueshmërisë së korporatave, janë hartuar tashmë dhe janë dërguar për shqyrtim dhe konsultim pranë Komisionit Evropian.

Në përmbushje të **Kushtit të tretë Mbyllës**: “*Shqipëria ka harmonizuar Ligjin e saj për Tregjet e Kapitalit dhe legjislacionin përkatës zbatues, me *acquis* që përfshin versionin më të fundit të Direktivës së Transparencës, dhe gjithashtu ka harmonizuar regjimin e tij të raportimit financiar, duke përfshirë legjislacionin zbatues, me *acquis* që përfshin Direktivën e Kontabilitetit, i ndryshuar*” janë marrë masat për hartimin e Projektligjit “Për Kërkesat e Transparencës për Emetuesit e Titujve” dhe Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”” në përputhje me *acquis-in* e BE-së në këtë fushë, përfshirë versionet më të fundit të Direktivës së Kontabilitetit (2013/34/EU) dhe Direktivës së Transparencës (2004/109/EC). Konkretisht, të dy projektligjet janë në proces konsultimi publik: Projektligji “Për Kërkesat e Transparencës për Emetuesit e Titujve” përfundon procesin e konsultimit publik në datë 20 prill 2026, ndërsa Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat

financiare”” përfundon procesin në datë 30 prill 2026 për të vijuar me tej me shqyrtimin dhe miratimin në Këshillin e Ministrave dhe në Kuvend.

**Në fushën e Auditimit Ligjor**, në përmbushje të **Kushtit të katërt Mbyllës**: “*Shqipëria ka përafruar legjislacionin e saj ligjor të auditimit, duke përfshirë legjislacionin zbatues, me versionin më të fundit të Direktivës së Auditimit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet, kur organizohet sistemi i mbikëqyrjes së auditimit publik, për të siguruar që sigurimi i cilësisë, hetimet dhe sanksionet në lidhje me auditimet ligjore, veçanërisht ato të enteve me interes publik, kryhen nga autoriteti kompetent përgjegjës për mbikëqyrjen e auditimit*”, Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) ka miratuar Rregulloren “Për procedurat dhe rregullat e mbledhjes së të ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, e publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 158 datë 08.09.2025. Kjo Rregullore synon forcimin e kapaciteteve nëpërmjet përmirësimit dhe qartësisimit të procedurave dhe rregullave të mbledhjes së të ardhurave, sipas burimeve të financimit të veprimtarisë të përcaktuara në nenin 4/1 të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Më tej, janë miratuar edhe dy rregullore të tjera, me qëllim përafrimin e mëtejshëm me standardet e BE-së:

- Rregullore për Hetimin dhe Procedurat për Vendosjen e Masave Disiplinore (miratuar me Vendimin Nr. 43, datë 30.09.2025, të Bordit të Mbikëqyrjes Publike)
- Rregullore për Procedurat e Kryerjes së Kontrollit të Sigurimit të Cilësisë, si dhe për Organizimin dhe Funksionimin e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë për Audituesit Ligjorë dhe Shoqëritë e Auditimit (miratuar me Vendimin Nr. 44, datë 30.09.2025, të Bordit të Mbikëqyrjes Publike).

Në kuadër të procesit të harmonizimit dhe raportimit për përafrimin me *Acquis*-in e BE-së, Komisionit Evropian i është përcjellë një Analizë e Detajuar e Sistemit të Mbikëqyrjes së Auditimit në Shqipëri, e cila përfshin vlerësimin e kapaciteteve aktuale administrative dhe teknike për zbatimin e legjislacionit të BE-së. Dokumenti paraqet nivelin e gatishmërisë institucionale, strukturat ekzistuese, si dhe sfidat dhe nevojat për forcimin e mëtejshëm të sistemit në përputhje me standardet evropiane. Gjithashtu, Komisionit Evropian i është dërguar për vlerësim VKM Nr.17, datë 16.1.2019 “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private me interes publik, për shkak të natyrës së veprimtarisë së tyre, madhësisë ose numrit të punonjësve”, i ndryshuar, si dhe Rregullorja për bashkëpunimin ndër-institucional brenda vendit dhe ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacionit, miratuar me Vendim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike Nr. 55, datë 26.11.2025. Përmes këtyre akteve është arritur përafrim i plotë me Direktivën 2006/43/EC për auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore dhe të konsoliduara, dhe Rregulloren (EU) No 537/2014 për kërkesat specifike lidhur me auditimin ligjor të njësisve me interes publik.

### 1.3.6 Kapitulli 7 – E Drejta e Pronësisë Intelektuale

#### ***Kushtet Mbyllëse***

Kushtet mbyllëse (gjithsej: 3) të Kapitullit 7 kërkojnë që: 1) Shqipëria të ndërmarrë të gjitha ndryshimet e nevojshme legjislative për të siguruar shterimin e të drejtave të BE-së/ZEE-së në

të gjitha fushat, që nga data e anëtarësimit; 2) Legjislacioni i saj duhet të jetë i përafëruar me *acquis* mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme, të drejtat e pronësisë industriale dhe zbatimin e Pronësisë Intelektuale; 3) Shqipëria duhet të sigurojë kapacitete të mjaftueshme administrative për të regjistruar të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të sigurojë një historik solid të zbatimit efektiv nga autoritetet përkatëse administrative, përmes drejtësisë civile dhe, kur është e përshtatshme, edhe përmes drejtësisë penale.

### **Masa Specifike për periudhën 2025 -2026**

Në kuadër të përmbushjes së Kushteve Mbyllëse, nën drejtimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, progresi i bërë deri tani për zbatimin e planit dhe adresimin e **Kushtit të parë Mbyllës** “*Shqipëria ndërmerr të gjitha ndryshimet e nevojshme legislative për të siguruar shterimin e të drejtave të BE/ZEE në të gjitha fushat që nga data e anëtarësimit.*” paraqitet si më poshtë:

- Akte të miratuara:
  - **Ligji Nr. 52/2025** “Për markat tregtare” është miratuar në datën 3.07.2025 dhe publikuar në fletoren zyrtare me Nr. 138, datë 1.08.2025. Ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 16.08.2025.
  - **Ligji Nr. 53/2025** “Për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë” është miratuar në datën 3.07.2025 dhe publikuar në fletoren zyrtare me Nr. 138, datë 1.08.2025. Ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 16.08.2025.

Janë hartuar dy projektligjet, akte përafëruese me *Acquis* të BE, konkretisht:

- **Projektligji “Për dizenjot”**, që synon mbrojtjen e dizenjove nëpërmjet regjistrimit të këtyre dizenjove dhe dhënien e të drejtave ekskluzive mbajtësve të tyre në përputhje me *acquis*.
- **Projektligji “Për Treguesit Gjeografikë për produkte artizanale dhe industriale”**, që synon mbrojtjen e treguesve gjeografikë për produktet artizanale dhe industriale, në veçanti duke përcaktuar dispozita që lidhen me detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e nevojshme për prodhuesit për të menaxhuar treguesit gjeografikë, duke përfshirë edhe përgjigjen ndaj kërkesave shoqërore për produkte të qëndrueshme.

Projektligjet kanë përfunduar konsultimin publik dhe janë në fazën fundore të bashkërendimit, marrjes së mendimeve nga Ministrinë përkatëse, si dhe i janë dërguar më herët për mendim mbi tekstin përafëruar dhe përshtatshmërinë, Komisionit Evropian, me të cilin institucionet kanë patur tashmë këmbime mbi adresimin e rekomandimeve të tyre dhe masave përplotësuese. Dy projektligjet do të paraqiten së shpejti për shqyrtim dhe miratim fillimisht pranë Këshillit të Ministrave dhe më tej Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit të dytë Mbyllës** “*Shqipëria ka përafëruar legjislacionin e saj me *acquis-in* për të drejtat e pronësisë intelektuale, veçanërisht për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, të drejtat e pronësisë industriale dhe zbatimin e pronësisë intelektuale*” paraqitet si më poshtë:

Është miratuar:

- **Ligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Marakeshit”**, publikuar në Fletoren Zyrtare me Nr. 238 datë 23.12.2025, i cili synon të përcaktojë përdorime të caktuara të lejuara të veprave të caktuara dhe lëndëve të tjera të mbrojtura nga të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, në dobi të personave të verbër, me shikim të kufizuar ose me aftësi të kufizuara në lexim si dhe në harmonizim me disa aspekteve të të drejtave

të autorit dhe të drejtave të lidhur me to në shoqërinë e informacionit. Ligji i miratuar i është përcjellë Komisionit Evropian në datë 18.02.2026.

- Është hartuar tashmë projektligji, akti përafrues, **“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”**, i cili synon vijimin e përafrimit të ligjit ekzistues, për të përcaktuar rregullat mbi ushtrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të (si psh. në përputhje me *acquis*-in për transmetime të caktuara online dhe ritransmetime të programeve televizive dhe radiofonike, në përputhje me *acquis*-in për licencime të detyrueshme etj). Procesi i konsultimit publik për këtë projektligj si dhe bashkërendimi ndër-institucional, për dhënien e mendimeve nga Ministrinë, ka përfunduar. Drejtoria e të Drejtës së Autorit është në proces të akomodimit të komenteve të KE duke patur disa këmbime me shërbimet e Komisionit Evropian. Ky projektligj së shpejti do të paraqitet për shqyrtim dhe miratim fillimisht në Këshillin e Ministrave dhe më tej në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit të tretë Mbyllës** *“Shqipëria garanton kapacitete të mjaftueshme administrative për të regjistruar të drejtat e pronësisë intelektuale dhe krijon një historik solid “track record” të zbatimit efektiv nga autoritetet përkatëse administrative, dhe nëpërmjet drejtësisë civile dhe, sipas rastit, penale”* paraqitet si më poshtë:

- Janë miratuar aktet:
- **Vendimi Nr. 6 datë 12.02.2026 i Këshillit Mbikëqyrës të DPPI “Mbi miratimin e projekt-strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale”** - struktura e re e riorganizimit institucional të pronësisë industriale. Struktura e miratuar i është dërguar shërbimeve të Komisionit Evropian për njoftim në datë 12.03.2025, duke vënë në dukje masat për forcim të kapaciteteve institucionale dhe zbatuese në këtë fushë.
- Në proces përgatitjeje:
- **Miratimi i Projekturdhrit “Për riorganizimin institucional në kuadër të pronësisë industriale”** me anë të së cilit synohet reformë institucionale dhe riorganizimi i Drejtorisë së Pronësisë Industriale. Struktura ka kaluar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të DPPI në datë 12.02.2025.
- Parashikuar krijimi i një baze të dhënash (*dashboard*) për monitorimin e zbatimit të të drejtave të autorit: Përpiluar një listë bazë me të dhënash në fushën e pronësisë intelektuale e cila do të konsultohet më pas me Komisionin Evropian. Ky *“dashboard”* synon që të tregojë kapacitetet zbatuese të nevojshme, mbi një sistem efektiv të zgjidhjes gjyqësore të mosmarrëveshjeve mbi të drejtat e pronësisë intelektuale dhe kapacitete të mjaftueshme inspektimi mbi të drejtat e pronësisë intelektuale. Aktualisht baza e të dhënave është pasuruar me të dhëna statistikore të gjeneruara nga institucionet kontribuese /raportuese. Drafti është në fazë konsolidimi.

Të tjera masa në përmbushje të detyrimeve të piktetës:

- **Miratimi i Projekvendimit ‘Për ngritjen e kapaciteteve në fushën e të drejtës së autorit’** me anë të së cilit synohet reformë institucionale dhe riorganizimi i Drejtorisë së të Drejtës së Autorit.
  - Janë parashikuar të merren masa për planifikimin sipas Ligjit Nr. 9936/2008 datë 26.06.2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar’;

- Kanë vijuar procedurat e firmosjes së Memorandumeve të Mirëkuptimit me institucionet ISHMT, AMA (dërguar në datë 12.03.2026 i firmosur për firmë tek institucioni kundërfirmues).
- Memorandum i Mirëkuptimit me AKEP do të firmoset pas miratimit të amendimeve në Ligjin 35/2016 “Për të drejtën e autorit”.

### 1.3.7 Kapitulli 32 – Kontrolli Financiar

#### *Kushtet Mbyllëse*

Kushtet mbyllëse (gjithsej: 4) për Kapitullin 32 kërkojnë që: 1) “Shqipëria të ketë kapacitete të mjaftueshme administrative dhe institucionale në të gjitha nivelet si dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e legjislacionit kombëtar mbi kontrollin e brendshëm financiar publik; 2) Në fushën e auditit të jashtëm, kërkohet që Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) të veprojë në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI); 3) Në fushën e mbrojtjes së interesave financiare të BE-së kërkohet që Shqipëria të sigurojë një bazë ligjore gjithëpërfshirëse për ruajtjen e konfidencialitetit të hetimeve të OLAF-it dhe të ketë kapacitetet e mjaftueshme operacionale për shërbimin e saj kombëtar të koordinimit kundër mashtrimit. Shqipëria duhet të zbatojë në mënyrë efektive Strategjinë Kombëtare Kundër Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Shqipëria koordinon në mënyrë efektive aktivitetet kundër mashtrimit dhe ka një historik të qëndrueshëm bashkëpunimi me Komisionin, OLAF-in dhe Zyrën e Prokurorit Publik Evropian (EPPO) në lidhje me parregullsitë e raportuara dhe çështjet e hetimit që përfshijnë fondet e BE-së për të përmbushur plotësisht detyrimet e tyre; 4) Në fushën e mbrojtjes së Euro nga falsifikimi, kërkohet që Shqipëria të zbatojë Konventën Ndërkombëtare të Gjenevës të vitit 1929 për ndalimin e falsifikimit të monedhës, si dhe të përafrojë legjislacionin e saj me acquis të BE-së për verifikimin e autenticitetit të monedhave Euro dhe për trajtimin e monedhave dhe kartëmonedhave euro të papërshtatshme”.

#### *Masa Specifike për periudhën 2025-2026*

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit të parë Mbyllës** – “*Shqipëria ka kapacitete të mjaftueshme administrative dhe institucionale në të gjitha nivelet si dhe merr masat e nevojshme për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e legjislacionit kombëtar mbi kontrollin e brendshëm financiar publik*” - janë miratuar aktet nënligjore, si më poshtë:

1. **Urdhri i Ministrisë të Financave Nr. 49/1, datë 21.10.2025** “Për Miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Performancës së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.
2. **Urdhri i Ministrisë të Financave Nr. 103, datë 23.07.2025** "Për miratimin e standardeve globale të auditimit të brendshëm të pranuar për zbatim në sektorin publik në Republikën e Shqipërisë".
3. **Urdhri i Ministrisë të Financave Nr. 134, datë 17.10.2025** “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm”.
4. **Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 311, datë 04.06.2025** “Për miratimin e Komisionit të Kualifikimit të Auditimit të Brendshëm”. Komisioni i ri i Auditimit të Brendshëm hyri në fuqi në shtator 2025, duke hedhur bazat për zbatimin e Programit të Certifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik.
5. **Urdhri i Ministrisë të Financave Nr. 159, datë 22.12.2025** “Për hapjen e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, për sezonin 2026”.

Gjatë vitit 2025, aktivitetet janë përqendruar në forcimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP), duke rritur njëkohësisht kapacitetet administrative dhe institucionale në të gjitha njësitë publike. Në këtë kuadër, u përgatitën dhe u publikuan dokumente kyçe, veçanërisht **Raporti Vjetor i KBFP-së dhe Metodologjia e Vlerësimit të Performancës së KBFP-së** për njësitë publike, të cilat kontribuan me masa për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe menaxhimit të shëndoshë të financave publike.

Viti 2025 shënoi gjithashtu një rritje të mëtejshme të vendimeve të delegimit. Nga 7 vendime të lëshuara në vitin 2023, numri arriti në 10 vendime delegimi të miratuara gjatë vitit 2025 në përputhje me Ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, duke reflektuar një rritje prej rreth 43% krahasuar me vitin 2023. Ky trend rritës, i evidentuar që në vitin 2024, u konsolidua më tej gjatë vitit 2025, duke dëshmuar një përdorim më të gjërë të mekanizmit të delegimit.

Po ashtu, gjatë vitit 2025 vijoi Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm Profesional për Audituesit e Brendshëm të sektorit publik, në bashkëpunim me projekte ndërkombëtare. Trajnimet u fokusuan në zbatimin konsistent të legjislacionit përkatës (përfshirë Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe Standardet Globale), forcimin e parimeve të qeverisjes së mirë dhe rritjen e rolit të auditimit të brendshëm në mbikëqyrjen e proceseve të vendimmarrjes dhe menaxhimit financiar.

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit të dytë Mbyllës**: “*Konrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) të veprojnë në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)*”, është miratuar **Ligji Nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”**, i cili përcakton KLSH-në si institucionin më të lartë të auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Përmbushja e këtij kushti nuk parashikon përafrim me *Acquis* të BE-së, por synon të përafrohet me parimet e Deklaratës së Limës (1977) dhe standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t.

KLSH zbaton gjithashtu Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI (1–400), Udhëzuesin për menaxhimin e riskut dhe cilësisë, Metodologjinë e planifikimit vjetor të auditimit, si dhe mekanizma për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Ky kuadër garanton ushtrimin e funksioneve të auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

Për vitin 2025, 99% e rekomandimeve të lëshuara nga KLSH janë pranuar nga institucionet e audituara, ndërsa vetëm 1% nuk është pranuar. Sa i përket zbatimit të tyre, 70% e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht, pjesërisht ose janë në proces zbatimi, ndërsa 30% mbeten të pazbatuara.

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit të tretë Mbyllës** – “*Shqipëria të sigurojë një bazë ligjore gjithëpërfshirëse për ruajtjen e konfidencialitetit të hetimeve të OLAF-it dhe të ketë kapacitetet e mjaftueshme operationale për shërbimin e saj kombëtar të koordinimit kundër mashtrimit. Shqipëria duhet të zbatojë në mënyrë efektive Strategjinë Kombëtare Kundër Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Shqipëria koordinon në mënyrë efektive aktivitetet kundër mashtrimit dhe ka një historik të qëndrueshëm bashkëpunimi me Komisionin, OLAF-in dhe Zyrën e Prokurorit Publik Evropian (EPPO) në lidhje me parregullsitë e raportuara dhe çështjet e hetimit që përfshijnë fondet e BE-së për të përmbushur plotësisht detyrimet e tyre*” – është miratuar **Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 275, datë 9.05.2025** “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Bashkimit

Evropian 2025–2030 dhe Planit të Veprimit”. Strategjia synon krijimin e një mjedisi rezistent ndaj mashtrimit, parandalimin e tij, rritjen e efikasitetit kontrolleve, si dhe forcimin e funksioneve hetimore dhe ndjekjes penale.

Përbushja e këtij Kushti përfshin përafrimin me Direktivën (BE) 2017/1371 (Direktiva PIF). Në këtë kuadër, janë në proces përgatitjeje dhe konsultimi me shërbimet e Komisionit Evropian Tabelat e Përputhshmërisë (ToC) për ndryshimet në Kodin Penal në lidhje me përafrimin e plotë me Direktivën mbi “Mbrojtjen e Interesave Financiar të Bashkimit Evropian”.

Shqipëria garanton konfidencialitetin e hetimeve të OLAF-it përmes kuadrit ligjor ekzistues, në veçanti Ligjit Nr. 112/2015 “Për inspektimin financiar publik” dhe Kodit të Etikës për Inspektimet Financiare Publike. Gjatë periudhës 2023-2025, AFCOS ka siguruar një shkëmbim efektiv informacioni me OLAF-in dhe ka vendosur kontaktin midis OLAF-it dhe autoriteteve kombëtare, për të siguruar bashkëpunim operativ në rastet e hetimeve.

Në fushën e bashkëpunimit gjyqësor, Shqipëria mban kontakte të rregullta me Zyrën e Prokurorit Publik Evropian (EPPO) përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Posaçme, bazuar në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit. Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike të ardhura nga EPPO janë trajtuar në përputhje të plotë me konventat dhe traktatet ndërkombëtare në fuqi.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, EPPO-ja ka paraqitur dy (2) kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike (NNJ) në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, me origjinë nga zyrat e EPPO-së në Itali dhe Poloni, gjatë periudhës janar-dhjetor 2025. Përveç kësaj, SPAK ka trajtuar katër (4) kërkesa për NNJ me origjinë nga Zyra Gjermane e EPPO-së, gjatë periudhës 2023-2025.

Në kuadër të përbushjes së **Kushtit të katërt Mbyllës** – “*Shqipëria të zbatojë Konventën Ndërkombëtare të Gjenevës të vitit 1929 për ndalimin e falsifikimit të monedhës, si dhe të përafrojnë legjislacionin e saj me acquis të BE-së për verifikimin e autenticitetit të monedhave euro dhe për trajtimin e monedhave dhe kartëmonedhave euro të papërshtatshme*” – konstatohet se kuadri ligjor shqiptar për mbrojtjen e monedhës Euro mbështetet në Ligjin për Bankën e Shqipërisë, Kodin Penal dhe aktet nënligjore përkatëse, duke garantuar mosdiskriminimin midis monedhës vendase dhe asaj të huaj, përfshirë Euron, si dhe parashikimin e sanksioneve penale efektive për veprat e falsifikimit. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Gjenevës me ligjin Nr. 77/2019 dhe ka harmonizuar legjislacionin përkatës me rregulloret e BE-së dhe standardet e Eurosistemit.

Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për mbledhjen, analizën teknike dhe statistikore të të dhënave mbi kartëmonedhat dhe monedhat e dyshuara si të falsifikuara, si dhe për tërheqjen e tyre të menjëhershme nga qarkullimi. Bashkëpunimi ndërinstytucional ndërmjet Bankës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë është forcuar përmes Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar në janar 2023, duke rritur koordinimin operacional dhe standardizimin e procedurave.

Gjatë periudhës 2023–2025, niveli i falsifikimit të Euro paraqitet pa ndryshime domethënëse. Janë trajtuar gjithsej 1.055 kartëmonedha Euro të falsifikuara, ku prerjet më të prekura mbeten kartëmonedhat me vlerë mesatare, veçanërisht prerja 50 Euro. Paralelisht, janë identifikuar 3.422 monedha Euro të falsifikuara, kryesisht monedha 2 Euro e lidhur me vështirësinë e dallimit vizual nga publiku. Autoritetet shqiptare marrin pjesë rregullisht në programet dhe mekanizmat evropianë për mbrojtjen e Euros, përfshirë Programin “Pericles”, si dhe kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Komisionin Evropian dhe Bankën Qendrore Evropiane.

Për sa i përket *Konventës së Gjenevës*, instrumenti i Ratifikimit të kësaj Konvente është nënshkruar nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme më datë 9 prill 2026 dhe është dërguar pranë Misionit të Republikës së Shqipërisë në OKB, për t'u depozituar në Regjistrin e OKB-së.

### 1.3.8 Kapitulli 5 - Prokurimi Publik

#### *Kushtet Mbyllëse*

Kushtet Mbyllëse (gjithsej: 3) për Kapitullin 5 kërkojnë që: 1) Shqipëria të sigurojë përafrim të plotë të kuadrit ligjor kombëtar me *Aacquis-in* e BE-së në të gjitha fushat e prokurimit publik (përfshirë koncesionet dhe PPP-të, prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare që përjashtojnë disa prokurime nga rregullat e prokurimit), në përputhje me Traktatin për Funkcionimin e BE-së (TFEU) dhe legjislacionin përkatës të BE-së. Paralelisht; 2) Shqipëria duhet të vendosë kapacitete të përshtatshme administrative dhe institucionale në të gjitha nivelet, si dhe të marrë masa për të garantuar zbatim dhe zbatueshmëri efektive të legjislacionit, në kohë të mjaftueshme përpara anëtarësimit. Së fundi, 3) kërkohet që Shqipëria të demonstrojë një *track record* të qëndrueshëm të një sistemi prokurimi publik të drejtë dhe transparent, që siguron njëkohësisht vlerë për parane, mbrojtjen e konkurrencës dhe masa të forta kundër korrupsionit.

#### *Masa Specifike për periudhën 2025-2026*

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit të parë Mbyllës** për Kapitullin 5: “*Shqipëria duhet të sigurojë përafrim të plotë të kuadrit ligjor kombëtar me *acquis* të BE-së në të gjitha fushat e prokurimit publik (përfshirë koncesionet dhe PPP-të, prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare që përjashtojnë disa prokurime nga rregullat e prokurimit), në përputhje me Traktatin për Funkcionimin e BE-së (TFEU) dhe legjislacionin përkatës të BE-së*”, është punuar për:

- Është miratuar **Ligji Nr. 88, datë 12.12.2025** “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me synim përafrimin me Direktivën 2014/23/BE, dhe vijon procesi për përgatitjen dhe miratimin e legjislacionit dytësor në këtë fushë, që do të përmbyllë kushtin edhe përafrimin e plotë.
- Përafrimin e plotë të **Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”**, me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian, përkatësisht **Direktivën 2014/24/BE** të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin publik”, që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE, si dhe **Direktivën 2014/25/BE** të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga subjektet që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare”, që shfuqizon Direktivën 2004/17/KE, nëpërmjet ndryshimeve që janë propozuar, të shoqëruara nga një proces konsultimi intensiv me shërbimet e Komisionit Evropian.
- Vijon procesi për miratimin e ndryshimeve në **VKM Nr. 291, datë 15.05.2024**, “Për përcaktimin e pragjeve monetare në procedurat e prokurimit publik”, ku është hartuar drafti i VKM-së me synim përafrimin e pragjeve monetare kombëtare me pragjet në fuqi sipas Direktivës 2014/24/BE dhe Direktivës 2014/25/BE. Projektakti është konsultuar me KE, dhe pasi janë reflektuar komentet e dhëna nga shërbimet e tij, është marrë dakordësia (*no objection*) më datë 04.02.2026 përsa I takon përafrimit me këto direktiva mbi kufijtë momentarë të prokurimit publik, gjithashtu pritet dakordësia e KE për përafrimin me

**Direktivën 2014/23/BE** përsa i takon kufijve monetar për kontratat e koncesioneve/PPP në projektvendim (dërguar në Komision në 24.03.2026). Në vijim, projektakti pritet t'i nënshtrohet procedurave të miratimit nga Këshilli i Ministrave.

- Është hartuar draft akti nënligjor dhe vijon procesi lidhur me miratimin e ndryshimeve në **VKM Nr. 457, datë 30.07.2021**, “Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit”, me qëllim përafrimin e plotë të tij me Rregulloren (KE) 2195/2002 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 nëntor 2002, për Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (FPP/CPV), të ndryshuar. Drafti i VKM-së është përgatitur dhe dërguar pranë shërbimeve të KE-së më datë 26.03.2026.

Paralelisht, për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, po vijon procesi i përafrimit të kuadrit ligjor përmes ndryshimeve në **Ligjin Nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”**, nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, në përputhje me Direktivën 2009/81/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave për punë, furnizime dhe shërbime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” (që ndryshon Direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE). Në këtë kuadër, me Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes Nr. 383, datë 06.03. 2025, është ngritur grupi i punës për hartimin e ndryshimeve . **Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 36/2020”** është hartuar tashmë dhe publikuar për konsultim publik në Regjistrin e Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike në periudhën 23.07.2025–20.08.2025 dhe është shpërndarë për mendime në ministrinë e linjës, ndërkohë SIGMA po ofron asistencë teknike për draftin, ndërsa priten rekomandimet e Komisionit Evropian të cilit i është dërguar paketa e projektligjit për mendim.

Për përmbushjen e **Kushtit të dytë Mbyllës**: “*Shqipëria duhet të vendosë kapacitete të përshatshme administrative dhe institucionale në të gjitha nivelet, si dhe të marrë masa për të garantuar zbatimin efektiv të legjislationit, në kohë të mjaftueshme përpara anëtarësimit,*” në këtë kuadër, certifikimi i zyrtarëve publikë të prokurimit po zbatohet përmes skemës së ngritur nga APP, në bashkëpunim me ASPA dhe DAP, mbi bazën e **Udhëzuesit të përbashkët të miratuar më 30.12.2024** “Për procedurat e trajnimit, testimit dhe dhënies së certifikatave”. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar pesë sesione testimi, ku janë testuar 696 punonjës dhe janë certifikuar 441 prej tyre, ndërkohë që procesi vijon në funksion të objektivave më tej.

Po ashtu, zbatimi i **Strategjisë Kombëtare të Prokurimit Publik 2024–2030** është përgatitur publikimi i Raporteve të Monitorimit dhe është publikuar, ndërsa mjetet praktike të zbatimit dhe monitorimit (udhëzime, manuale, dokumente standarde kontraktuale dhe instrumente monitorimi) zbatohen nëpërmjet rolit rregullator dhe monitorues të APP-së, përfshirë monitorimin *ex-post*, trajtimin e sinjalizimeve të palëve të treta dhe vëmendjen e veçantë ndaj fazës së zbatimit të kontratës. Mekanizmat e kontrollit mbështeten dhe nga **Metodologjia për Vlerësimin e Riskut të Korrupsionit në Prokurimin Publik**, e përgatitur gjatë vitit 2025 dhe publikuar në dhjetor 2025, si element i qasjes së bazuar në risk si dhe po vazhdon puna për hartimin e Planit të Integritetit për parandalimin e Korrupsionit në këtë sektor, bazuar në metodologjinë e sipërpërmendur.

Në lidhje me **Kushtin e e tretë Mbyllës** ku kërkohet që: “*Shqipëria të demonstrojë një track record të qëndrueshëm të një sistemi prokurimi publik të drejtë dhe transparent, që siguron vlerë për parandë, konkurrencë dhe masa të forta kundër korrupsionit*”; Autoriteti i Prokurimit Publik (APP) po punon të hartojë në 6 mujin e parë 2026 një **raport statistikor të posaçëm, me të dhëna krahasuese për periudhën 2022–2025**, i cili do të pasqyrojë performancën e sistemit dhe treguesit kryesorë që lidhen drejtpërdrejt me transparencën, konkurrencën dhe

eficencën e shpenzimeve publike. Raporti bazohet në raportimet vjetore të APP dhe do të përfshijë, ndër të tjera, analiza mbi numrin e procedurave të publikuara në sistemin elektronik, shpërndarjen sipas llojit të kontratës dhe llojit të procedurës, përdorimin e procedurave të negociuara pa publikim paraprak (pa shpallje), nivelin e procedurave ku është paraqitur vetëm një ofertë dhe që janë finalizuar me fitues, pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) (procedurat e fituara nga NVM-të kundrejt totalit), si dhe mënyrën e përzgjedhjes së ofertës fituese përmes kriterëve ligjore të vlerësimit të përdorura në procedurat e përmbyllura.

Për të plotësuar panoramën e “*track record*”-it, APP po koordinon me institucionet përkatëse edhe për grumbullimin dhe pasqyrimin e të dhënave mbi mekanizmin e ankimeve (*remedies*), mbi prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe mbi informacionin e disponueshëm lidhur me rastet e korrupsionit në prokurimin publik, me synim që raportimi të përfshijë jo vetëm volum/strukturë të procedurave, por edhe funksionimin e garancive procedurale dhe të integritetit. Paralelisht, për të forcuar shtyllën parandaluese kundër korrupsionit, është përgatitur dhe publikuar në dhjetor 2025, **Metodologjia për vlerësimin e riskut të korrupsionit në prokurimin publik (sipërpërmendur)** (APP në bashkëpunim me MAPA), si instrument për identifikimin sistematik të rreziqeve dhe orientimin e kontroleve mbi bazë risku me qëllim parandalimin; ndërkohë, parashikohet që deri në qershor 2026 të hartohet **Model i Planit të Integritetit** për autoritetet kontraktore, i cili do të standardizojë masat e integritetit dhe parandalimit të korrupsionit do të krijojë një kornizë të unifikuar për parandalimin e shkeljeve, rritjen e transparencës dhe forcimin e përgjegjshmërisë gjatë gjithë ciklit të prokurimit publik.

Në këtë kuadër vlen të përmendet së gjatë vitit 2025, Shqipëria ka shënuar progres të dukshëm në fushën e prokurimit publik, i reflektuar si në vlerësimet ndërkombëtare ashtu edhe në treguesit e brendshëm të performancës. Vendi u rendit i pari në rajon sipas SIGMA/OECD me 81/100 pikë.

Portali ndërkombëtar *OpenTender.EU* (i cili menaxhohet nga Instituti i Transparencës Qeveritare, një organizatë jo-fitimprurëse, me bazë në Hungari, që mbledh dhe publikon të dhëna nga 27 shtete anëtare të Bashkimit Evropian), ku Shqipëria është përfshirë për herë të parë në vitin 2025, konfirmon progresin e vendit në prokurimin publik në krahasim me rajonin dhe BE-në, bazuar në treguesit e integritetit dhe transparencës. Shqipëria renditet mbi disa vende të BE-së në të dy treguesit, duke arritur **71.41 pikë për integritetin** (më lart se 16 vende të BE-së si Austria, Bullgaria, Hungaria, Rumania, Qipro, Spanja, Sllovakia, Portugalia, Letonia, Lituania, Sllovenia, Kroacia, Polonia, Italia, Franca dhe Irlanda.) dhe **54.5 pikë për transparencën**, ku barazohet në vlerësim me 3 vende të BE si Portugalia, Sllovakia dhe Holanda, si dhe është vlerësuar më lart se 4 vende të BE, si Austria, Sllovenia, Irlanda, dhe Lituania, apo vendet e rajonit si Maqedonia e Veriut.

### 1.3.9 Kapitulli 4 – Lëvizja e Lirë e Kapitalit

#### *Kushtet Mbyllëse*

Kushtet Mbyllëse (gjithsej: 3) për Kapitullin 4 kërkojnë që: **1)** Shqipëria të sigurojë përafrim të plotë të kuadrit ligjor kombëtar me *Acquis-in* në lidhje me lëvizjet e kapitalit dhe të tregojë

se do të jetë në gjendje ta zbatojë plotësisht atë deri në anëtarësim, duke siguruar që, të gjitha kufizimet e mbetura të hiqen; **2)** Në fushën e pagesave, legjislacioni të jetë përafër me *Acquis* të BE-së, veçanërisht në lidhje me shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm (Direktivën e Shërbimit të Pagesave të ndryshuar), pagesat ndërkufitare dhe *Acquis* për Zonën e Vetme Evropiane të Pagesave. Në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Shqipëria duhet të ketë përafër *Acquis* e BE-së, veçanërisht Direktivën Kundër Pastrimit të Parave, Rregulloren Kundër Pastrimit të Parave dhe Rregulloren e Transferimit të Fondeve, të ndryshuara. Së fundi, **3)** kërkohet që Shqipëria të demonstrojë kapacitete të mjaftueshme administrative për të zbatuar legjislacionin dhe detyrimet përkatëse kundër Pastrimit të Parave/Financimit të Terrorizmit, dhe të tregojë përparim të prekshëm drejt një historiku të qëndrueshëm.

### **Masa Specifike për periudhën 2025 -2026**

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit të parë Mbyllës** për Kapitullin 4: “*Shqipëria është përafër me Acquis-në në lidhje me lëvizjet e kapitalit dhe tregon se do të jetë në gjendje ta zbatojë plotësisht atë deri në anëtarësim, duke siguruar që të gjitha kufizimet e mbetura të hiqen*”, është punuar për analizën për përafërmin e **Ligjit Nr. 8337, datë 30.4.1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, kullotave dhe livadheve”** me Direktivën e Këshillit 88/361/KEE e 24 qershorit 1988 për zbatimin e Nenit 67 të Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU). Ndryshimi i ligjit synon rregullimin juridik të kalimit të pronësisë mbi tokën bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave tek të huajt. Aktualisht, personat fizike dhe juridike të huaj gëzojnë të drejtën e marrjes së saj me qira deri në 99 vjet. Dhënia me qira e tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil.

Për përmbushjen e **Kushtit të dytë Mbyllës**: “*Shqipëria është përafër me Acquis-në e BE-së në fushën e pagesave, veçanërisht për sa i përket shërbimeve të pagesave në tregun e brendshëm (Direktiva e Shërbimit të Pagesave e ndryshuar), pagesat ndërkufitare dhe Acquis-në për Zonën e vetme Evropiane të Pagesave dhe tregon se do të jetë në gjendje ta zbatojë plotësisht atë me anëtarësimin*”, është punuar për të garantuar përafërmin e plotë të:

- **Është hartuar projektligjit Nr. 133/2013 “Për Sistemin e Pagesave”** i cili synon përafërmin me kërkesat e Direktivës PSD 2 si dhe me Direktivën e Parasë Elektronike (EMD2), veçanërisht lidhur me kërkesat për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të parasë elektronike.
- **Është hartuar projektligjit Nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”** i cili synon përafërmin e plotë me Rregulloren 2015/751 të tarifave të shkëmbimit për transaksionet e pagesave me kartë, që synojnë rregullimin e tarifave të ndërrimeve për transaksionet e pagesave që bëhen me kartë. Për të dy projektligjet, së shpejti parashikohet të kryhet procedura e konsultimit publik, në përfundim të të cilit do të fillojë dhe procedura e shqyrtimit për miratim fillimisht në Këshillin e Ministrave dhe më tej në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

**Në Mars 2026, Banka e Shqipërisë, ka përgatitur paketat e plota ligjore për dy projektligjet** më sipër, të cilat ja ka përcjellë Ministrisë së Financave për të filluar procesin e konsultimit publik dhe ndër-institucional planifikuar gjatë maj 2026.

Gjithashtu gjatë vitit 2025 në përmbushje të këtij Kushti Mbyllës, Banka e Shqipërisë ka miratuar **Vendimin 49/2025 “Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për**

përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe debitimet direkte në Euro”, e cila përafrohet pjesërisht Rregulloren 2021/1230 mbi pagesat ndërkufitare në BE. Ky vendim do të rishikohet, deri në qershor 2026, për të arritur përafrimin e plotë me *Acquis* të BE-së mbi pagesat ndërkufitare në Bashkimin Evropian.

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit të tretë Mbyllës** për Kapitullin 4: “*Shqipëria është përafruar me acquis-në e BE-së në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (veçanërisht Direktiva Kundër Pastrimit të Parave, Rregullorja Kundër Pastrimit të Parave dhe Rregullorja e Transferimit të Fondeve, e ndryshuar). Shqipëria tregon kapacitete të mjaftueshme administrative për të zbatuar siç duhet legjislacionin dhe detyrimet përkatëse kundër pastrimit të parave/kundër financimit të terrorizmit, dhe tregon përparim të prekshëm drejt një historiku solid. Shqipëria tregon se do të jetë e gatshme të zbatojë plotësisht acquis-në që nga dita e anëtarësimit*”, është përgatitur paketa ligjore për të siguruar përafrimin e plotë të **Ligjit Nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar**, me Direktivën për ndalimin e përdorimit të sistemit financiar për pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit (Direktiva (BE) 2024/1640); Rregulloren për ndalimin e përdorimit të sistemit financiar për pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit (Rregullore (BE) 2024/1624) dhe Rregulloren (BE) 2024/1624 për informacionin që shoqëron transferimin e fondeve dhe atë të kryptoaseteve. Procesin e konsultimit publik të Projektligji ka filluar në datë 10 prill 2026 dhe përfundon në datën 8 maj 2026. Së shpejti do të fillojë dhe procesi i bashkërendimit ndërinstitucional me Ministrinë që japin mendim dhe më tej do të fillojë dhe procedura e shqyrtimit për miratim fillimisht në Këshillin e Ministrave dhe më tej në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

**Zhvillimi i Sistemeve dhe historikut të të dhënave:** Është planifikuar ngritja e Sistemit CAMS mbi ndërlidhjen e sistemeve të lidhura me Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme (ZPP). Aktualisht, janë vlerësuar sistemet ekzistuese, bazat e të dhënave, pajisjet e rrjetit dhe serverat, dhe janë identifikuar kërkesat me imediate për infrastrukturën e IT-së. Është konfirmuar nisja e fazës së parë, e cila përfshin prokurimin dhe konfigurimin e pajisjeve të rrjetit. Në qershor 2025, u miratua zyrtarisht nga Grupi i Punës “**Dokumenti i Vlerësimit të Nevojave**”.

Në janar 2026, është miratuar “**Dokumenti i Kërkesave të Biznesit**”, që përcakton specifikimet funksionale dhe teknike për sistemin si dhe specifikimet për zhvillimin e sistemit të menaxhimit të rasteve. Ky dokument do të shërbejë si bazë për proceset e tenderimit dhe fazat pasuese të projektimit, zhvillimit dhe zbatimit.

### 1.3.10 Kapitulli 21 - Rrjetet Trans-Evropiane

#### ***Kushtet Mbyllëse***

Kushtet mbyllëse (gjithsej: 3) për Kapitullin 21 kërkojnë që: Shqipëria të sigurojë përafrim të plotë me *Acquis*-in e BE-së në fushën e Rrjeteve Trans-Evropiane të Energjisë (TEN-E) dhe Rrjeteve Trans-Evropiane të Transportit (TEN-T). Në sektorin e energjisë, kërkohet forcimi i planifikimit afatgjatë të infrastrukturës, vlerësimi i nevojave për investime dhe garantimi i përputhshmërisë mjedisore të proceseve të lejeve. Në sektorin e transportit, kërkohet përmblyllja e përafrimit me Rregulloren e re TEN-T (2024), si dhe progres i qëndrueshëm në projektet prioritare, veçanërisht në Korridorin Ballkani Perëndimor – Mesdheu Lindor. Gjithashtu, kërkohet forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative, si dhe zbatimi i masave për integritet, transparencë dhe llogaridhënie në proceset që lidhen me zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të rrjeteve trans-evropiane.

## **Masa Specifike për periudhën 2025 -2026**

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit të parë Mbyllës** për Kapitullin 21 – Rrjetet Trans-Evropiane: “*Shqipëria duhet të sigurojë përafrim të plotë të kuadrit ligjor kombëtar me acquis të BE-së në fushën e Rrjeteve Trans-Evropiane të Energjisë (TEN-E)*”: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka parashikuar miratimin e **Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores TEN-E”**, i cili aktualisht është në proces përgatitjeje. Përgatitja e aktit mbështetet në Rregulloren (BE) 2022/869 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 30 majit 2022, mbi udhëzimet për infrastrukturën trans-evropiane të energjisë, duke ndryshuar Rregulloret (KE) Nr. 715/2009, (BE) 2019/942 dhe (BE) 2019/943 dhe Direktivat 2009/73/KE dhe (BE) 2019/944, dhe duke shfuqizuar Rregulloren (BE) Nr. 347/2013. Projektvendimi synon të sigurojë përafrim të plotë përmes një harmonizim të plotë të Rregullores së BE në kuadrin rregullator kombëtar. Synohet konsultimi me palët dhe grupet e interesit dhe Komisionin Evropian brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2026, me objektiv miratimin nga Këshilli i Ministrave sa më shpejt. Kjo shënon një hap vërtet të rëndësishëm para në përgatitjet rregullatore të vendit për “Rrjetet Pan-Evropiane”, krahas përgatitjes infrastrukture.

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit të dytë Mbyllës** për Kapitullin 21: “*Shqipëria ka rënë dakord me Komisionin Evropian, pas konsultimeve të duhura, për projektet prioritare të rrjetit TEN-T në të ardhmen; Shqipëria ka një nivel të avancuar të përafrimit me rregulloren TEN-T dhe ka arritur përparim të mjaftueshëm drejt përfundimit të projekteve në Korridorin e Transportit Evropian Ballkani Perëndimor–Mesdheu Lindor*” janë parashikuar dhe po zbatohen masat në vijim:

- Në aspektin rregullator, është në proces përgatitja e **Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Për miratimin e rregullores TEN-T”**. Akti është përgatitur dhe dorëzuar, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për mendim në Sekretariatit e Komunitetit të Transportit, ndërsa drafti bazohet në një harmonizim të plotë të Rregullores (BE) 2024/1679, me synim sigurimin e përafrimit të plotë. Konsultimi publik dhe me palët e interesuara është parashikuar të zhvillohet në vijim të procesit, ndërsa rishikimi i draftit mbi bazën e konsultimeve dhe dorëzimi për miratim janë planifikuar brenda vitit 2026, duke shpresuar që të gjitha konsultimet shkojnë mirë dhe ky na mundëson të ruajmë këtë ritëm.
- Në aspektin institucional dhe zbatues, zhvillimi i koordinuar i rrjetit TEN-T të Shqipërisë brenda Korridorit të Transportit Evropian Ballkani Perëndimor – Mesdheu Lindor vijon në mënyrë të vazhdueshme. Shqipëria kontribuon aktivisht në proceset rajonale të planifikimit dhe koordinimit në kuadër të Komunitetit të Transportit. Në këtë kontekst, Ministrat e Komunitetit të Transportit, gjatë takimit të 9-të të Këshillit Ministror të Komunitetit të Transportit, mbështetën Draftin e Planit të Parë të Punës të Korridorit të Ballkanit Perëndimor–Mesdheut Lindor dhe riafirmuan rëndësinë e zhvillimit të Korridoreve Evropiane të Transportit për rritjen e lidhshmërisë në Evropë. Paralelisht, vijon procesi i identifikimit dhe avancimit të projekteve prioritare të rrjetit TEN-T.

Në kuadër të përmbushjes së **Kushtit të tretë Mbyllës** për Kapitullin 21: “*Shqipëria siguron kapacitet të mjaftueshëm institucional dhe administrativ me standarde të larta integriteti të nevojshme për të ndër marrë përgjegjësitë e acquis në këtë kapitull*”, forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative trajtohet si një proces i vazhdueshëm, si në fushën e Rrjeteve Trans-Evropiane të Transportit (TEN-T), ashtu edhe në atë të Rrjeteve Trans-Evropiane të Energjisë (TEN-E), si më poshtë:

- Në fushën TEN-T, boshllëqet në aftësi që lidhen me planifikimin dhe zbatimin e infrastrukturës së transportit, përfshirë kërkesat e Rregullores TEN-T, procedurat e prokurimit, analizat kosto-përfitim (CBA) dhe vlerësimet e ndikimit në mjedis (EIA), identifikohen dhe adresohen në mënyrë të vazhdueshme, dhe po punohet për një plan më intensiv konsolidimi, sidomos në kapacitete e aftësi për Rrjetin TEN-T që i kërkohet një vendi anëtar, potencial të BE.”
- Në këtë kontekst, janë parashikuar aktivitete trajnimi dhe mbështetje teknike në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, Sekretariatit e Komunitetit të Transportit dhe partnerët zhvillimorë. Shqipëria merr pjesë aktive në aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve të Komunitetit të Transportit, veçanërisht në fushat që lidhen me menaxhimin e ciklit të projektit dhe monitorimin e projekteve prioritare të Rrjetit.
- Në fushën TEN-E, zhvillimi i koordinuar i Rrjetit Kombëtar vijon në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Boshllëqet në aftësi që lidhen me zbatimin e kërkesave të *Acquis* TEN-E, përfshirë aspektet rregullatore dhe procedurat e lejeve të infrastrukturës, identifikohen në mënyrë sistematike dhe po punohet për një plan më intensiv të konsolidimit të aftësive dhe kapaciteteve. Aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve dhe mbështetja përkatëse realizohen në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe institucionet përkatëse kombëtare.

## PJESA II

# PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT KOMBËTAR ME ACQUIS TË BE-SË NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Përafrimi i legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimi Evropian përbën një nga shtyllat themelore të plotësimit të kushteve mbyllëse të negociatave dhe një detyrim thelbësor për Republikën e Shqipërisë në rrugën drejt anëtarësimit.

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit kombëtar me Acquis dhe standartet e Bashkimit Evropian buron nga:

- **Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit**, i cili parashikon përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe sigurimin e zbatimit efektiv të tij në përputhje me standartet e BE-së;
- **Pozicionet negociuese të Republikës së Shqipërisë për 6 Grupkapitujt**, të hartuara dhe miratuara në përputhje me metodologjinë e re të zgjerimit të Bashkimi Evropian;
- **Pozicionet e Përbashkëta të Bashkimit Evropian për 6 Grupkapitujt**, në kuadër të procesit të përmbushjes të kushteve mbyllëse të përcaktuara nga BE për Shqipërinë, për mbylljen e negociatave dhe për arritjen e gatishmërisë teknike për mbylljen e negociatave;
- **Angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Agjendës Kombëtare të Reformave 2024–2027**, si instrument kyç për përshpejtimin e reformave kryesore të BE-së dhe përafrimin me standartet evropiane;
- **Plani Kombëtar i Integrimit Evropian 2024-2027**.

Përsa më sipër, gjatë periudhës **2025-Prill 2026**, janë miratuar në total së paku **222 akte**, të ndara si vijon:

- |                                      |     |
|--------------------------------------|-----|
| • Ligje <sup>6</sup>                 | 44  |
| • Vendime të Këshillit të Ministrave | 78  |
| • Akte të tjera nënligjore           | 100 |

**75 akte** që kanë përafuar Acquis të BE dhe ose kanë përmbushur hendeqe, kriteret në kuadër të përmbushjes të **Kushteve të Ndërmjetme**, të ndara si vijon:

- |                                      |                 |
|--------------------------------------|-----------------|
| • Ligje                              | 23              |
| • Vendime të Këshillit të Ministrave | 16              |
| • Akte të tjera nënligjore           | 36 <sup>7</sup> |

**111 akte** që kanë përafuar me Acquis të BE-së në kuadër të përmbushjes të **Kushteve të Mbylljes**, të ndara si vijon:

- |                                      |    |
|--------------------------------------|----|
| • Ligje <sup>8</sup>                 | 18 |
| • Vendime të Këshillit të Ministrave | 49 |
| • Akte të tjera nënligjore           | 44 |

<sup>6</sup> 5 projektligje janë miratuar vetëm në Këshillin e Ministrave dhe pritet miratimi në Kuvend.

<sup>7</sup> Përfshirë edhe aktet e emërimit në detyrë, për institucionet e pavarura kryesisht, me Vendim të Kuvendit.

<sup>8</sup> 5 projektligje janë miratuar vetëm në Këshillin e Ministrave dhe pritet miratimi në Kuvend.

**12 akte** që kanë përmbushur Acquis dhe ose kanë përmbushur masanë kuadër të **Agjendës Kombëtare të Reformave**<sup>9</sup>, Faciliteti “Për Reforma dhe Rritje” të BE, të ndara si vijon:

- **Ligje** 1
- **Vendime të Këshillit të Ministrave** 5
- **Akte të tjera nënligjore** 6

**24 akte të tjera** janë përafuar me Acquis të BE-së në kuadër të punës më të gjerë në procesin e integritimit evropian, të ndara si vijon:

- **Ligje** 2
- **Vendime të Këshillit të Ministrave** 8
- **Akte të tjera nënligjore** 14

Të dhënat mbi volumin e akteve të miratuara gjatë periudhës 2025–Prill 2026 tregojnë një **rritje të ndjeshme të aktivitetit normativ**, duke **arritur në 222 akte, krahasuar me 82 akte në vitin 2024**.

Ky intensifikim lidhet drejtpërdrejt me prioritarizimin e përafrimit në fazën kyçe në të cilën ndodhet procesi i negociatave për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Në këtë kontekst, rritja e ndjeshme e numrit të **akteve ligjore dhe nënligjore gjatë vitit 2025-prill 2026, krahasuar me vitin 2024 (rreth 170%)** pasqyron ndër të tjera reforma, masa dhe përmirësime në të 33 kapitujt e Acquis dhe avancimin në fazat e tjera të procesit të negociatave, si dhe progresin konkret dhe të matshëm në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga procesi i negociatave, ku kryesisht dominojnë angazhimet, e prioritarizuara tashmë nga perspektiva e bisedimeve për anëtarësim, për përmbushjen e piketave të ndërmjetme, përmbushjen e kriterëve për mbylljen e negociatave dhe zbatimin e Agjendës Kombëtare të Reformave.

Ky intensifikim tregon se procesi i përafrimit ka kaluar nga një fazë relativisht më e përgjithshme legjislativë (në vitin 2024), drejt një faze shumë më të targetuar të transformimit evropian të vendit, me natyrë **teknike, sektoriale dhe të orientuar drejt** rezultateve, duke u udhëzuar nga prioritetet e bisedimeve të negociatave, tashmë të qarta dhe të dakordësuara me BE për çdo fushë/kapitull, ku kërkohet:

- harmonizim i detajuar rregullator,
- ngritje mekanizmash zbatues,
- dhe forcim i kapaciteteve institucionale dhe atyre të tregut e më gjerë sistemit shoqëror.

Periudha 2025–2027 përfaqëson, për shkak të çeljes së bisedimeve për anëtarësim dhe kalimit solid për të cilin mbetemi shpresëplotë, drejt fazës së përgatitjes teknike për mbylljen e negociatave, një fazë të **përsheptuar dhe të thelluar të procesit të integritimit**, i cili shoqërohet edhe me një proces intensiv përafrimi me Acquis të BE-së, ku:

- viti 2025 shënoi kulmin e punës për **hapjen e negociatave dhe përmbushjen e Piketave të Ndërmjetme**,
- ndërsa vitet 2026–2027 do dominohen nga **përgatitja teknike për përmbushjen teknike të kushteve mbyllëse, të përcaktuara nga BE për Shqipërinë, për mbylljen negociatave dhe konsolidimin e reformave për anëtarësimin dhe transformimin**

<sup>9</sup> Këtu veçohen vetëm ato akte të cilat nuk janë të përfshira në kuadër të përmbushjes të Kushteve të Ndërmjetme apo Kushteve të Mbylljes, me qëllim shmangien e dublikimeve.

**evropian të vendit, nga vend kandidat, në atë të negociatave për anëtarësimin e tij në vend anëtar.**

Rritja e konsiderueshme e aktivitetit normativ dhe dominimi i akteve zbatuese dëshmojnë qartë një **intensifikim të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt rezultateve të procesit të përafrimit**, duke reflektuar një fazë më të pjekur dhe më kërkuese të negociatave për anëtarësim.

Në përputhje me procesin e negociatave të Shqipërisë me BE-në, siç kemi njoftuar më herët Kuvendin (Shkurt 2025), Shqipëria ka hartuar draft-planet e punës për plotësimin e kushteve për mbylljen e negociatave për 31 nga 33 kapitujt, pasi për kapitujt 23 dhe 24 Kushtet e mbylljes ende priten të përcaktohen nga BE në Qendrimin e Përbashkët të BE.

Këto 31 plane janë në proces rishikimi ciliësor dhe konsultimi me Komisionin Evropian (DG ENEST) dhe pritet të finalizohen brenda javëve në vijim. Për të bërë rishikimin e draft Planeve të Punës dhe për të marrë udhëzimet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian mbi pritshmëritë e tyre për si duhet të përmbushen 101 Kushtet Mbyllëse të negociatave, për tw 31 kapitujt u zhvilluan takimet shpjeguese (*explanatory meetings*) midis Komisionit Evropian dhe Shqipërisë sipas Kalendarit të përcaktuar nga Shërbimet e Komisionit Evropian, të cilat u përmbyllën në muajin shkurt 2026. Mbas tyre Komisioni Evropian dërgoi udhëzimet (Konkluzioneve Operacionale), mbi bazën e të cilave po bëhen përmirësimet reflektuese cilësore në draft Planet e Punës.

Pas përfundimit të këtij procesi, por paralelisht me të, po punohet për rishimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian (në fuqi) dhe jetësimin e Planit Kombëtar për Përafrimin me Acquis të BE-së (PKPA) 2026–2027, i cili do të zëvendësojë planin ekzistues PKIE 2024–2026 dhe do të shërbejë si instrument kryesor për harmonizimin ligjor me BE-në.

Të gjitha aktet e përfshira në PKPA do të kërkojnë konsultim dhe dakordësi paraprake nga Komisioni Evropian para miratimit, krahas të gjithë proceseve të brendshme të ligjërjes, konsultimit dhe pjesëmarrjes

Në përputhje me procesin e integritimit evropian, progresi në përafrimin me Acquis të BE-së për periudhën 2025 – Prill 2026, në mënyrë të përmbledhur ka patur këto drejtime kryesore reformuese dhe fokus prioriteti:

Në kuadër të përafrimit me **Acquis të Bashkimit Evropian për Grupkapitullin I “Themeloret”**, gjatë periudhës së raportimit është vijuar me intensifikimin e reformave ligjore, institucionale dhe operacionale, në funksion të përmbushjes së kushteve të ndërmjetme dhe mbyllëse për negociatat për anëtarësimin në BE.

- **Reforma në sistemin e drejtësisë** - Është shënuar progres në rritjen e efikasitetit institucional dhe uniformitetit të praktikës gjyqësore, në përputhje me standardet e BE-së, nëpërmjet konsolidimit të kuadrit ligjor të reformës në drejtësi përmes:
  - ndryshimeve në **Ligjin për organizimin e sistemit të drejtësisë dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve**;
  - miratimit të akteve për **efikasitetin e sistemit gjyqësor**, përfshirë afatet standarde të gjykimit dhe standardizimin e vendimeve gjyqësore;
  - forcimit të strukturave të shërbimit ligjor në gjykata, etj.

- **Të drejtat themelore** - Është forcuar kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave themelore përmes miratimit të:
  - Ligjit “Për barazinë gjinore”;
  - ndryshimeve në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi;
  - Ligjit “Për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave”;
  - ndryshimeve në Ligjin “Për Avokatin e Popullit”;
  - Ligjit “Për kujdesin alternativ për fëmijët”;
  - akteve për njohjen dhe trajtimin e pakicave kombëtare;
  - një sërë aktesh nënligjore të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave, në kuadër të GDPR, etj.
- **Media** - Është forcuar kuadri ligjor dhe institucional përmes ndryshimeve në Ligjin Nr. 97/2013 ‘Për Median Audiovizive në Republikën e Shqipërisë’”, duke shënuar progres të rëndësishëm në drejtim të përmbushjes së standardeve evropiane dhe përafrimit me acquis, veçanërisht në aspektet që lidhen me pronësinë e medias (parandalimin e përqendrimit) dhe rritjen e transparencës së financimit.
- **Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar** - Është forcuar kuadri ligjor dhe institucional përmes:
  - krijimit të **Zyrës së Rikuperimit të Aseteve**;
  - ndryshimeve në ligjin për **pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit**;
  - ligjit për **konfliktin e interesit dhe lobimin**;
  - forcimit të mekanizmave të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve (ndryshimet ligjore);
  - marrëveshjeve Polici e Shtetit – BKH;
  - memorandumit për qendrat e të miturve të pashoqëruar, etj.
- **Politikat penale** - Është përmirësuar kuadri ligjor nëpërmjet përafrimit të Kodit Penal me acquis të Bashkimit Evropian. Ndërhyrjet kryesore përfshijnë pastrimin e parave, duke forcuar standardet provuese dhe duke rritur dënimet për veprat përkatëse; përmirësimin e kuadrit ligjor për trafikimin e qenieve njerëzore, përmes zgjerimit të përkufizimit të shfrytëzimit dhe forcimit të mbrojtjes për të miturit; si dhe forcimin e masave për mbrojtjen e të miturve nga abuzimi dhe shfrytëzimi, përfshirë ndalimin e ushtrimit të profesioneve të caktuara dhe përjashtimin nga përgjegjësia penale për viktimat e mitura. Gjithashtu, janë zgjeruar dhe forcuar dispozitat në fushën e luftës kundër terrorizmit, duke përfshirë juridiksionin, kriminalizimin e veprave të reja dhe ashpërsimin e sanksioneve; janë përditësuar dispozitat për trafikimin e lëndëve narkotike, me zgjerim të veprimeve të ndaluara dhe rritje të dënimeve; si dhe janë ndërmarrë masa për garantimin e lirisë së medias dhe rritjen e sigurisë së gazetarëve, përmes parashikimit të mbrojtjeve specifike në legjislacionin penal.
- **Siguria kufitare, migracioni dhe azili** - Është arritur përafrim i mëtejshëm me acquis të Schengen-it dhe menaxhimit të migracionit nëpërmjet miratimit të:
  - ligjit për **kontrollin e kufirit shtetëror**;
  - ligjit për **përpunimin e informacionit të udhëtimit (API)**;
  - **Planit Kombëtar i Kontigjencës për Migracionin 2026–2028**;
  - **Planit i Veprimit për Shengenin**.
  - Udhërrëfyesit të **Politikës së Vizave, etj.**

- **Parandalimi i krimit të organizuar dhe trafikimit** - Është forcuar kuadri rregullator përmes miratimit të:
  - Strategjisë për **Armët e Vogla dhe Eksplozivët 2025–2030**;
  - Procedurave Standarde për **mbrojtjen e viktimave të trafikimit**;
  - Krijimit të **Observatorit Kombëtar të Drogës**;
  - Krijimit të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të Drogës;
  - Ndryshimeve në ligjet për substancat narkotike;
  - Ligjit dhe operacionalizimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve Kriminale
- **Kontrolli Financiar** - Janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në forcimin e sistemit të kontrollit financiar publik dhe përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, është miratuar Strategjia Kombëtare Kundër Mashtrimit 2025–2030, e cila synon mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe forcimin e mekanizmave për parandalimin dhe zbulimin e parregullsive. Gjithashtu, është krijuar Komisioni i Kualifikimit të Auditimit të Brendshëm, me qëllim rritjen e standardizimit dhe profesionalizimit të auditimit në sektorin publik, si dhe janë miratuar metodologji dhe manuale të reja për kontrollin dhe auditimin e brendshëm, duke forcuar kuadrin teknik dhe procedural. Në funksion të harmonizimit me acquis të BE-së është miratuar Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE), ndërsa është hapur procesi i certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, me synim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe institucionale.
- **Në fushën e prokurimit publik** është shënuar progres në përafrimin me acquis të BE-së përmes miratimit të Ligjit Nr. 88/2025 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik–Privat”, i cili synon forcimin e kuadrit ligjor për menaxhimin transparent dhe efikas të koncesioneve dhe PPP-ve.

Në kuadër të **Grupkapitullit II “Tregu i Brendshëm”**, i cili përfshin përafrimin me Acquis të Bashkimit Evropian në fushat e lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, shoqërive tregtare, konkurrencës, pronësisë intelektuale, shërbimeve financiare dhe mbrojtjes së konsumatorit, gjatë periudhës së raportimit është vijuar me konsolidimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në funksion të integritetit në Tregun e Brendshëm të BE-së:

- **Lëvizja e lirë e mallrave** - Është shënuar progres në rritjen e përputhshmërisë teknike dhe lehtësimin e qarkullimit të lirë të mallrave, përmes përditësimit të klasifikimit të produkteve plehëruese të lejuara për regjistrim dhe zbatimit të planit të punës për harmonizimin me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Gjithashtu, janë miratuar rregulla mbështetëse për startup-et dhe inovacionin, përmes skemave të granteve, ngritjen e Këshillit Kombëtar të Inovacionit, miratimit të Planit të Veprimit për Scoreboard-in Evropian të Inovacionit, si edhe strukturën e miratimit të Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3) dhe masave të tjera nxitëse, duke kontribuar në zhvillimin e ekosistemit të inovacionit dhe rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë, etj.
- **Lëvizja e lirë e shërbimeve** – Këshilli i Ministrave ka miratuar projektligjin “Për lirinë e vendosjes dhe ofrimit të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë”, i cili synon lehtësimin e ofrimit ndërkufitar të shërbimeve dhe krijimin e kushteve më të favorshme për ushtrimin e aktivitetit ekonomik. Ky projektligj kontribuon në eliminimin e barrierave administrative, për shërbimet, rritjen e konkurrencës në treg dhe përafrimin e mëtejshëm me standardet e Bashkimit Evropian, etj.

- **Lëvizja e lirë e kapitalit** - Është miratuar ndryshimi në Rregulloren për transfertat e kreditit dhe debitimit direkt në Euro nga Banka e Shqipërisë. Ky ndryshim synon të përmirësojë funksionimin e pagesave në Euro, duke rritur efikasitetin dhe sigurinë e transaksioneve financiare, etj.
- **E drejta e shoqërive tregtare** - Janë miratuar rregullore të reja që lidhen me procedurat e investigimit dhe masat disiplinore, si dhe rregullore për sigurimin e cilësisë së auditimit ligjor dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të cilësisë. Këto ndryshime synojnë të forcojnë kuadrin rregullator në fushën e auditimit, duke rritur transparencën, llogaridhënien dhe standardet profesionale. Nëpërmjet tyre, përmirësohet mbikëqyrja e aktivitetit auditues dhe sigurohet një nivel më i lartë besueshmërie dhe integriteti në raportimin financiar. Si edhe është punuar dhe është përgatitur paketa me 10 akte ligjore (9) dhe nënligjore (1) për kuadrin e Shoqërive Tregtare dhe përafrimin e tij me Acquis të BE në kuadër të përmbushjes së Kriterëve Mbyllëse me Kapitullin 6.
- **Pronësia intelektuale** - Janë miratuar disa akte ligjore të rëndësishme në fushën e pronësisë intelektuale, përfshirë Ligjin për Markat Tregtare, Ligjin për Patentat, Modelet e Përdorimit dhe Certifikatat e Mbrojtjes Shtesë, Ligjin për aderimin në Traktatin e Marrakeshit, si dhe aktin për riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Ky kuadër ligjor përfaqëson një hap të rëndësishëm në përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian, duke forcuar mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe duke përmirësuar funksionimin institucional në këtë fushë, si dhe janë hartuar 3 draft akte të rëndësishme ligjore, etj.
- **Politika e konkurrencës** - Janë miratuar rregullore dhe udhëzues nga Autoriteti i Konkurrencës, të cilat lidhen me marrëveshjet e kërimit dhe zhvillimit, marrëveshjet e specializimit, përjashtimet në bllok të marrëveshjeve vertikale, si dhe kufizimet vertikale dhe praktikave bashkërenduara. Këto akte synojnë të forcojnë zbatimin efektiv të rregullave të konkurrencës në treg, duke rritur qartësinë rregullore dhe parandalimin e praktikave antikonkurrese, etj.
- **Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik** - Është miratuar ligji për aderimin në Protokollin për ndalimin e tregtisë së paligjshme të produkteve të duhanit. Ky akt përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e kuadrit ligjor në fushën e shëndetit publik dhe synon të luftojë tregtinë e paligjshme të produkteve të duhanit, si dhe është hartuar draft ligji ndryshues “Për mbrojtjen e konsumatorit”, një masë shumë e rëndësishme në proces

Në kuadër të **Grupkapitullit III “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithpërfshirëse”** janë miratuar një sërë aktesh ligjore, vendimesh të Këshillit të Ministrave dhe akteve nënligjore që synojnë forcimin e konkurrueshmërisë, modernizimin institucional, rritjen e sigurisë digjitale, përmirësimin e qeverisjes ekonomike dhe përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian.

- **Teknologjia e informacionit, komunikimet elektronike dhe siguria kibernetike** - Janë miratuar një sërë aktesh që forcojnë infrastrukturën digjitale dhe sigurinë kibernetike, përfshirë Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2025–2030, rregullat për rrjetet 5G, menaxhimin e krizave kibernetike, si dhe skemën e certifikimit të sigurisë kibernetike. Gjithashtu, janë miratuar rregullore të AKEP për portabilitetin

e numrit, tregjet përkatëse, rrjetet me kapacitet të lartë (VHCN), monitorimin e spektrit, autorizimet e përgjithshme dhe sigurinë e rrjeteve elektronike. Janë ndërmarrë edhe hapa për krijimin e identifikimit elektronik dhe portofolit të identitetit digjital, etj. Këto masa synojnë forcimin e sigurisë dhe harmonizimin me standardet e BE-së në fushën digjitale.

- **Politika Fiskale** - është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”. Ky akt synon forcimin e transparencës fiskale dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e tatimeve, duke kontribuar në parandalimin e evazionit fiskal dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian.
- **Financat publike dhe stabiliteti makroekonomik** - Janë miratuar akte që lidhen me forcimin e kuadrit fiskal dhe transparencës financiare, përfshirë dispozitat për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare. Gjithashtu, janë ngritur grupe pune për krijimin e Këshillit Fiskal dhe për rishikimin e kuadrit ligjor të Bankës së Shqipërisë, si dhe janë miratuar udhëzime për raportimin e devijancave makroekonomike dhe buxhetore. Këto masa synojnë përmirësimin e disiplinës fiskale dhe qeverisjes ekonomike.
- **Punësimi, politikat sociale dhe mbrojtja e punëtorëve** - Janë miratuar masa që lidhen me përmirësimin e kushteve të punës dhe forcimin e mbrojtjes sociale, përfshirë indeksimin e pensioneve, politikat për sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe Planin Kombëtar për Garancinë Evropiane për Fëmijët 2026–2030. Gjithashtu, janë forcuar strukturat e dialogut social dhe rregullat për funksionimin e institucioneve të punës. Këto masa synojnë rritjen e mirëqenies sociale dhe përafrimin me standardet e BE-së.
- **Politika industrial dhe mbështetja e biznesit** - Janë miratuar ndryshime ligjore dhe strategji që synojnë përmirësimin e klimës së biznesit, mbështetjen e startup-eve dhe nxitjen e investimeve. Përfshin strategjitë për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, edhe atë industriale programet për eksportet dhe ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve, si dhe masat për derregullim dhe modernizim të shërbimeve për biznesin. Gjithashtu, janë miratuar rregulla për inspektimet, metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe përcaktimin e dënimeve administrative. Këto masa rrisin konkurrueshmërinë dhe efikasitetin e tregut.
- **Shkenca, kërkimi dhe arsimiti i lartë** - Janë miratuar akte që forcojnë sistemin e kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë, përfshirë standardet për shkencën e hapur, kodin e etikës në kërkim shkencor, kriteret për institucionet kërkimore dhe financimin e shkencës, etj. Gjithashtu, janë përcaktuar rregullat për statusin e qendrave të ekselencës, regjistrin kombëtar të kërkuesve dhe modelin e financimit të shkencës. Në fushën e arsimit janë miratuar edhe strategjitë për arsimin digjital dhe krijimin e bazës së të dhënave për arsimin e lartë dhe riorganizimin e dy strukturave qendrore si Agjencia për Shërbimet Arsimore (në Kuvend) dhe Inspektorati Qendror i Arsimit, por edhe Plani i Veprimit për Strategjinë e Arsimit të Lartë apo Metodologjia për Arsimin Gjithëpërfshirës. Këto akte synojnë modernizimin e sistemit arsimor dhe shkencor dhe përafrimin me Standardet e BE-së.

- **Arsimi, rinia dhe kultura** - janë miratuar një sërë aktesh ligjore dhe vendimesh të Këshillit të Ministrave që synojnë forcimin e politikave rinore, zhvillimin e arsimit, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe përmirësimin e administrimit publik në këto fusha.
  - Në këtë kontekst, janë miratuar ndryshime në ligjin “Për rininë” dhe ligji “Për vullnetarizmin”, duke forcuar kuadrin ligjor për angazhimin rinor dhe pjesëmarrjen vullnetare në shoqëri, si dhe ngritjen e inspektoratit qendror të arsimit parauniversitar. Janë ndërmarrë gjithashtu hapa për krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Arsimore dhe përmirësimin e qeverisjes në sektorin arsimor.
  - Gjithashtu, janë miratuar masa të rëndësishme në fushën e arsimit, përfshirë krijimin e bazës së të dhënave të sistemit të menaxhimit të informacionit të arsimit të lartë (SMIAL), Planin Kombëtar të Arsimit Dixhital 2025–2030.
  - Në fushën e arsimit profesional është miratuar rregullorja mbi standardet, kriteret dhe procedurat për akreditimin e ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP), duke synuar rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve, garantimin e përputhshmërisë me standardet kombëtare dhe evropiane, si dhe forcimin e mekanizmave të vlerësimit dhe monitorimit të institucioneve ofruese.
  - Në fushën e rinisë dhe sportit, janë miratuar rregulla për mbështetjen e talenteve rinore, si dhe procedura për financimin e projekteve sportive nga organizatat përkatëse, duke synuar rritjen e përfshirjes së të rinjve dhe zhvillimin e sportit në vend.
- **Dogant dhe integrimi ekonomik me BE-në** - Janë miratuar vendime që lidhen me nomenklaturën e mallrave dhe strategjinë shumëvjeçare të IT për ndërveprim të sistemit tonë doganor me sistemet doganore të BE-së, etj. Këto masa kontribuojnë në harmonizimin e tregtisë dhe sistemeve teknologjike me standardet evropiane dhe përmirësimin e integritit ekonomik.

Në kuadër të **Grupkapitullit IV “Agjenda e gjelbër dhe ndërlidhja e qëndrueshme”** janë miratuar një sërë aktesh ligjore, vendimesh të Këshillit të Ministrave dhe akteve nënligjore që synojnë forcimin e politikave të transportit të qëndrueshëm, tranzicionin energjetik, mbrojtjen e mjedisit dhe përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian në fushat e lidhura me agjendën e gjelbër.

- **Transporti** - Janë miratuar akte që forcojnë kuadrin rregullator në aviacionin civil, hekurudhë, transport rrugor dhe detar, duke përfshirë Programin Kombëtar të Lehtësirave në Aviacion, rregullat për kontrollin e mjeteve motorike, si dhe ndryshime në Kodin Rrugor. Gjithashtu, janë miratuar rregullore për ekuipazhin ajror, kontrollorët e trafikut ajror, regjistrin e mjeteve hekurudhore, sigurinë në tunelet hekurudhore, ndërveprimin në transport dhe aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, etj. Këto masa synojnë rritjen e sigurisë, ndërveprueshmërisë dhe standardeve teknike në transport, në harmoni me ato të BE.
- **Energjia** - në fushën e energjisë janë miratuar ligje dhe akte që mbështesin tranzicionin energjetik dhe rritjen e efikasitetit energjetik, përfshirë Ligjin “Për Performancën Energjetike të Ndërtesave” dhe Ligjin “Për biokarburantet dhe energjitë e rinovueshme në transport”. Gjithashtu, janë miratuar Strategjia Kombëtare e Rinovimit të Ndërtesave dhe rregullore për etiketimin e produkteve energjetike. Në sektorin e energjisë elektrike janë miratuar rregulla për alokimin e kapaciteteve, balancimin e

sistemit dhe menaxhimin e tregut të energjisë, etj., duke forcuar integrimin në tregjet evropiane.

- **Mjedisi** - Janë miratuar akte që lidhen me përmirësimin e menaxhimit mjedisor dhe mbrojtjen e burimeve natyrore, përfshirë Ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligjin “Për ndryshimet klimatike dhe ligjin për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesve”. Gjithashtu, janë miratuar vendime për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme, si dhe për organizimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve. Janë përcaktuar gjithashtu, elementet e cilësisë së ujërave dhe kufijtë hidrografikë të baseneve, duke forcuar menaxhimin e integruar të ujërave dhe mbrojtjen e ekosistemeve. Lidhur me politikat horizontale të qëndrueshmërisë dhe ndërveprimit mjedisor, janë miratuar rregulla që lidhen me klasifikimin e riskut, sigurinë e operimeve dhe standardet teknike në sektorë të ndryshëm, përfshirë transportin detar dhe aviacionin. etj. Këto masa kontribuojnë në rritjen e sigurisë operacionale dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore në aktivitetet ekonomike dhe transport.

Në kuadër të **Grupkapitullit V “Burimet, bujqësia dhe kohezioni”** janë miratuar një sërë aktesh ligjore, vendimesh të Këshillit të Ministrave dhe akteve nënligjore që synojnë forcimin e sigurisë ushqimore, zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit, rritjen e standardeve të prodhimit dhe përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian në fushat përkatëse.

- **Bujqësia** - Janë miratuar akte që forcojnë kuadrin rregullator për prodhimin dhe kontrollin e produkteve organike. Përfshihen rregullat e hollësishme për importin e produkteve organike dhe në kalim, si dhe rregullat për prodhimin organik blegtoral. Këto masa synojnë garantimin e standardeve të larta të cilësisë dhe sigurisë ushqimore në përputhje me kërkesat e BE-së.
- **Siguria ushqimore** - Janë ndërmarrë hapa për forcimin e kuadrit ligjor në fushën e sigurisë ushqimore, përfshirë propozimin e Projektligjit “Për nën-produktet shtazore”. Gjithashtu janë miratuar akte nënligjore për substancat aromatizuese në produktet ushqimore dhe për parandalimin e sëmundjeve të listuara në kafshë, duke rritur kontrollin dhe sigurinë në zinxhirin ushqimor.
- **Peshkimi** - Janë miratuar masa për forcimin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve detare dhe luftën kundër peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar (IUU). Këto përfshijnë rregulla për inspektimin e aktiviteteteve të peshkimit dhe krijimin e skemës së certifikimit të zënies së peshkut si dhe ndryshime në rregulloren për detyrimin e zbakimit të mbetjeve të peshkimit. Këto masa synojnë mbrojtjen e ekosistemeve detare dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të peshkut.

Në kuadër të **Grupkapitulli VI “Marrëdhëniet me jashtë”** janë miratuar një sërë aktesh ligjore, vendimesh të Këshillit të Ministrave dhe akteve nënligjore që synojnë forcimin e kontrollit të tregtisë ndërkombëtare, rregullimin e skanimit të investimeve të huaja, zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare dhe përafrimin me politikën e përbashkët të jashtme dhe atë të sigurisë të Bashkimit Evropian.

- **Tregtia dhe Investimet e Huaja Direkte** - Janë miratuar Plani i Veprimit “Për përafrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me acquis të BE-së”, ndryshimet në Ligjin “Për investimet e huaja” si dhe është miratuar Rregullorja “Për vlerësimin dhe

rishikimin e investimeve të huaja të drejtpërdrejta” që prekin infrastrukturën kritike, teknologjitë strategjike, furnizimin me inpute kritike dhe sektorë të ndjeshëm si informacioni dhe media. Janë bërë ndryshime dhe në kuadrin ligjor për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve me përdorim të dyfishtë. Gjithashtu janë përditësuar listat e mallrave ushtarake dhe teknologjive të kontrolluara, si dhe mallrat që mund të përdoren për qëllime të ndëshkimit mizor ose trajtimit çnjerëzor. Këto masa synojnë forcimin e kontrollit dhe rritjen e sigurisë në tregtinë ndërkombëtare, si dhe mbrojtjen e interesave kombëtare dhe përafrimin me mekanizmat e BE-së për shqyrtimin e investimeve të huaja.

- **Politika e jashtme** - Janë miratuar ndryshime në kuadrin për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për masat shtrënguese ndërkombëtare dhe procedurat për materialet për materialet kriptografike, duke forcuar zbatimin e politikës së përbashkët të sigurisë dhe jashtme.

*Për një informacion më të detajuar mbi aktet e miratuara, në kuadër të përafrimit me Acquis të BE-së, si dhe të detyrimeve në procesin e negociatave dhe integritit evropian për periudhën 2025 – Prill 2026, referojuni Aneksit I bashkëlidhur këtij Raporti.*

## **PJESA III**

# **FONDET NGA BASHKIMI EVROPIAN DHE PARTNERËT E TJERË**

### **3.1 Ecuria e programimit dhe zbatimit të IPA-s Kombëtare**

Paketa IPA III (2021-2027) është miratuar dhe janë nënshkruar marrëveshjet financiare respektive.

#### **- Marrëveshja Financiare për Programin Kombëtar IPA 2024**

Më 18 mars 2025, Delegacioni i BE-së në Tiranë ka përcjellë pranë Koordinatorit Kombëtar i IPA-s, (KKIPA) paketën e Marrëveshjes Financiare për Planin Vjetor të Veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2024, me qëllim iniciimin e procedurave të brendshme deri në nënshkrimin nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s.

Programi Kombëtar Vjetor IPA 2024 është miratuar në parim me VKM Nr. 362 datë 30.6.2025. Në vijim të miratimit në parim, KKIPA ka përgatitur paketën e dokumenteve për miratimin përfundimtar, ku Programi Kombëtar Vjetor IPA 2024 është miratuar me VKM Nr. 414, datë 23.7.2025 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 137, datë 31.7.2025. Totali për këtë Program është 67.35 milionë Euro.

#### **- Programet Operacionale (OP) 2024-2027**

Në kuadër të përmbushjes së procedurave për miratimin e Marrëveshjeve Financiare të Programeve Operacionale, ZMKKIPA ka koordinuar ndjekjen e procedurave të brendshme për Programet Operacionale:

- ✓ Marrëveshja financiare për Programin Operacional për Energjinë është miratuar në parim në datë 26.2.2025 me VKM Nr. 114, është miratuar me VKM Nr. 255 datë 07.05.2025, është ratifikuar me ligjin nr. 36/2025 datë 5.6.2025 dhe është publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 116 datë 3.7.2025.
- ✓ Marrëveshja financiare për Programin Operacional për Ekonominë dhe Shoqërinë Digjitale është miratuar në parim në datë 26.2.2025 me VKM Nr. 116, është miratuar me VKM Nr. 253 datë 07.05.2025, është ratifikuar me ligjin 35/2025 datë 5.6.2025 dhe është publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 115 datë 2.7.2025;
- ✓ Marrëveshja financiare për Programin Operacional për Punësimin e të Rinjve është miratuar në parim në datë 26.2.2025 me VKM Nr. 115, është miratuar me VKM Nr. 254 datë 07.05.2025 është ratifikuar me ligjin Nr. 34/2025 datë 5.6.2025 dhe është publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 111 datë 26.6.2025.

#### **- Marrëveshja Financiare IPA 2025-2027**

KKIPA ka koordinuar procesin për miratimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes Financiare IPA 2025-2027.

Plani Shumëvjeçar i Veprimit në favor të Shqipërisë për vitet 2025-2027 është miratuar në parim me VKM Nr.702 datë 26.11.2025, është miratuar me VKM Nr.735 datë. 10.12.2025, është nënshkruar nga KKIPA më 5.12.2025 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 230 datë, 11.12.2025.

## **Ecuria e monitorimit të zbatimit të IPA-s Kombëtare**

- *Monitorimi i qëndrueshmërisë së projekteve të financuara nga IPA II*

Në kuadër të IPA II, në zbatim të detyrimeve për monitorimin dhe raportimin e asistencës së Bashkimit Evropian, është ndjekur procesi i monitorimit të qëndrueshmërisë së projekteve, duke:

- Identifikuar projektet që kanë hyrë në fazën e qëndrueshmërisë, në përputhje me detyrimet e përcaktuara;
- Realizuar dy kërkesa për raportim në baza gjashtë mujore, të përcjella pranë institucioneve përfituese;
- Përcjellë në mënyrë të rregullt përditësimet mbi udhëzuesit më të fundit të Bashkimit Evropian, lidhur me këto çështje.

- *Raportimet gjashtë mujore të progresit teknik IPA II*

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve për raportim, bazuar në manualët e brendshme të procedurave, është realizuar koordinimi, mbledhja dhe rishikimi i raporteve gjashtë mujore të progresit teknik për projektet në zbatim nën IPAIL, për vitin 2025.

- *Komiteti Vjetor i Monitorimit IPA*

Është koordinuar organizimi i Komitetit Vjetor të Monitorimit IPA për vitin 2025, si një nga eventet kryesore për monitorimin e asistencës financiare IPA.

- *Raporti Vjetor i Zbatimit (AIR)*

Është koordinuar puna me Strukturat dhe Autoritetet IPA për finalizimin e Raportit Vjetor të Zbatimit (AIR) për vitin 2024, i cili është dorëzuar brenda afateve. Më 13 shkurt 2026, Zyra Mbështetëse e Koordinatorit Kombëtar IPA (ZMKKIPA) përgatiti dhe KKIPA dorëzoi Raportin Vjetor të Zbatimit (AIR) për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2025. Raporti u hartua në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian dhe u dorëzua brenda afatit.

- *Raportet Finale të Zbatimit (FRI)*

Është koordinuar puna me Strukturat dhe Autoritetet IPA dhe CFCU për hartimin dhe finalizimin e Raporteve Finale të Zbatimit (FRI), për të cilin gjatë vitit 2025, është përgatitur dhe dorëzuar Raporti Final i Zbatimit (FRI) për Programin Vjetor IPA 2017 pranë shërbimeve të Komisionit Evropian.

- *Deklarata Vjetore Menaxheriale*

Janë përgatitur dhe dorëzuar 2 (dy) Deklarata Vjetore Menaxheriale për vitin financiar 2024 në kuadër të IPA II dhe IPA III.

Gjithashtu, është përgatitur dhe dorëzuar Deklarata Menaxheriale në rolin e Autoritetit Menaxhues për Programin Vjetor IPA 2022. Ka përfunduar procesi i dorëzimit të tre (3) Deklaratave Menaxheriale për vitin 2025, me afat dorëzimi 22 dhe 23 janar 2026.

- *Planet vjetore të monitorimit të aktiviteteve*

Është ndjekur Plani i Aktiviteteve për vitin 2025 dhe është përgatitur Plani i Aktiviteteve të Monitorimit për vitin 2026. Plani përfshin aktivitetet kryesore të monitorimit të përcaktuara në Marrëveshjet Financiare dhe manualët përkatëse.

## Pjesëmarrja e Shqipërisë në Kuadrin e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF)

Gjatë vitit 2025, lidhur me mbështetjen që Shqipëria përfiton nga asistenca e Bashkimit Evropian nëpërmjet instrumentit rajonal të Kuadrit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF), është marrë miratimi për 3 (tre) veprimtari të mëposhtme të asistencës teknike të aplikuar në thirrjen 31. Vlera totale e grantit për këto veprimtari do të jetë **5.53 milionë Euro**.

- ✓ Korridor VIII, Rindërtimi i Linjës Hekurudhore Rrogozhinë - Pogradec - Projekti i Detajuar, VNMS, Dokumentet e Tenderit;
- ✓ Linja e transmetimit 400 kV Rrashbull-Fier - Studim Fizibiliteti dhe përcaktimi i Fushëveprimit Mjedisor dhe Social;
- ✓ Zgjerimi në 400 kV i nënstacionit të Fierzës dhe linja e re e ndërlidhjes 400 kV me Kosovën - Studim Fizibiliteti dhe përcaktimi i Fushëveprimit Mjedisor dhe Social.

Përsa i përket aplikimeve të projekteve për grant investimi, janë miratuar në muajin prill 3 (tre) projektet e para të investimit pjesë e Listës Indikative të Projekteve të prioritizuara për financim nga Faciliteti për Reforma dhe Rritje (RGF), të cilat i përkasin sektorit të energjisë dhe do të kenë burim financimi fondet nga kësti i parafinancimit, konkretisht:

- ✓ Digjitalizimi i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë;
- ✓ Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës;
- ✓ Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë - Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës.

Kontributi nga WBIF për këto projekte do të jetë **30.92 milionë Euro**.

Zyra e KKIPA ka vazhduar të kryejë koordinimin dhe ndjekjen e proceseve dhe për thirrjet vijuese aktive gjatë vitit, konkretisht Thirrja 10 B dhe 11 për grant investimi dhe Thirrja 32 për asistencë teknike. Nga aplikimet në dy thirrjet për projekte investimi është marrë miratimi për dy projekte me rëndësi kombëtare, si vijon:

- ✓ Zgjerimi i Impianteve të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) në Lezhë dhe Sarandë;
- ✓ Përmirësimi i ITUN Durrës dhe rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të përdorura në zonën historike të qytetit të Durrësit.

Nëpërmjet grantit të financuar nga fondet e Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit III (IPA III), këto dy projekte do të mbështeten respektivisht me një vlerë prej **39,66 milionë Euro** dhe **84,84 milionë Euro**, duke përfaqësuar kështu vlerat më të larta të granteve të investimit të miratuara ndonjëherë për Shqipërinë në sektorin e mjedisit, në kuadër të WBIF.

Po lidhur me aplikimet në këto thirrje, krahas projekteve të mësipërme tashmë të miratuara, pas marrjes së një rezultati pozitiv gjatë procesit të vlerësimit, pritet të prezantohen për miratim në Bordin e WBIF, në fillim të vitit të ardhshëm, edhe dy projekte të tjera me rëndësi për vendin në sektorin e transportit dhe atë digjital, siç janë Projekti 'Elektrifikimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës' dhe Projekti 'Për zhvillimin e infrastrukturës rajonale me brez të gjerë, apo broadband'.

**Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me partnerë të tjerë gjatë vitit 2025:**

**Me Gjermaninë**, ka vijuar bashkëpunimi si një nga shtyllat kryesore të ndihmës dypalëshe, për Shqipërinë. Në datat 13-14 nëntor 2025 u zhvilluan diskutimet paraprake mes dy vendeve për Protokollin e Bashkëpunimit për Zhvillim 2026-2028. Këto diskutime shënuan një hap të rëndësishëm, duke shërbyer si një fazë përgatitore për negociatat zyrtare dhe nënshkrimin e Protokollit të ri të Bashkëpunimit, në vitin 2026. Synimi i tyre ishte të vlerësohej progresi

aktual i zbatimit të portofolit të bashkëpunimit dhe identifikimi i prioriteteve dhe drejtimeve të ardhshme për bashkëpunimin dypalësh.

Gjithashtu, ka vazhduar zbatimi i Protokollit të Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë 2024-2026, si dhe marrëveshjeve/protokolleve të mëparshme me këtë vend (të vitit 2022, 2020, 2018) për programet dhe projektet “Qendrat për migracion dhe zhvillim (ZME)”, “Green Vjosa (Vjosa e Gjelbër) - Zhvillim rajonal i gjelbër dhe gjithëpërfshirës në zonën e ujëmbledhësit të Parkut Kombëtar të Vjosës”, “Programi për klimën në Shqipëri - Program i hapur mbi efikasitetin e energjisë dhe digjitalizimin e sektorit të energjisë”, “Programin për rinovimin e konvikteve të universiteteve publike në Shqipëri, sipas parimit të efikasitetit të Energjisë V”, “Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve dhe Parandalimi i Mbetjeve Detare në Ballkanin Perëndimor” ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).

**Me Italinë**, filloi procesi i negociatave dypalëshe për Planin Indikativ Shumëvjeçar të Bashkëpunimit për Zhvillim Itali-Shqipëri 2025-2029. Gjithashtu, më 29 tetor 2025, Këshilli i Ministrave miratoi në parim Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, ‘Për bashkëpunimin strategjik në kujdesin shëndetësor, energjinë, mjedisin, industrinë e sigurisë dhe mbrojtjes, menaxhimin e migracionit, arsimin, inovacionin, diasporën, transformimin ekonomik dhe rritjen inteligjente’. Marrëveshja u nënshkrua në mbledhjen e përbashkët të dy Qeverive në Romë, në 13 nëntor 2025.

**Me Zvicrën**, u hartua dhe miratua Programi për Bashkëpunimin për Zhvillim në Shqipëri 2026–2028. Programi i ri i bashkëpunimit fokusohet në tre fusha kryesore: (i) qeverisje gjithëpërfshirëse (*përfshirë mbështetjen për sektorin e shëndetësisë*), (ii) zhvillim ekonomik dhe punësim, (iii) zhvillimi urban dhe ndryshimet klimatike. Vlera e përgjithshme e financimit për periudhën 3-vjeçare do të jetë 58 milion CHF (30 milion nga SDC dhe 28 milion SECO), me objektiv kryesor integrimin në BE, demokratizimin, rritjen e qëndrueshme dhe përfshirjen sociale në linjë me parimet mjedisore.

Gjatë vitit 2025 kanë filluar diskutime për marrëveshjet e bashkëpunimit me **Brazilin** (Marrëveshje bazë për bashkëpunimin teknik midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Brazilit), Marrëveshjen Ndërqeveritare me **Izraelin** (Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së shtetit të Izraelit për bashkëpunimin strategjik), dhe Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Qeverisë së Republikës së **Austriës** mbi bashkëpunimin ekonomik.

**Në kuadrin e bashkëpunimit me Agjencitë Ndërkombëtare, Japonia** nëpërmjet JICA’s, për vitin fiskal japonez 2025, ka ofruar 12 programe trajnimit për specialistët dhe zyrtarët qeveritarë shqiptarë, përmes të cilave do t’i sigurojë njohuri dhe ekspertizë teknike në fusha të ndryshme, si dhe dy programe “Trajnim Afatgjatë në Japoni (Programi i Studimeve Zhvillimore të JICA-s)”, “Rrjeti i Studimeve Bujqësore dhe Sigurisë Ushqimore (Agrinet) dhe “Udhëheqësi Global në OZHQ”. Nga Qeveria e Japonisë janë ofruar edhe skema të tjera bashkëpunimi teknik si : “Science and Technology Research Partnership for Sustainable Development (SATREPS)” dhe “Programet e trajnimit për Bashkë-Krijimin e njohurive për Liderët e Rinj”.

**Përmes trajnimeve të ofruara nga Korea e Jugut**, për vitin 2025, është koordinuar pjesëmarrja në programet e periudhës 2026-2027 të ‘Knowledge Sharing’ Program (KSP) në fusha të ndryshme si: - planifikimi i zhvillimit ekonomik, - politika makro-financiare, - financat publike, - politika industrial, - promovimi i tregtisë dhe eksportit, - zhvillimi i biznesit (SME), - shkenca dhe teknologjia, kërkimi dhe zhvillimi, TIK, - transporti dhe zhvillimi urban, -

energji, - uji dhe kanalizimet, - mjedisi, - zhvillimi rural, - shëndeti dhe mjekësia, - mirëqenia sociale, - edukimi dhe burimet njerëzore, - administrata publike, - punësimi dhe puna, - kultura dhe turizmi etj.

**Me Zyrën e Kombeve të Bashkuara**, në kuadër të Fondit të Përshpejtimin të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm për Shqipëri është diskutuar ndryshimi i Marrëveshjes aktuale dhe nënshkrimi i një Marrëveshje të re Administrative Standarde. Gjithashtu, ka filluar puna për hartimin dhe diskutimin e Kuadrit të ri të Partneritetit për periudhën 2027 – 2031.

**Në kuadër të bashkëpunimit me Agjencitë e Kombeve të Bashkuara**, me përfundimin e Programit Kombëtar aktual për Zhvillim Industrial për Shqipërinë 2020-2024, është iniciuar me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), diskutimi dhe puna për hartimin e një Programi të Ri Partneriteti Kombëtar 2025 - 2029.

**Në kuadër të bashkëpunimit me Institucionet Financiare dhe Bankat Zhvillimore**, gjatë vitit 2025 partnerët për zhvillim janë angazhuar në financimin e disa projekteve dhe programeve strategjike:

- **Banka Botërore (IBRD)**, në kuadër të Strategjisë së saj të Partneritetit me Shqipërinë 2023-2027, vijoi në mbështetjen e projekteve në fusha të ndryshme:

- *Digjitalizim dhe Shërbime publike* – “Veprimi i Ofrimit të Shërbimeve të Përqëndruara dhe Gjithpërfshirëse të Përdoruesit”, i cili ka në fokus digjitalizimin e shërbimeve dhe proceseve të ofruara nga niveli vendor. Projekti është financim shtesë i projektit GovTECH, me kredi në vlerën e **76.9 milionë Euro**.
- *Financa dhe Raportimi* – është mbështetur me anë të një granti në vlerën e **1.2 milionë USD** Projekti “Përmirësimi i praktikave të Kontabilitetit dhe Raportimit të Sektorit Publik në Shqipëri” dhe gjithashtu projekti "Aftësia Ripërtëritëse dhe Zhvillimi i Gjellbër- Hua e Dytë për Politikën e Zhvillimit" kredi, me një financim në shumën totale prej **113.6 milionë Euro**.

- **Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)** ka ofruar mbështetjen e saj në disa projekte infrastrukturore dhe energjitike të rëndësishme për vendin, si pjesë e prioritetëve të Qeverisë shqiptare:

- Projekti i Qëndrueshmërisë së OSHE-së , kredi me një financim në shumën prej **45.75 mln Euro**.
- Projekti Fotovoltaik (FV) " Solar nga KESH" me një financim në shumën **30 milionë Euro** kredi.
- Projekti ‘Infrastruktura Hekurudhore e Korridorit VIII, Faza 1-Seksioni Durrës-Rrogozhinë’, me një financim në shumën prej **30 milionë Euro**, kredi.

- **Banka Evropiane e Investimeve (BEI)** është gjithashtu një partner i rëndësishëm në projekte infrastrukturore të rëndësishme për vendin, si pjesë e prioritetëve të Qeverisë shqiptare, gjatë 2025 ka ofruar mbështetje për:

- Projekti ‘Infrastrukturën Hekurudhore Korridorit VIII, Faza I- Shqipëri’, kredi në shumën e **30 milionë Euro**.
- Projekti ‘Infrastruktura Hekurudhore e Korridorit VIII, Faza I –Shqipëri’, grant në shumën prej **60.4 milionë Euro**.

- **Banka Gjermane për Zhvillim (KfW)** ka vijuar bashkëpunimin dhe zbatimin e projekteve, dakordësuar edhe në Protokollin e Bashkëpunimit 2024-2026, ndër të cilat:

- Programi ‘Për Klimën në Shqipëri I - program i hapur mbi efikasitetin e energjisë dhe digjitalizimin e sektorit të energjisë’, me një financim në shumën e **30 milionë Euro** kredi dhe **2 milionë Euro** grant.
- Projekti ‘Për Rehabilitimin e Hidrocentralit të Fierzës’, me një financim prej **40 milionë Euro** kredi dhe **1 milion Euro** grant.
- Programi ‘Për klimën në Shqipëri II- program i hapur për efikasitetin e energjisë dhe digjitalizimin e sektorit të energjisë’, me një financim në shumën e **60 milionë Euro** kredi dhe **2 milionë Euro** grant.
- Programi ‘Infrastruktura Bashkiake V – Faza II’, kredi në shumën prej **47 milionë Euro** dhe **3 milionë Euro** grant.

- **Agjencia Franceze për Zhvillim (AFD)**, gjatë vitit 2025 ka vijuar zbatimin e projekteve në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Ndërsjelltë, ndërsa gjithashtu, ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi në fushën e turizmit, për krijimin e një projekti gjithëpërfshirës për turizmin e qëndrueshëm në rajonin e Korçës, grant në shumën totale prej **400.000 Euro**.

- **Cassa Depositi e Prestiti S.p.A**, në kuadër të Përmirësimit të Rrjetit të Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipërinë Veriore pas tërmetit të vitit 2019, financoi shumën prej **35 milionë Euro** kredi.

#### - **Platforma e Dialogut me Donatorët dhe Partnerët për Ndhmën e Huaj në Shqipëri**

Në datën 30 shtator 2025, në Tiranë, u zhvillua *Forumi Vjetor- Platforma e Dialogut me Donatorët dhe Partnerët për Ndhmën e Huaj në Shqipëri*, i cili shërbeu si një platformë dialogu me donatorët dhe partnerët, si një hapësirë bashkëpunimi për të adresuar sfidat dhe për të identifikuar zgjidhje të përbashkëta në koordinimin e ndihmës së huaj në Shqipëri, me diskutimet të cilat u fokusuan në:

- përafrimin e ndihmës së huaj me prioritetet qeveritare dhe SKZHIE 2030;
- forcimin e koordinimit ndërinstitucional;
- rritjen e efikasitetit, transparencës dhe përshejtimin e proceseve administrative;
- mbështetjen e reformave dhe integritimit evropian.

## PJESA IV: TË TJERA

### 4.1 Struktura negociuese

Për periudhën janar 2025 – prill 2026 rezulton se strukturat negociuese, më specifiku Grupi i Negociatorëve, nën drejtimin e Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator ka qenë produktiv dhe ka luajtur një rol aktiv në koordinimin e punës për arritjen e rezultateve të synuara lidhur me procesin e negociatave dhe anëtarësimin në BE, si dhe përmbushjen e detyrimeve në kuadër të zbatimit dhe raportimit të MSA-së. Më specifiku për periudhën janar 2025 - shkurt 2026 janë zhvilluar **tetëmbëdhjetë (18) takime**<sup>10</sup>, të Grupit Negociator, ku janë diskutuar rreth **dyzet e nëntë (49) tematika, në drejtim të përgatitjeve teknike të negociatave dhe transformin evropian:**

- Pozicioni Negociues Grupkapitulli II “Tregu i Brendshëm”,
- Pozicioni Negociues Grupkapitulli III “Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithpërfshirëse”,
- Pozicioni Negociues i Grupkapitullit IV “Agjenda e Gjelbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme”,
- Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit të Çështjeve Evropian të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me Pozicionin Negociues për Grupkapitullin II “Tregu i Brendshëm”, lidhur me Pozicionin Negociues për Grupkapitullin III “Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithpërfshirëse”, lidhur me Pozicionin Negociues për Grupkapitullin IV “Agjenda e Gjelbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme” si dhe lidhur me Pozicionin Negociues për Grupkapitullin V “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni”,
- Diskutimi sistematik i kërkesave për masa tranzitore të Republikës së Shqipërisë ndaj Bashkimit Evropian për Grupkapitullin II “Tregu i Brendshëm”, Grupkapitullin III “Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithpërfshirëse”, Grupkapitullin V “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni”,
- Piketat e Ndërmjetme për Grupkapitullin I “Themeloret”, kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”,
- Piketat Mbyllëse për Grupkapitullin VI “Marrëdhëniet me Jashtë”,
- Udhërrëfyese i Procesit të Negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian,
- Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 -2027, në kuadër të Planit të Rritjes,
- Raporti i Kapaciteteve – Prezantimi i nismës për Planin e Kapaciteteve,
- Përafrimi dhe Përkthimi i Aquis të BE-së,
- Planet e Punës mbi Kushtet e Mbylljes së Negociatave, të përcaktuara nga Bashkimi Evropian,
- Angazhimin e sektorit privat në procesin e integritit dhe anëtarësimin në BE,
- 
- Projektimi për vitin 2026 ( & 2027) – Prioritetet e Negociatave, hapat, masat dhe prioritetet,
- Priorizimi i Gadishmërisë Teknike për Kushtet e Mbylljes së Negociatave për 16 kapitujt (2026),
- Raporti Vjetor të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian dhe planizimi për 2026, si dhe Platformës E-Konsultime.

<sup>10</sup> takimi nr.1-datë 07.02.2025; takimi nr. 2-datë 13.02.2025; takimi nr.3-datë 21.02.2025; takimi nr.4- datë 13.03.2025; takimi nr.5-datë 03.04.2025; takimi nr.6-datë 25.04.2025; takimi nr.7-datë 19.05.2025; takimi nr.8-datë 10.06.2025; takimi nr.9-datë 13.03.2025; takimi nr.10-datë 27.06.2025; takimi nr.11-datë 28.07.2025; takimi nr.12-datë 01.09.2025; takimi nr.13- date 30.10.2025; takimi nr.14-datë 22.01.2026; takimi nr.15 – datë 19.02.2026; takimi nr.16 – datë 3.03.2026; takimi nr.17 19.03.2026; takimi nr.18 - 16.04.2026

- Informimi i biznesit, nevojat ,mundësitë, bazat e Programit për Përgatitjen e Biznesit për Tregun Unik Evropian.

Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE), nën drejtimin e Negociatorëve të kapitujve, kanë luajtur një rol aktiv në koordinimin e punës për përgatitjet për hapjen e negociatave, ku gjatë vitit 2025 janë zhvilluar rreth 287 takime, në 36 GNPIE nga ku janë të angazhuar rreth 2162 anëtarë, të cilët janë angazhuar intensivisht në kuadër të integritit, negociatave dhe ndjekjes së rekomandimeve të BE-së.

Departamenti i Politikave dhe Integritit Evropian, Sekretariati i Intergrimit Evropian, ka orientuar dhe forcuar rolin e GNPIE-së, duke drejtuar metodologjikisht planifikimin, vlerësimin dhe raportimin në kuadër të procesit të integritit evropian. Më specifikisht drejtuesit e 19 Sekretariateve Teknike të 36 GNPIE-ve (rrjeti i integritit evropian) për periudhën janar 2025 – prill 2026 ka zhvilluar 20 takime<sup>11</sup>, të dedikuara dhe të orientuara drejt forcimit të koordinimit ndërinstitucional dhe arritjes së rezultateve në përputhje me prioritetet për integrimin dhe anëtarësimin në BE.

#### 4.2 Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian

Përsa i përket Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE) dhe 35 Tryezave të Diskutimit dhe Këshillimit sipas Aquis të BE-së, gjatë vitit 2025, rezulton se janë zhvilluar 117 tryeza, 58.11% më shumë krahasuar me vitin 2024, ku janë konsultuar më shumë se 252 tematika. Në Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit të Platformës (PPIE) ka patur një pjesëmarrje të lartë të përfshirjes të rreth 1131 përfaqësuesve të grupeve të interesit nga të cilët: ekspertë të fushës (225); nga shoqëria civile (242); nga akademia/universitetet (282); nga qeverisja vendore (110); nga komuniteti i biznesit (200); nga mediat (63); si dhe nga shoqata punëmarrësish (9).

Në këto Tryeza të Diskutimit dhe Këshillimit të Platformës janë trajtuar, diskutuar dhe konsultuar çështje lidhur me:

- Piketat e Ndërmjetme dhe progresi në kuadër të angazhimeve dhe masave specifike;
- Transparenca e procesit të negociatave dhe rëndësia e Komunikimit Publik.
- Zbatimin e Axhendës Kombëtare të Reformave, monitorimin e zhvillimeve dhe sigurinë e transparencës, si dhe çështje të tjera
- si integriteti i magjistratëve, reformat në Shkollën e Magjistraturës, mbrojtja e pakicave kombëtare dhe liria e medias.
- Databaza Gjeohapësonore dhe Atlasi Gjeografik Web GIS;
- Diskutim i gjerë mbi përmbushjen e Kushteve të Mbylljes brenda afateve (objektive paraprake) të përcaktuara.
- Diskutimin lidhur të draft – Paketës Strategjike për Reformën në Administratën Publike 2024-2030.
- Bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe rolin e PPIE-së në procesin e reformave evropiane.
- Konsultimin publik lidhur me projekt-ndryshimet në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”

<sup>11</sup>07.02.2025; 12.03.2025; 25.04.2025; 04.06.2025; 05.06.2025; 16.07.2025;31.10.2025;17.11.2025; 14.01.2026; 02.03.2026; 17.03.2026 (6 takime sipas Grupimeve); 07.04.2026

- Modelet e rekrutimit dhe menaxhimit të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues, përfshirë kalimin nga një model karriere i mbyllur në një
- model miks.
- Unifikimin e kritereve të pranimit dhe strukturën e pagave, si dhe tipologjinë e institucioneve.
- Përafrimi i legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së në fushën e mbikëqyrjes së tregut dhe garantimit të lëvizjes së lirë të mallrave dhe Plani i Veprimit të TFBE.
- Diskutim lidhur me Ligjin për “Shërbimet”, etj.

### 4.3 Kapacitetet

#### **Plani Kombëtar i Kapaciteteve për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin në BE 2026–2027**

Në kuadër të Planit Kombëtar të Kapaciteteve për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin në BE 2026–2027, Departamenti për Politikën dhe Integrimin Evropian, në rolin e Sekretariatit për Integrimin Evropian, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), ka realizuar gjatë vitit 2025, Vlerësimin e Nevojave për Trajnim (Training Needs Assessment – TNA) për drejtuesit dhe anëtarët e 36 Grupeve Ndërinstitucionale për Integrimin Evropian (GNPIE), për periudhën 2026–2027.

Në vijim të këtij procesi dhe në kuadër të analizave për konsolidimin dhe finalizimin e Planit Kombëtar të Kapaciteteve, janë përgatitur produkte analitike kyçe, konkretisht:

- 36 (33 Kapitujt dhe 3 Kritere) raporte/diagnoza, nga një për secilin kapitull/kriter të Acquis të BE-së;
- 6 raporte/profile kombëtare për secilin grupkapitull (cluster), të hartuara në përputhje me Metodologjinë e Re të Zgjerimit të Komisionit Evropian, COM(2020) 57.

Plani Kombëtar i Kapaciteteve për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin në BE 2026–2027 përfshin në total 64 tematika, të strukturuar në:

- 11 tematika horizontale, të cilat mbulojnë të gjithë ciklin e procesit të integritit evropian, duke përfshirë koordinimin institucional, procesin e negociatave, përafrimin ligjor, përdorimin e fondeve të Bashkimit Evropian, teknologjitë digjitale dhe zhvillimin e aftësive të buta;
- 53 tematika të organizuara sipas 6 Grupkapitujve (clusters), të cilat adresojnë në mënyrë të detajuar dhe specifike, fushat kryesore të procesit të integritit evropian.

Në këtë kuadër, Plani Kombëtar i Kapaciteteve shërben si një instrument koordinimi të forcimit të strukturuar të kapaciteteve, duke garantuar një qasje të harmonizuar për rritjen e aftësive institucionale dhe harmonizimin efektiv të njohurive në praktikë në funksion të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe përgatitjen institucionale për anëtarësim.

#### **Objektivat e programeve të trajnimeve për forcimin e strukturave të GNPIE për integrimin evropian**

Në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Kapaciteteve për strukturat e integritit evropian 2024–2025, Sekretariati i Integritit Evropian, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, gjatë vitit 2025, ka zhvilluar trajnime të dedikuara për forcimin e kapaciteteve të strukturave GNPIE. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar dhe realizuar gjithsej 28 trajnime, në të cilat kanë marrë pjesë 863 pjesëmarrës nga institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe pushteti vendor. Programet trajnuese janë strukturuar në module

specifike, të zhvilluara mbi bazën e kurrikulave të hartuara në procesin integruar të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian, si më poshtë:

- “Qeverisja për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin në BE”;
- “Llojet e fondeve të BE-së, planifikimi dhe aplikimi për fonde”;
- “Çështjet rregullatore të BE-së”;
- “Përgatitja e planit të përkthimit të *acquis-it* të BE-së”;
- “Identifikimi i grupeve të interesit për pjesë të caktuara të procesit të negociatave”;
- “Vlerësimi i Piketave Hapëse”.

Të dhënat e mbledhura nga feedback-u i strukturuar tregojnë se:

- 79% e pjesëmarrësve kanë fituar njohuri të reja dhe të aplikueshme;
- 79% vlerësojnë se trajnimet kanë nxitur shkëmbimin e informacionit dhe praktikave të dobishme ndër-institucionale;
- 64% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se trajnimet kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e ushtrimit të detyrave të tyre funksionale.

**Për vitin 2026, për periudhën janar-mars 2026**, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve për Grupet Ndër-institucionale të Punës për Integrimin Evropian GNPIE janë zhvilluar 3 kurse online me certifikim në të cilat kanë marrë pjesë 54 pjesëmarrës.

Përkatësisht në modulet:

- Identifikimi i grupeve të interesit për pjesë të caktuara të procesit të negociatave -15 pjesëmarrës;
- Llojet e fondeve të BE-së, planifikimi dhe aplikimi për fondet - 25 pjesëmarrës;
- Përgatitja e planit të përkthimit të EU-se *Acquis* - 14 pjesëmarrës.

Të dhënat e mbledhura nga *feedback-u* i strukturuar tregojnë se:

- 74% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se janë plotësisht dakort që trajnimet i kanë ndihmuar për të përfituar njohuri të përditësuara;
- 76% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se janë plotësisht dakort që trajnimet i kanë ndihmuar në shkëmbimin e informacionit dhe ideve me trajnerin dhe koleget;
- 72% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se janë plotësisht dakort që trajnimet i kanë ndihmuar në realizimin e punës në mënyrë më efektive.

#### **Administrata qëndrore, vendore dhe institucioneve të pavarura**

Gjatë vitit 2025, është ofruar një gamë e gjerë trajnimesh për administratën e pushtetit qendror, pushtetin vendor, si dhe për institucionet e pavarura, të fokusuara si në çështje të përgjithshme mbi Bashkimin Evropian dhe procesin e integritit evropian, ashtu edhe në çështje specifike që lidhen me kapituj e *Acquis* të BE-së. Mbi Integrimin Evropian janë trajnuar gjithsej 2,444 zyrtarë publik.

#### **4.4 Pushteti Vendor**

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është një proces kompleks dhe gjithëpërfshirës, i cili bëhet realitet nëpërmjet kontributit të të gjitha niveleve të qeverisjes dhe të gjithë shoqërisë. Integrimi në Bashkimin Evropian përbën një objektiv strategjik për pushtetin vendor, gjithashtu.

Viti 2025 ka pasur zhvillime të rëndësishme lidhur me integrimin evropian dhe fuqizimin e rolit të bashkive në këtë proces, ku hapja e negociatave për Grupkapitullin V më 17 nëntor 2025, i cili lidhet direkt me zhvillimin lokal territorial, ekonomik dhe social, do të ketë një impakt mbi përfshirjen e pushtetit vendor në politikëbërjen dhe zbatimin e politikave zhvillimore lokale dhe rajonale sipas politikave dhe instrumentave financuese për kohezionin të BE-së.

Gjatë vitit 2025 janë organizuar gjithashtu dy konferenca kombëtare, specifikuist:

- **Konferenca mbi rolin e Bashkive Shqiptare në Integrimin Evropian**

Më **13 nëntor 2025**, me mbështetjen e projektit EU4GoodGovernance, u zhvillua Konferenca Kombëtare me temë **“Ngjitja në një nivel më të lartë: Roli i Bashkive Shqiptare në Integrimin Evropian”**. Kjo Konferencë u organizua posaçërisht për të adresuar rolin dhe sfidat e pushtetit vendor në procesin e integritimit. Konferenca shërbeu si një platformë për dialog të drejtëpërdrejtë midis drejtuesve vendorë, Shoqatave të Bashkive nga vendet e BE-së, si dhe përfaqësuesve nga organizatat ndërkombëtare të pranishëm në Konferencë. Konferenca theksoi rëndësinë e përgatitjes institucionale të bashkive shqiptare në kuadër të negociatave për anëtarësim, si dhe rolin e tyre pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

- **Konferenca Bilaterale e Komitetit Konsultativ të Përbashkët (JCC)**

Më **4 dhjetor 2025**, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore organizuan Konferencën Bilaterale të **Komitetit Konsultativ të Përbashkët** midis **Komitetit të Rajoneve të Bashkimit Evropian** dhe **Bashkive të Shqipërisë**. Ky aktivitet pati rëndësi të veçantë diplomatike dhe teknike në kuadër të procesit të integritimit evropian.

Përfaqësues të pushtetit vendor shqiptar (kryetarë dhe nënkryetarë bashkish) morën pjesë në këtë forum dialogu me homologët e tyre evropianë. Diskutimet u fokusuan në çështje kyçe si:

- decentralizimi fiskal
- qëndrueshmëria financiare e bashkive
- mekanizmat për përfshirjen efektive të pushtetit vendor në politikën e kohezionit

Konferenca ofroi një mundësi të çmuar për shkëmbim të drejtëpërdrejtë përvojash dhe për përforsimin e bashkëpunimit institucional, duke përcjellë në mënyrë të qartë pritshmëritë e BE-së për rolin e bashkive shqiptare në procesin e integritimit.

- **Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të Njësitë të Integritimit Evropian, përmes trajnimeve**

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve administrative të Bashkive, gjatë vitit 2025, janë realizuar **6 trajnime teknike (online)** për Njësitë të Integritimit Evropian, ku në fokus ishin programe dhe thirrje konkrete të Bashkimit Evropian, duke përfshirë CERV, ERASMUS+ dhe URBACT IV, ku bashkitë shqiptare janë të pranueshme për të aplikuar:

- Trajnimi i datës 11 Shkurt, 2025 mbi thirrjen *“Network of Towns”* nën programin **CERV** ka përfshirë 24 bashki.
- Trajnimi i datës 28 Shkurt, 2025 mbi thirrjet *“Youth”* dhe *“Sport”* nën programin **ERASMUS+** ka përfshirë 8 bashki.
- Trajnimi i datës 22 Prill 2025, mbi thirrjet *“Citizens’ Engagement and Participation”* dhe *“Rights of the Child and Children’s Participation”* nën programin **CERV** ka përfshirë 21 bashki.

- Trajnimi i datës 5 Maj 2025 mbi thirrjen “*Prevent and Combat Gender-based Violence and Violence against Children*” nën programin **CERV** ka përfshirë 19 bashki.
- Trajnimi i datës 11 Qershor, 2025 mbi thirrjen “*Rrjetet e Transferimit*” nën programin **URBACT IV** ka përfshirë 12 bashki.
- Trajnimi i datës 1 Shtator, 2025 mbi thirrjen “*Town Twinning*” nën programin **CERV** ka përfshirë 9 bashki.
- **Mbështetje për Bashkitë për aplikime dhe menaxhim të projekteve të BE-së**

Gjatë vitit 2025, është ofruar asistencë e drejtpërdrejtë për bashkitë në menaxhimin e projekteve të financuara nga BE-ja, duke adresuar çështje procedurale, financiare dhe administrative. Asistenca ka përfshirë mbështetje mbi rregullat e PRAG, kërkesat për bashkëfinancim, regjistrimin e projekteve në Ministrinë e Financave dhe hapjen e llogarive në Thesar, si dhe zgjidhjen e problematikave të lidhura me TVSH-në dhe përdorimin e portaleve zyrtare të BE-së **Funding & Tenders** dhe **PADOR**.

Gjatë vitit 2025 janë asistuar bashkitë Kamëz, Klos, Dibër, Elbasan, Dropull, Berat, Pogradec, Pukë, Peqin, Divjakë, Gjirokastër, Bulqizë dhe Durrës.

- **Asistencë teknike për Bashkitë në hartimin e projekt-propozimeve, konkretisht gjatë vitit 2025 janë ofruar :**
  - o Asistencë për **Bashkinë Livohovë** - për përgatitjen e aplikimit dhe nënshkrimin e marrëveshjes së grantit, projekt fitues.
  - o Asistencë për **Bashkinë Dropull** - për përgatitjen e aplikimit në thirrjen **BE-MED**, projekt fitues.
  - o Asistencë për **Bashkinë Maliq** - për përgatitjen e aplikimit në thirrjen **CHILD** të Programit CERV, në pritje të rezultateve.
  - o Asistencë për **Bashkinë Cërrik** - për përgatitjen e aplikimit në thirrjen **Sunny Schools**, projekt fitues.
  - o Asistencë për **Bashkinë Belsh** - për përgatitjen e aplikimit në thirrjen **Sunny Schools**, projekt fitues.
  - o Asistencë për **Bashkinë Bulqizë** - për përgatitjen e aplikimit në thirrjen **Sunny Schools**, projekt fitues.

#### - **Thirrje për aplikime të shpërndara te NJIE gjatë vitit 2025**

Në funksion të rritjes së aksesit të bashkive në financimet e Bashkimit Evropian, janë **identifikuar, analizuar dhe përpunuar informacion mbi 30 thirrje të hapura** nga programe të ndryshme evropiane financimi. Për secilën thirrje janë përgatitur skeda informative të strukturuar, të cilat janë përcjellë në mënyrë zyrtare te Njësitë e Integritimit Evropian të bashkive. Ky proces ka shërbyer si instrument praktik për orientimin e bashkive drejt thirrjeve më të përshtatshme dhe për përmirësimin e cilësisë së aplikimeve të tyre.

#### - **Këshilli Konsultativ**

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rritjes së efikasitetit në procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit që prekin drejtpërdrejt njësitë e vetëqeverisjes vendore, Këshilli Konsultativ ka vepruar si një forum kolegjal i rëndësishëm, mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 17.4.2024. Ky mekanizëm institucional ka siguruar një platformë të qëndrueshme dialogu ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, duke garantuar pjesëmarrje aktive dhe kontribuese në hartimin e politikave publike.

**Gjatë periudhës janar 2025 – mars 2026 janë zhvilluar 12 (dymbëdhjetë) mbledhje.** Nga ministrinë e linjës janë sjellë për konsultim/mendim një numër projektaktesh, ndër të cilat 10 (dhjetë) projektligje, 38 (tridhjetë e tetë) projektvendime, 2 (dy) udhëzime dhe 1 (një) urdhër. Gjithashtu, janë sjellë 6 (gjashtë) draft dokumenta/prezantime/raporte dhe dy projektvendime (propozime), nga Bashkia Lushnjë dhe bashkia Kamëz, si dhe 1 (një) kërkesë.

**- Projektakte të konsultuara në Këshillin Konsultativ**

1. Në mbledhjen e zhvilluar më datë 18 Shkurt, 2025, janë diskutuar nga bashkitë pjesëmarrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit Konsultativ 3 (tre) projektakte, 1 (një) raport dhe 1 (një) dokument, si vijon;
  - *Projektvendimi* “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.450, datë 26.07.2018 të Këshillit të Ministrave “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritimit evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”
  - *Projektvendimi* “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2025-2030 dhe planit të veprimit”
  - *Projektvendimi* “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 754, datë 18.12.2024 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe zhvillimin e zonave aeroportuale”
  - *Raport* mbi “Ecurinë e zbatimit të Vendimit nr.1/2024 të Këshillit të Stabilitimit dhe Asocimit midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Rajoneve (RoC)”
  - *Dokumenti* “Mbi nevojën e hartimit të Rregullores së Brendshme të Këshillit Konsultativ, si dhe analizës nga Projekti i BE-së, EU4GoodGovernance mbi nevojën e krijimit, bazuar në standardet e Këshillit të Evropës dhe vendeve të BE-së”.
2. Në mbledhjen e zhvilluar më datë 9 Prill, 2025, janë diskutuar nga bashkitë pjesëmarrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit Konsultativ 2 (dy) projektakte si vijon;
  - *Projekturdhër* i Kryeministrit “Për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale për Sezonin Turistik 2025”, paraqitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
  - *Projektvendimi* “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.926, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes”, i ndryshuar, paraqitur nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.
3. Në mbledhjen e zhvilluar më datë 8 Maj, 2025, janë diskutuar nga bashkitë pjesëmarrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit Konsultativ, 3 (tre) projektakte si vijon;
  - *Projektligji* “Për gjuetinë”, paraqitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
  - *Projektvendimi* “Për miratimin e dokumentit politik të moshimit dhe planit të veprimit 2025-2030”, paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.  
*Projektudhëzimi* “Për përcaktimin e rregullave, kriterëve dhe dokumentacionit për identifikimin e zonave me prioritet zhvillimi në territoret e bashkive”, paraqitur nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor;
4. Në mbledhjen e zhvilluar më datë 2 Qershor, 2025, janë diskutuar nga bashkitë pjesëmarrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit Konsultativ, 12 (dymbëdhjetë) projektakte si vijon;
  - *Projektvendimi* “Për ngritjen e Komitetit Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial Evropian”, të ardhur nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor

- *Projektvendimi* ”Për metodologjinë e krijimit të partneritetit për përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e fondeve të politikave të kohezionit të BE-së në Republikën e Shqipërisë”, të ardhur nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor
- *Projektvendimi* ”Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme”, të ardhur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- *Projektvendimi* “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.575, datë 24.6.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, të ardhur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- *Paketa ligjore e ardhur nga Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit/Inspektorati i Përgjithshëm*
- *Projektvendimi* “Për përcaktimin rregullave të organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Përgjithshëm”
- *Projektvendimi* “Për përcaktimin e institucioneve që riorganizohen sipas Ligjit Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”
- *Projektvendimi* “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit”
- *Projektvendimi* “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit”
- *Projektvendimi* “Për përcaktimin e përbërjes dhe mënyrës së funksionimit të bordit të inspektimeve”
- *Projektvendimi* “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme për marrjen, trajtimin e mostrave dhe kryerjen e ekspertizave, si dhe e metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve në këto procedura”
- *Projektvendimi* “Për programimin e inspektimeve dhe metodologjinë e vlerësimit të riskut, si dhe për përcaktimin e periudhës maksimale të inspektimeve vjetore dhe mënyrën e llogaritjes së tyre”
- *Projektvendimi* “Për përcaktimin e kritereve të veçanta dhe procedurave të përzgjedhjes, emërimit, vlerësimit e rezultateve në punë, disiplinën, lirimimin dhe shkarkimin nga detyra të Inspektorit të Përgjithshëm”.

Në fillim të mbledhjes së datës 2 Qershor 2025 është prezantuar nga znj. Mirela Kumbaro, Ministre e Turizmit dhe Mjedisit, Sesioni konsultues “Në kuadër të Task-Forcës mbi masat për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2025”.

5. Në mbledhjen e zhvilluar më datë 21 Korrik, 2025, janë diskutuar nga bashkitë pjesëmarrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit Konsultativ 7 (shtatë) projektakte, 1 (një) rregullore dhe 1 (një) prezantim si vijon;

- *Projektligji* “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- *Projektvendimi* “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, të ndryshuar”;
- *Projektvendimi* “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.712, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore, të ndryshuar”

- *Projektvendimi* “Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shtijen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimin e rrugëve autopsyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre, si dhe kriteret për shënimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore dhe për prerjet shfrytëzuese në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale”
  - *Projektvendimi* “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të integruar mjedisor”
  - *Projektvendimi* “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”
  - *Rregullore e Brendshme* “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”; *Prezantim* i Procedurave Standarde të Veprimit për Strukturat e Diasporës dhe Migracionit
6. Në mbledhjen e zhvilluar (*online*) më datë 3 Shtator, 2025, janë diskutuar nga bashkitë pjesëmarrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit Konsultativ 2 (dy) projektakte normative si vijon;
- *Projektligji* “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar
  - *Projektligji* “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.
7. Në mbledhjen e zhvilluar (*online*) më datë 14 Nëntor, 2025, janë diskutuar nga bashkitë pjesëmarrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit Konsultativ 5 (pesë) projektakte dhe 1 (një) propozim për projektvendim, si vijon;
- *Projektligji* “Për Kujdesin Alternativ në Familje në Republikën e Shqipërisë”
  - *Projektligji* “Për Parandalimin dhe Mbrojtjen ndaj Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”
  - *Projektligji* “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”
  - *Projektvendimi* “Plani Kombëtar për Rinovimin e Ndërtesave”
  - *Projektvendimi* “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026-2030 dhe Planit të Veprimit 2026-2028”
  - *Propozim për projektvendim* “Akti i krijimit të Bazës së të Dhënave Shtetërore”.
8. Në mbledhjen e zhvilluar (*online*) më datë 9 Dhjetor, 2025, janë diskutuar nga bashkitë pjesëmarrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit Konsultativ 3 (tre) projektakte normative, 1 udhëzues, 1 (një) draft dhe 1 (një) propozim për ndryshim vendimi si vijon;
- *Projektligji* “Për censin e bujqësisë”
  - *Projektligji* “Për lirinë e vendosjes dhe ofrimit të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë”,
  - *Projektvendimi* “Plani Kombëtar i Kontigjencës për Flukset Migratore për vitet 2026-2028”
  - *Drafti* “Plani Kombëtar i Garancisë Evropiane për Fëmijët në Shqipëri”
  - *Udhëzuesi* “Për Ngritjen dhe Funksionimin e Fondit Social në Bashki”
  - *Propozimi* “Për ndryshimin e pikës 11 të VKM-së nr. 328, datë 31. 05. 2023 “Për klasifikimin e funksionarëve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruarve, të

nëpunësve civil e të punonjësve administrativ të njërive të vetëqeverisjes vendore, ndryshuar me VKM nr. 503 datë 01.08.2024”.

9. Në mbledhjen e zhvilluar (*online*) më datë 17 Dhjetor, 2025, janë diskutuar nga bashkitë pjesëmarrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit Konsultativ 5 (pesë) projektakte normative si vijon;

- *Projektvendimi* “Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr. 649, datë 16.10.2024, Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar”
- *Projektvendimi* “Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës se shpërblimit të drejtë për huadhënien publike”
- *Projektvendimi* “Për miratimin e normave, standardeve, çmimet bazë dhe praktikat më të mira në fushën e pyjeve”
- *Projektvendimi* “Për miratimin e Planit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve”
- *Projektvendimi* “Për rishikimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020-2030”.

10. Në mbledhjen e zhvilluar (*online*) më datë 8 Janar, 2026, është diskutuar nga bashkitë pjesëmarrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit Konsultativ 1 (një) projektakt, si vijon;

- *Projektvendimi* “Për miratimin e metodologjisë, rregullave dhe procedurave për përcaktimin e vlerës së taksueshme te pasurisë së paluajtshme ”ndërtesa”, llogaritjen e taksës mbi ndërtesën dhe pagesën e saj”.

11. Në mbledhjen e zhvilluar (*online*) më datë 3 Shkurt, 2026, janë diskutuar nga bashkitë pjesëmarrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit Konsultativ 4 (katër) projektakte, si vijon:

- *Projektvendimi* “Për një ndryshim në Vendimin nr. 419, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagesë bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”
- *Projektvendimi* “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar
- *Projektvendimi* “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 425, datë 26.6.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor para universitar”
- *Projektvendimi* “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë Rrugore 2030 dhe planit të veprimit 2026-2028”; *Projektvendimi* “Për miratimin e Planit Kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike 2026-2036”.

12. Në mbledhjen e zhvilluar (*online*) më datë 3 Mars, 2026, janë diskutuar nga bashkitë pjesëmarrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit Konsultativ 4 (katër) projektakte dhe 1 (një) prezantim, si vijon:

- *Projektligji* “Për Policinë Bashkiake”

- *Projektvendimi* “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të trajtimit ekonomik dhe financiar të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën për shkak të detyrës, dhe punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës”
- *Projektvendimi* “Për disa ndryshime në vendimin nr. 173, datë 24.03.2023, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2025”, i ndryshuar”
- *Projektvendimi* “Për miratimin e formatit tip të marrëveshjes që lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe investitorit për të drejtën e përdorimit të brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve si stacione plazhi”*Prezantim* “Procedurat standarde të veprimit për angazhimin e diasporës në nivelin vendor”.

## PJESA V

### ANEKS I: LISTA E AKTEVE TË MIRATUARA GJATË PERIUDHËS 2025 – PRILL 2025 PËR SECILIN (GRUP) KAPITULL TË ACQUIS:

#### GRUPKAPITULLI I – “THEMELORËT”

#### KAPITULLI 23 & 24 (PIKETAT E NDËRMJETME)

##### Ligje:

1. Ligji Nr. 128/2024 datë 19.12.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7975 datë 26.07.1995 Për barnat narkotike dhe substancat psikotrope"
2. Ligji Nr. 38/2025, "Për Përpunimin e Informacionit të Udhëtimit në Republikën e Shqipërisë"
3. Ligji Nr. 39/2025, "Për Kontrollin e Kufirit Shtetëror"
4. Ligji Nr. 44/2025, "Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve"
5. Ligji Nr. 37/2025, datë 27.03.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9917, datë 19.05.2008 'Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit'"
6. Ligji Nr. 43/2025, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 79/2021 "Për të Huajt"
7. Ligji Nr. 85/2025 datë 12.12.2025 "Për Rivlerësimin e Pasurive të Paluajtshme"
8. Ligji Nr. 64/2025, "Për barazinë gjinore"
9. Ligji Nr. 78/2025, "Për Avokatin e Popullit"
10. Ligji Nr. 92/2025, "Për Kujdesin Alternativ"
11. Ligji Nr. 96/2025, "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve"
12. Ligji Nr. 10/2026 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar"
13. Ligji Nr. 9/2026 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"
14. Ligji Nr. 15/2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 97/2013 "Për Median Audiovizive në Republikën e Shqipërisë"
15. Ligji Nr. 14/2026 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8891, datë 02.05.2002 'Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit'"
16. Ligji Nr. 8/2026 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995, ' "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar"
17. Ligji Nr. 12/2026 "Për Lobimin"
18. Ligji Nr. 11/2026 "Për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje".
19. Ligji Nr. 13/2026 "Për Importin, Eksportin dhe Tranzitin e Armëve të Zjarrit, Pjesëve Kryesore dhe Municioneve".
20. Ligji Nr. 23/2026 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e Funksioneve Publike"
21. Ligji Nr. 22/2026 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi"
22. Ligji Nr. 16/2026, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8874, datë 29.3.2002, 'Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope'"
23. Ligji Nr. 17/2026, "Për disa shtesa në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995, 'Për barnat narkotike, psikotrope dhe të kontrolluara', i ndryshuar"

**Vendimet e Këshillit të Ministrave të miratuara:**

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 209, datë 09.04.2025 “Për heqjen e Bahreinit nga lista e regjimit sezonal pa viza për qëllime turizmi”
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 788 datë 24.12.2025 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontigjencës për Flukset e Përziera Migratore 2026–2028”
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 44, datë 21.01.2026 “Për miratimin e Planit të Veprimit të Shengenit”
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 393, datë 10.07.2025 “Për tarifatat dhe procedurat e pagesës për shënjimin dhe gjurmueshmërinë”
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 235, datë 24.04.2025 “Për ndërprerjen e pezullimit të pjesshëm dhe mbylljen e masës lehtësuese për Bjellorusinë”
